



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E LËNDËS SË GJEOGRAFISË NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Material në ndihmë të mësuesit

2023

Koordinoi hartimin e udhëzuesit

Evis Mastori, ASCAP

Koordinoi redaktimin shkencor

Dr. Dorina Rapti

Koordinoi redaktimi letrar

Miranda Kurti

Koordinoi faqosjen

Eriksen Mersinllari

Prodhim i ASCAP, 2023

www.ascap.edu.al

Copyright ©, ASCAP

TABELA E PËRMBAJTJES

I. QËLLIMI I UDHËZUESIT	4
II. RËNDËSIA DHE STRUKTURA E LËNDËS NË KËTË CIKËL SHKOLLIMI	5
2.1 Rëndësia e Gjeografisë në këtë cikël shkollimi.....	5
2.2 Struktura e lëndës	5
III. KOMPETENCAT KYÇE DHE SHEMBUJ TË ZHVILLIMIT TË TYRE	8
IV. MODELE TË INTEGRIMIT NDËRLËNDOR BRENDË DHE JASHTË FUSHËS SË TË NXËNIT	13
4.1. Integrimi ndërlëndor brenda fushës	13
4.2 Integrimi ndërlëndor me fushat e tjera të të nxënit.....	16
V. TEMAT NDËRKURRIKULARE	24
VI. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES-NXËNIES NË GJEOGRAFI	33
6.1. Shembuj të përdorimit të metodave dhe teknikave të të nxënit në gjeografi	36
VII. PLANIFIKIMI KURRIKULAR DHE MODELE TË PLANIFIKIMIT TË LËNDËS 45	
7.1. Planifikimi i mësimdhënies së gjeografisë.....	45
7.2. Planifikimi vjetor	46
7.3. Planifikimi i periudhës	50
7.4. Planifikimi ditor.....	57
VIII. VLERËSIMI I NXËNËSVE	75
8.1. Teknika dhe instrumente të vlerësimit të nxënësve në lëndën e gjeografisë	76
8.2. Përdorimi i niveleve të arritjeve dhe vlerësimi bazuar në kritere.....	79
8.3. Llojet e vlerësimit	82
A. Vlerësimi i vazhduar (për të nxënë)	82
B. Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse	82
C. Projekti kurrikular	106
Vlerësimi periodik	115
Vlerësimi përfundimtar.....	115
IX. BIBLIOGRAFIA	117

I. QËLLIMI I UDHËZUESIT

Udhëzuesi kurrikular i lëndës gjeografi është një material ndihmës për përdoruesit e kurrikulës dhe në mënyrë të veçantë për mësuesit për zbatimin e programeve mësimore të kësaj lënde në arsimin e mesëm të lartë.

Udhëzuesi ka si qëllim:

- të ndihmojë mësuesit, drejtuesit e shkollave, nxënësit, prindërit në lidhje me kuptimin dhe zhvillimin e kompetencave kyçe dhe kompetencave të lëndës së gjeografisë;
- të ofrojë sugjerime mbi strategjitë dhe metodat ndërvepruese të mësimdhënies/nxënies që mbështesin dhe zhvillojnë të nxënit aktiv, duke i lënë vend lirisë akademike të mësuesve dhe krijimtarisë së tyre;
- të mbështesë mësuesit për planifikimin e veprimtarive mësimore në përmbushje të rezultateve të të nxënit, të specifikuara në programet e gjeografisë për shkallë dhe klasë;
- të tregojë rrugët në të cilat të mësuarit e gjeografisë mund të lidhet me përvojat e të mësuarit në lëndë të tjera dhe me ato të jetës së përditshme të nxënësve;
- të ofrojë sugjerime mbi strategjitë dhe teknikat e vlerësimit të nxënësve.

II. RËNDËSIA DHE STRUKTURA E LËNDËS NË KËTË CIKËL SHKOLLIMI

2.1 Rëndësia e Gjeografisë në këtë cikël shkollimi

Gjeografia është shkenca e vendit, hapësirës dhe mjedisit e cila jep një kontribut të veçantë për përgatitjen e nxënësve për jetën dhe funksionimin e tyre në një shoqëri globale dhe të ndërruar. Nëpërmjet studimit rajonal të hapësirës gjeografike synohet që nxënësit, duke analizuar shpërndarjen hapësinore të dukurive gjeografike në mjedisin fizik dhe human, të aftësohen për të mbajtur qëndrime, për të gjetur zgjidhje të informuara për çështje të botës së sotme, duke vlerësuar nevojën për zhvillim të qëndrueshëm.

Përmes kompetencave që zhvillon lënda, nxënësit aftësohen të njohin, pranojnë, vlerësojnë dhe respektojnë diversitetin e vendeve, rajoneve, kulturave dhe njerëzve në botë; të zbulojnë lidhjet shkak-pasojë të dukurive dhe proceseve që ndodhin në sistemet natyrore të planetit tonë; të mbrojnë mjedisin në funksion të zhvillimit të tij të qëndrueshëm.

Gjeografia i frymëzon nxënësit të mendojnë për vendin e tyre, përmes saj edukohen vlera dhe qëndrime për përgjegjësitë e tyre ndaj njerëzve e vendeve të tjera, për ndërrarësinë, ndërveprimin dhe bashkëpunimin reciprok ndërmjet vendeve.

Gjeografia në këtë cikël shkollimi mundëson për nxënësit hapësira përfshirjeje e thellimi në fushat që ai dëshiron e ka interes dhe të cilat, në njëfarë mënyre, përbëjnë disa ndër sfidat më të mëdha që ne, si shoqëri e shekullit të 21 do të përballojmë: Si do t'i përgjigjet shoqëria sfidës së ngrohjes globale? Si do të zgjidhen dhe parandalohen konfliktet gjeopolitike? Si mund t'i përdorim në mënyrë sa më efektive burimet natyrore të kufizuara? Si mund t'i projektojmë qytetet për të qenë të qëndrueshëm nga pikëpamja mjedisore dhe për një cilësi më të mirë të jetës?

Këto njohuri dhe aftësi të transferueshme u shërbejnë për të nxënësit e tyre gjatë gjithë jetës.

2.2 Struktura e lëndës

Programet e gjeografisë për arsimin e mesëm të lartë janë hartuar me një strukturë dhe mënyrë të re konceptimi në funksion të qasjes kurrikulare me bazë kompetencat.

Ato krijojnë kushte për ndërtimin e kompetencave kyçe të të nxënësit gjatë gjithë jetës dhe kompetencave të lëndës që lidhen me to. Kompetencat zhvillohen përmes tematikave të përbashkëta të fushës dhe në program zërthehen në njohuri, shkathtësi, qëndrime/vlera.

Gjeografia është lëndë e fushës shoqëria dhe mjedisi, së bashku me historinë, qytetarinë, filozofinë, sociologjinë, psikologjinë dhe ekonominë. Lënda e gjeografisë në arsimin e mesëm të lartë zhvillohet nga klasa e 10-të deri në të 12-të me këtë strukturë:

GJEOGRAFI AML	Shkalla 5				Shkalla 6	
	KURRIKUL BËRTHAMË				KURRIKUL ME ZGJEDHJE	
	Klasa 10		Klasa 11		Klasa 12	
	Orë javore	Orë vjetore	Orë javore	Orë vjetore	Orë javore	Orë vjetore
	2	72	2	72	4	136

Tematikat e përbashkëta të fushës janë elemente të rëndësishme të programit të gjeografisë, sipas të cilave strukturohet përmbajtja lëndore dhe integrimi konceptual brenda fushës, në funksion të zhvillimit të kompetencave. Programi i gjeografisë për klasat 10-12 është i strukturuar rreth dy tematikave të mëdha:

- **Proceset natyrore dhe shoqërore;**
- **Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve.**

Klasat	Tematika	Nëntematikat	Orë të sugjeruara¹
<i>Klasa 10</i> <i>(Kurrikul bërthamë)</i>	Proceset natyrore dhe shoqërore	Sistemi diellor	10
		Hartografia	7
		Atmosfera	15
		Hidrosfera	8
		Litosfera	8
		Biosfera	2

¹Orët për nëntematikat janë sugjeruese. Mësuesit janë të lirë të planifikojnë dhe shpërndajnë sipas nëntematikave orët në dispozicion për secilën klasë, në varësi të interesave dhe nevojave të nxënësve.

		Dinamika e Tokës	18
		Mjedisi dhe ndikimi i veprimtarisë njerëzore	4
<i>Klasa 11</i> <i>(Kurrikul bërthamë)</i>	Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve	Hapësira në trajtimin gjeografik rajonal.	4
		Evropa, rajoni, Shqipëria dhe trevat e tjera shqiptare.	10
		Tiparet e përgjithshme natyrore të Republikës së Shqipërisë.	9
		Popullsia dhe ekonomia e Republikës së Shqipërisë.	10
		Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë.	35
		Pabarazitë dhe mundësitë e zhvillimeve rajonale.	4
<i>Klasa 12</i> <i>(Kurrikul me zgjedhje)</i>	Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve	Gjeografia dhe proceset globalizuese	5
		Rajonet gjeografike të botës	81
		Sfida të botës globale	50

Për secilën prej tematikave dhe nëntematikave përcaktohen rezultatet e pritshme të cilat përfshijnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet. Rezultatet e të nxënimit të kompetencave kyçe nuk përmbushen jashtë tematikave, ato janë marrë në konsideratë në të gjithë procesin e hartimit të rezultateve të të nxënimit për tematikë, duke qenë pjesë integrale e tyre.

III. KOMPETENCAT KYÇE DHE SHEMBUJ TË ZHVILLIMIT TË TYRE

Shkolla duhet t'i aftësojë nxënësit të përdorin dijet për të kuptuar botën rreth tyre dhe për t'i drejtuar ato në veprimet që ndërmarrin. Në mënyrë që të përshtaten, të funksionojnë dhe të jenë të suksesshëm në tregun e punës dhe në jetën e përditshme, nxënësve u nevojiten aftësi të cilat përfshijnë shumë më tepër se ato specifiku të lidhura me lëndën. Këto aftësi të përgjithshme intelektuale, sociale dhe personale identifikohen me termin *kompetenca kyçe*². Kompetencat kyçe zhvillohen në mënyrë graduale përgjatë viteve të shkollimit.

Kompetencat kyçe janë të përgjithshme për shkak të natyrës së tyre kroskurrikulare. Ato janë komplementare, në kuptimin që nuk zëvendësojnë njëra-tjetrën.

Programet e gjeografisë në arsimin e mesëm të lartë krijojnë kushte për ndërtimin dhe demonstrimin nga nxënësi të kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe. Këto kompetenca marrin kuptim nëse zhvillohen dhe përmbushen në një kontekst të caktuar.

Ndërtimi dhe zhvillimi i kompetencave kyçe kërkon që mësuesi të mbajë parasysh dhe të punojë për përmbushjen e rezultateve të të nxënësve (RN) të kompetencave kyçe të përcaktuara në programet e gjeografisë për çdo shkallë.

Parashtrimet e mëposhtme demonstrojnë zhvillimin e kompetencave kyçe përmes lëndës së gjeografisë.

Kompetenca qytetare

Programet mësimore të gjeografisë në klasat 10-12, si pjesë e fushës shoqëria dhe mjedisi, e cila në mënyrë të veçantë ka në fokus zhvillimin e kompetencës qytetare, krijojnë kushte për ndërtimin dhe demonstrimin nga nxënësi të kësaj kompetence.

Diskutimi, debati, punët në grup dhe ato individuale për çështje të ndryshme gjeografike, mundësojnë që nxënësi të zhvillojë aftësi dhe qëndrime, si respektimi i mendimit ndryshe, toleranca, zgjidhja paqësore e konflikteve, aftësi të pjesëmarrjes qytetare, ndërmarrja e përgjegjësisë individuale dhe kolektive dhe parashikimi i pasojave për këto çështje.

² *Kompetenca kyçe janë kompetencat për të cilat kanë nevojë të gjithë individët për plotësim dhe zhvillim vetjak, për qytetari aktive, për përfshirje sociale dhe për punësim (Fjalorth, Korniza kurrikulare për arsimin parauniversitar, MAS 2014)*

Më poshtë paraqitet një shembull ilustrues i një situatë të nxëni në lëndën e gjeografisë që mundëson zhvillimin e disa rezultateve të të nxënit të kompetencës qytetare.

Monumentet e natyrës

Situata e të nxënit:

Trashëgimia natyrore është vlerë e përcjellë brez pas brezi. Ajo është vlerë e mjedisit natyror dhe si e tillë është natyrore, por është edhe vlerë materiale e shpirtërore e shoqërisë dhe si e tillë është kulturore. Shqipëria me natyrë tepër të larmishme dhe në evolucion jashtëzakonisht të ndërlikuar, është shumë e pasur me monumente natyre. Midis këtyre monumenteve dallohen Pisha Flamur e Llogarasë, Vulfenia e Shtegut të Dhenve, Kanioni i Osunit, Liqenet e Lurës, Ujëvara e Thethit, Shpella e Zezë etj.

Lidhur me mirëmenaxhimin e Monumenteve të Natyrës, synohet që:

- menaxhimi dhe shfrytëzimi i monumentit të natyrës të bëhet vetëm për qëllime shkencore, ekologjike, kulturore, historike, turistike, kurative, didaktike dhe kurrsesi nuk duhet të dëmtojë vlerat e tij;
- t'i ofrojë përfitime popullsisë së zonës, pa dëmtuar vlerat.

Diskutim rreth situatës:

- Identifikoni disa prej monumenteve të natyrës në rajonin tuaj.
- Cilët janë faktorët natyrorë që çënojnë prishjen e monumenteve të natyrës në rajonin tuaj?
- Cili është roli i njeriut në ruajtjen/shkatërrimin e tyre?
- A keni ju përgjegjësi individuale? Nëse po, cilat janë?
- Cilat janë përgjegjësitë e komunitetit të zonës?
- Çfarë masash duhen marrë për të menaxhuar situatën?

Përmes kësaj situatë nxënësi nxitet të mendojë në mënyrë kritike, të marrë vendime dhe të veprojë për adresimin e një çështje gjeografike, duke marrë përgjegjësi individuale të cilat nxësin pjesëmarrjen qytetare.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Gjeografia e ka mjedisin një komponent të rëndësishëm dhe të natyrshëm të saj. Veprimtaritë mësimore në të cilat nxënësit angazhohen i drejtojnë drejt zgjidhjes së çështjeve të ndryshme që lidhen me mjedisin gjeografik, drejt analizës së situatave, vlerësimit të kompleksitetit dhe rëndësisë së tyre, propozimit të zgjidhjeve dhe verifikimit të vlefshmërisë së tyre.

Ndryshimet klimatike

Situatë të nxëni

Tuvalu është ose më saktë, ishte një ishull i vogël në Oqeanin Paqësor, i cili për shkak të rritjes së nivelit të oqeanit është zhdukur nga sipërfaqja e planetit. Tuvalu është një komb i vogël, por tepër homogjen. 96% e popullsisë së tij janë polinezianë. Banorët e ishullit nuk përdornin celularë dhe në ishull nuk kishte qendra interneti. Banorët e Tuvalusë tashmë kanë emigruar në Australi dhe në Zelandën e Re.

Diskutim mbi situatën:

- Cilat mendoni janë arsyet e rritjes së nivelit të oqeanit dhe zhdukjes së ishullit Tuvalu?
- Çfarë ndodh kur shumë prej këtyre ishuj – shteteve zhduken?
- Jepni gjykimin tuaj në lidhje me humbjen e kulturës dhe historisë së këtij vendi?
- Ç’ nënkupton për ju termi “emigrantë mjedisorë”?
- Ndryshimet klimatike shoqërohen me një sërë pasojash. Identifikoni tregues të ndryshimeve klimatike sot?
- Cilat janë përgjegjësitë e vendeve në lidhje me ndikimin e njeriut në ndryshimet klimatike?
- Mendoni që janë të mjaftueshme protokollet që nënshkruajnë vendet për reduktimin e ndikimit në këto ndryshime?

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

Perceptimet për mjedisin natyror dhe human që nxënësit zhvillojnë përmes gjeografisë marrin kuptim për të tjerët kur komunikohen përmes “gjuhës” së gjeografisë. Çështjet që gjeografia trajton përbëjnë tema të rëndësishme jo vetëm për komunitetin e nxënësve, por të gjithë shoqërisë (zhvillimet demografike, dukuritë natyrore, kulturat, zhvillimi urban, mjedisi etj). Në këtë kontekst krijohen mundësi për ndarjen e ideve, parashtrimin e argumenteve, artikulimin qartë të mendimit, përdorimin e fjalorit të përshtatshëm gjeografik, komunikimin përmes gjuhës së hartave dhe simboleve. Komunikimi nuk zhvillohet vetëm “pas” përfundimit të njohurive, por është parakusht për zhvillimin e tyre.

Kompetenca e të menduarit

Në vitin 2004 kur ndodhi një cunami në Oqeanin Indian, në një plazh të Tajlandës, një vajzë britanike (duke përdorur të menduarin gjeografik) kuptoi që oqeani po tërhiqej dhe kjo ishte një

shenjë që një cunami po afrohej. Thirrja e saj drejtuar autoriteteve të zonës për të evakuar plazhin shpëtoi qindra jetë.

Të menduarit gjeografik mbështet nxënësit për të zhvilluar mekanizma që i ndihmojnë të zgjidhin probleme të jetës së përditshme, të përshtaten dhe të përballojnë sfida.

Të menduarit gjeografik zhvillohet kur nxënësit:

- ndërtojnë/parashtrojnë pyetje gjeografike;
- hulumtojnë në burime gjeografike;
- mbledhin të dhëna gjeografike;
- analizojnë informacionin gjeografik;
- veprojnë mbi bazën e njohurive gjeografike.

Kompetenca e të nxënit

Kompetenca e të nxënit ka një domethënie të veçantë për aftësimin e nxënësve të nxënë gjatë gjithë jetës. Pa dyshim të nxënit në gjeografi sot mbështetet nga një sërë burimesh (libra, atlase, enciklopedi, terreni, harta, fotografi, fotografi ajrore, imazhe satelitore, diagrama, statistika, prezantime grafike etj). Teknologjia gjithashtu është bërë një mbështetje e fuqishme në këtë drejtim.

Por vetëm burimet janë të pamjaftueshme; gjeografia, përmes kërkimit gjeografik, përgatit dhe aftëson nxënësit të zhvillojnë strategji për të ndërtuar dijen mbi bazën e mbjedhjes, vlerësimit, përpunimit dhe prezantimit të informacionit gjeografik.

Kompetenca personale

Programi i gjeografisë stimulon të nxënit bazuar në kërkim, duke zhvilluar aftësinë e nxënësve për të menaxhuar veten. Përmes realizimit të detyrave, punëve individuale dhe në grup, nxënësit kuptojnë rolin e tyre në procesin e të nxënit dhe në kryerjen e hetimeve, aftësohen të jenë të pavarur në zbatimin e njohurive dhe shkathtësive, dhe në marrjen e vendimeve, zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe mësojnë të vlerësojnë perspektivat e ndryshme të anëtarëve të tjerë të grupit.

Kompetenca digjitale

Gjeografia orientohet dukshëm drejt përdorimit të medias dhe teknologjisë. Nxënësi zhvillon kompetencën digjitale, përmes përdorimit në mënyrë efektive dhe të përshtatshme të TIK-ut, kur heton për një çështje/problem gjeografik, kur kërkon një hartë, kur krijon një produkt/prezantim,

kur komunikon idetë dhe informacionin për dukuritë gjeografike, për vendin e tij, për marrëdhënien e njeriut me mjedisin.

Shembulli i paraqitur më poshtë tregon se si gjeografia mundëson zhvillimin e rezultateve të të nxëniet të kompetencës digjitale.

Ecuria e numrit të përgjithshëm të popullsisë së Shqipërisë në periudha të ndryshme

Për realizimin e kësaj teme mësimore, nxënësit mund të përdorin teknologjinë e informacionit dhe komunikimit për sigurimin e të dhënave, përpunimin e tyre dhe prezantimin e gjetjeve.

- Mësuesi orienton nxënësit të hulumtojnë në web-in (faqen) e internetit të Institutit të Statistikave, Shqipëri www.instat.gov.al.
- Për të grumbulluar të dhëna për periudha të ndryshme nga kjo faqe, nxënësit duhet të kërkojnë në dy prej rubrikave brenda faqes, të cilat janë të shpallura sapo hyn në web-in e INSTAT.
- Për të siguruar të dhëna për treguesit demografikë të popullsisë në vitin 2018, nxënësit klikojnë në rubrikën “Treguesit demografikë dhe socialë”. Pasi nxënësit kanë klikuar brenda kësaj rubrike, për gjetjen e të dhënave u drejtohen nën rubrikave “Popullsia dhe lindjet, vdekjet dhe martesat”.
- Në rubrikën “Censet”, e cila ndodhet në faqen e parë të web-it, nxënësit i drejtohen nën rubrikës “Censusi i popullsisë dhe banesave”, brenda së cilës shfrytëzojnë të dhënat e treguesve demografikë për vitin 2011 dhe 2001, në nivel kombëtar dhe sipas qarqeve të vendit.
- Të dhënat e mbledhura për të tria vitet nxënësit i organizojnë në tabela dhe përmes TIK-ut ndërtojnë organizues grafikë.
- Nxënësit interpretojnë ecurinë e numrit të përgjithshëm të popullsisë përgjatë periudhave të ndryshme, mbi bazën e interpretimit të grafikëve dhe të dhënave të siguruara.

Shënim: Kjo veprimtari mund të realizohet dhe në formën e një projekti, për realizimin e të cilit nxënësit përveç të dhënave që grumbullojnë nga hulumtimi në faqen web të INSTAT-it, mund të zhvillojnë dhe intervista me individë të ndryshëm, të cilat i regjistrojnë dhe i përfshijnë në një CD dhe së bashku me të dhënat e mësipërme i sjellin në formën e një produkti kërkimor.

IV. MODELE TË INTEGRIMIT NDËRLËNDOR BRENDA DHE JASHTË FUSHËS SË TË NXËNIT

Gjeografia është pjesë integrale e jetës së përditshme. Pothuajse çdo gjë që ne bëjmë çdo ditë është e lidhur në mënyra të ndryshme me Tokën dhe banorët e saj të cilat janë objekt i saj i studimit.

Gjeografia zbatohet në shumë fusha të jetës së përditshme, si:

- Meteorologji (matjet dhe parashikimi i motit);
- Planifikimi urban (studimi i territorit, hartografia, lëvizjet demografike; vendbanimet);
- Turizmi (peizazhi natyror, mjedisi human, aktivitetet ekonomike, trashëgimia natyrore);
- Transporti (orientimi, hartat, llojet e transportit);
- Mjedisi (roli i njeriut, pasojat e veprimtarisë njerëzore në mjedis, zhvillimi i qëndrueshëm)
- Ekonomia (potencialet natyrore dhe humane për zhvillim ekonomik, zhvillimi i sektorëve të ndryshëm të ekonomisë;
- Siguria (tërmetet, rrëshqitjet e dherave, vullkanet, përmbytjet etj).
- Etj.

Kjo është arsyeja që të mësuarit e gjeografisë është i lidhur ngushtësisht me lëndët e tjera.

Zhvillimi i kompetencave kyçe mundësohet kur sigurohen lidhje të vazhdueshme dhe të shumta ndërlëndore.

Gjatë planifikimit mësimor të lëndës së gjeografisë, mësuesit duhet të kenë në qendër të vëmendjes lidhjet integrale brenda fushës dhe me fushat e tjera të të nxënit.

4.1. Integrimi ndërlëndor brenda fushës

Gjeografia, si një ndër lëndët e rëndësishme të fushës “Shoqëria dhe mjedisi”, zhvillon lidhje të shumta me lëndët brenda fushës, në mënyrë të veçantë me historinë, qytetarinë, ekonominë.

Historia

Në arsimin e mesëm të lartë gjeografia lidhet ngushtë me njohuritë dhe aftësitë që nxënësit zhvillojnë në lëndën e historisë në lidhje me:

- zhvillimet historiko-territoriale të rajoneve më të mëdha të botës;
- ndryshimet e hartës politike të trevave shqiptare përgjatë kohërave;
- konfliktet etnike, fetare në rajone të ndryshme të botës etj.

Qytetaria

Gjeografia zhvillon lidhje me njohuritë dhe aftësitë që nxënësit zhvillojnë në lëndën e qytetarisë, si p.sh., në lidhje me: zhvillimet historiko-territoriale të rajoneve më të mëdha të botës;

- zhvillimet kulturore të rajoneve të ndryshme dhe respektimin e diversitetit kulturor;
- ndërvarësinë globale midis rajoneve dhe vendeve të ndryshme;
- përgjegjësitë individuale dhe kolektive për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e qëndrueshëm etj.

Ekonomia

Për përmbushjen e disa prej rezultateve të të nxënit të lëndës së gjeografisë përgjatë tri viteve të gjimnazit, del e nevojshme përdorimi i njohurive dhe aftësive që nxënësit zhvillojnë në lëndën e ekonomisë, si p.sh. në lidhje me:

- burimet natyrore;
- sektorët e ekonomisë (industrinë, bujqësinë, tregtinë dhe shërbimet) dhe shpërndarjen gjeografike të tyre;
- eksport-importin;
- punësimin dhe papunësinë etj.

Shembull

Lidhja ndërlëndore me HISTORINË

Paraqitja e Tokës në hartë

Situatë të nxëni

Për mijëra vjet, shumica e njerëzve mendonin se Toka ishte e rrafshët. Por që në vitin 300 p.e.s, grekët e lashtë hodhën idenë që Toka është e rrumbullakët. Megjithatë, ata vazhduan t'i skiconin hartat sikur Toka të qe e rrafshët. Ndërsa eksploronin gjithnjë e më shumë Tokën, njerëzit ishin në gjendje të skiconin në harta zona gjithnjë e më të gjera.

Veprimet në situatë:

- Për të krahasuar pasqyrimin e sipërfaqes dhe objekteve të ndryshme në hartë, mësuesi, në bashkëpunim me nxënësit, përpiqen të sigurojnë harta të vjetra dhe harta aktuale që paraqesin të njëjtën hapësirë gjeografike (p.sh., një hartë e vjetër dhe një hartë aktuale e Europës).
- Duke shfrytëzuar njohuritë që nxënësit kanë marrë në lëndën e historisë dhe përmes kërkimit në burime të ndryshme historike, nxitet diskutimi në lidhje me pyetjet e mëposhtme:
 - Cilët ishin të parët që filluan të gdhendin hartat në gur?
 - Cili ishte kontributi që solli astronomi grek Ptoleme në lidhje me pasqyrimin e Tokës në hartë?
 - Cila është arsyeja kryesore që çoi në përmirësimin e hartave?
 - Në hartat që keni gjetur, nga krahasimi midis tyre, cilat elemente të hartës së sotme paraqiten dhe në hartën e vjetër?
 - Çfarë gabimesh dalloni në hartën e vjetër?
 - Po pjesët e brendshme të Tokës të paraqitura në hartën e vjetër ofrojnë informacion të mjaftueshëm?
 - Pse mendoni ka ndodhur kjo?

Lidhja ndërlëndore me QYTETARINË dhe EKONOMINË

Globalizimi dhe tregtia globale

Situata e të nxënit

- Organizata Botërore e Tregtisë (OBT), themeluar në vitin 1995 me seli në Gjenevë (Zvicër), numëron rreth 164 vende anëtare. Kjo organizatë ka inkurajuar prosperitetin e tregtisë globale duke mundësuar hapjen ekonomike të vendeve përmes reduktimit të barrierave tregtare, rritjes së konfidencës dhe mundësive të marrëveshjeve të ndershme tregtare. Megjithatë, globalizimi nuk mirëpritet me entuziazëm nga çdokush. Kritikët e tij theksojnë që parimet e tregtisë së lirë dhe eficiencës së ekonomisë tejkalojnë vlera të tilla si, zhvillimi i qëndrueshëm, kujdesi për shëndetin, demokracia dhe mbrojtja e mjedisit.

Diskutim mbi situatën:

- Përcaktoni qëndrimin tuaj në lidhje me globalizimin dhe argumentojeni atë.
- Identifikoni avantazhe dhe disavantazhe që OBT-ja i sjell tregtisë në botë.
- Argumentoni qëndrimin tuaj në lidhje me pohimin e kritikëve të OBT-së se “Kjo organizatë mbështet më shumë zhvillimin e tregtisë globale se sa zhvillimin e komunitetit lokal”.

4.2 Integrimi ndërlëndor me fushat e tjera të të nxënit

Krahas lidhjes së gjeografisë me lëndët brenda fushës, si element i domosdoshëm për ta parë dhe studiuar botën në mënyrë globale, gjeografia ka nevojë për njohuri dhe aftësi që i zhvillojnë lëndët e fushave të tjera të të nxënit.

Integrimi ndërlëndor me fushën “Matematika”

Gjeografia zhvillon lidhje të shumta ndërlëndore me matematikën në lidhje me përdorimin e numrave, ndërtimin dhe matjen e këndeve, përcaktimin e kooordinatave gjeografike, përdorimin e shkallës së zvogëlimit dhe zmadhimit, llogaritjen e mesatares aritmetike, ndërtimin dhe interpretimin e grafikëve, diagramave etj. Programet e gjeografisë mundësojnë zbatimin e këtyre shkathtësive matematike në lidhje me temperaturën e ajrit, sasinë e reshjeve, prurjet e lumenjve, të dhënat për popullsinë, për treguesit ekonomikë etj. Në punën me hartën, nxënësit punojnë me koncepte numerike, si shkalla, largësia, koordinatat, projeksionet hartografike.

Shembull 1

Lidhja ndërlëndore me MATEMATIKËN

Ndryshimi i temperaturës në drejtim vertikal dhe përcaktimi i saj.

Kthimi i temperaturës në nivelin e detit

Temperatura në nivelin e detit është 15°C . Sa do të jetë temperatura në malin e Dajtit në lartësinë 1612 m?

Dimë që për çdo 100 m lartësi, temperatura ulet $0,6^{\circ}\text{C}$.

Për 100 m – 0,6⁰ C

Për 1612 m - X

$$X = 1612 \times 0,6 / 100 = 9,67^0 \text{ C.}$$

Temperatura në malin e Dajtit në lartësinë 1612 m do të jetë 9,67⁰ C më e ulët se në nivelin e detit.

$$15^0\text{C} - 9,67^0\text{C} = 5,33^0\text{C}$$

Pra, temperatura në malin e Dajtit do të jetë 5,33⁰ C.

Shembull 2

Lidhja ndërlëndore me MATEMATIKËN

Përcaktimi i kohës lokale

Të gjendet koha lokale e Ankarasë me gjatësi gjeografike 33⁰, kur në Tiranë me gjatësi gjeografike 20⁰, koha lokale është 13^h 05['].

- Mbështetur në hartë ndërtojmë një skicë e cila do të na ndihmojë për të përcaktuar vendndodhjen e dy vendeve, Tiranës dhe Ankarasë, në lindje apo në perëndim të njëri-tjetrit.
- Gjejmë ndryshimin e gjatësisë gjeografike midis Ankarasë dhe Tiranës e cila është 13⁰ (33⁰ - 20⁰).
- Gjejmë ndryshimin në kohë midis dy vendeve që i përgjigjet ndryshimit të gjatësisë gjeografike të shprehur në gradë si më lart. Brenda 4 minutave Toka rrotullohet 1⁰, ndërsa për t'u rrotulluar 13⁰ i duhen 52 minuta (13⁰ x 4'/ 1⁰).Ndryshimi midis kohës lokale të Ankarasë dhe Tiranës është 52'.
- Meqenëse kohën lokale të Tiranës e kemi të njohur, i shtojmë 52' dhe në këtë mënyrë përcaktojmë kohën lokale të Ankarasë (pasi Ankaraja ndodhet më në lindje të Tiranës).
 $13^h 05' + 52' = 13^h 57'$
- Koha lokale e Ankarasë është 13^h 57'.

Shembull 3

Ndërtimi i grafikëve me veçoritë e klimës


Problemi:

Si përdoren faktorët klimatikë për klasifikimin dhe krahasimin e vendeve/rajoneve të ndryshme të botës?


- Duke shfrytëzuar të dhënat që gjenden në tabelën e reshjeve mesatare mujore ndërtoni nga një grafik për secilin vend (Vinipeg/Kanada, Izmir/Turqi, Ulan Bator/Mongoli). Në boshtin vertikal vendosni sasinë mesatare të reshjeve, ndërsa në boshtin horizontal vendosni muajt. Grafikët të ndërtohen brenda të njëjtëve boshte në mënyrë që të krahasohen.
- Duke shfrytëzuar të dhënat që gjenden në tabelën e temperaturave mesatare mujore ndërtoni nga një grafik për secilin vend. Në boshtin vertikal vendosni treguesit e temperaturave mesatare, ndërsa në boshtin horizontal vendosni muajt.

Vinipeg, Kanada												
Muaji	J	Sh	M	P	M	Q	K	G	Sh	T	N	DH
Temp (°C)	-16	-8	1	5	12	15	21	20	13	7	-1	-14
Reshjet (mm)	18	0	17	6	61	182	136	95	60	13	50	28
Izmir, Turqi												
Muaji	J	Sh	M	P	M	Q	K	G	Sh	T	N	DH
Temp (°C)	8	9	11	15	19	24	26	26	23	18	14	10
Reshjet (mm)	126	95	77	47	29	11	6	5	15	41	84	144
Ulan Bator, Mongoli												
Muaji	J	Sh	M	P	M	Q	K	G	Sh	T	N	DH
Temp (°C)	-23	-17	-8	2	10	15	18	17	9	0	-12	-20
Reshjet (mm)	10	10	10	10	20	50	30	30	30	10	10	10

Grafiku i temperaturave mesatare për të tri vendet



Grafiku i sasisë mesatare të reshjeve (në mm) për të tri vendet




- Referuar grafikëve dhe të dhënave:
 - Cili nga rajonet klimatike të Evropës është i ngjashëm me klimën e Vinipegut? Po me Izmirin? Po me Ulan Batorin? Shpjegoni përgjigjet tuaja.

- Cili nga qytetet ka temperaturën më të lartë në dimër? Po më të ultën?
- Cili qytet ka luhatjen më të madhe të temperaturave nga dimri në verë? Po më të ultën?
- Cili qytet ka verën më të thatë? Po më të lagështën?
- Cili qytet ka dimrin më të thatë? Po më të lagështin?

Integrimi ndërlëndor me fushën “Shkencat e natyrës”

Lënda e gjeografisë për vetë karakterin e saj ndërdisiplinor krijon lidhje të shumta me lëndët e shkencave të natyrës.



Shembull

Lidhja ndërlëndore me BIOLOGJINË

Situatë të nxëni

Deti Adriatik është pjesë e detit Mesdhe dhe ndan gadishullin Apenin nga gadishulli i Ballkanit. Kërcënimet më serioze me të cilat deti Adriatik po përballet sidomos gjatë 50 viteve të fundit kanë të bëjnë me mbipeshkimin, eutrofizimin, mungesën e oksigjenit, degradimin e kateve detare dhe ndotjen nga kimikatet etj. Delfinët kanë qenë ndër llojet më të përhapura të gjitarëve

të detit në rajonin e detit Adriatik dhe Jon. Në librin e kuq të faunës shqiptare, “mbipopullata” mesdhetare e delfinëve me turi të zgjatur përcaktohet si një lloj tepër i rrezikuar.

Veprime në situatë:

Zhvillohet me nxënësit diskutimi rreth pyetjeve:

- Cilët janë disa prej faktorëve të mundshëm që mund të kenë çuar në rënien e numrit të delfinëve?
- Çfarë masash mund të merren për monitorimin e situatës? Po për përmirësimin e saj si mund të ndikohet?
- Njihni raste të tjera të degradimit të ekuilibrit ekologjik të ekosistemit në Detin Adriatik?

Nxënësit hulumtojnë në burime të informacionit mbi migrimin e algës së gjelbër tropikale nga deti Adriatik në pjesën veriore të Detit Mesdhe. Pse po ndodh një dukuri e tillë? Po Poseidonia?

Shembull

Lidhja ndërlëndore me FIZIKËN

Situatë të nxëni

Temperatura e bërthamës së brendshme të Tokës është rreth 5000°C , ndërsa temperatura e bërthamës së jashtme fillon nga 2200°C . Megjithatë bërthama e jashtme është e lëngët, ndërsa bërthama e brendshme është e ngurtë.

Diskutim rreth situatës:

- Shpjegoni si është e mundur një gjë e tillë?
- Çfarë i bind shkencëtarët se bërthama e brendshme është e ngurtë? Cila veti e valëve P (primare/gjatësore) është studiuar nga shkencëtarët?
- Çfarë ndodh me valët P kur kalojnë në lëng?
- Po valët S (sekondare/tërthore), çfarë ndodh me to kur kalojnë në një shtresë të lëngshme?
- Cilat janë më të shpejta, valët P apo S?

Shembull

Lidhja ndërlëndore me KIMINË

Eksperiment

Formimi i ujërave artezianë

Në një enë qelqi ose në një enë tjetër çfarëdo vendosim një shtresë argjile të lagur dhe mbi të një shtresë rëre të trashë, të situr dhe të thatë. Mbi këtë shtresë rëre vendosim një shtresë argjile të ngjeshur.

Hedhim ujë nga lart në shtresën e rërës, deri në atë masë sa e gjithë kjo shtresë të mbushet me ujë (të ngopet). Më pas ngulim një tub prej qelqi në pjesën e ulur, deri në atë thellësi sa të arrijë shtresën e rërës së ngopur me ujë. Uji do të ngrihet lart në sipërfaqe, në formën e një shatërvani, ashtu sikurse ndodh në pusët arteziane.

Integrimi ndërlëndor me lëndët e fushës “Gjuhët dhe komunikimi”

Gjuha shqipe është themelore për të nxënëit e nxënësve. Me lëndën e gjuhës integrohen njohuritë dhe aftësitë për hartimin e eseve, komunikimin dhe prezantimin e informacioneve, përdorimin e fjalorit gjeografik, përdorimin drejtë strukturës dhe rregullave standarde të drejtshkrimit të gjuhës shqipe në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit etj.

Integrimi ndërlëndor me fushat e tjera të të nxënëit

Gjeografia krijon lidhje me fushat e tjera të të nxënëit dhe lëndët që i përbëjnë ato, si **Teknologjinë** (aparaturat për matjen e temperaturës, lagështirës, erës, shtypjes atmosferike etj); **TIK** (për hulumtimin për informacione dhe të dhëna të ndryshme, përdorimin e Google maps për përcaktimin e vendndodhjes, nxënësit përdorin word-processor në shkrimin e materialeve, projekteve dhe punëve praktike, përdorin excel për hedhjen e të dhënave dhe ndërtimin e grafikëve, përdorin power-point për prezantimin e produkteve etj); **Arte** (vizatime, skema, modelimin e maketeve, si psh., të sistemit diellor, të vullkanit etj).

Shembull

Tema: Trashëgimia natyrore e Shqipërisë, pasuri e rëndësishme për zhvillime të caktuara rajonale

Klasa 11

Nxënësi:

- Evidenton disa ndër sitet e trashëgimisë natyrore të vendit tonë.
- Hulumton në burime të ndryshme informacioni mbi zonat e mbrojtura të vendit tonë, pasurinë që ofrojnë dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e turizmit.
- Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.
- Përdor TIK për grumbullimin, përpunimin e të dhënave dhe prezantimin e gjetjeve.

Për përmbushjen e rezultateve të të nxënit të kësaj teme, mësuesi mund t'u japë nxënësve si detyrë të përgatitin *një poster me temë “Trashëgimia natyrore e Shqipërisë”*.

Lidhja ndërlëndore me GJUHËN SHQIPE, TIK dhe ARTE

- *Nxënësit duhet të kërkojnë informacion në lidhje me temën e propozuar, pikënisur nga termat kyçe të temës mësimore (lidhja me TIK). Mirë është që mësuesi të përcaktojë më parë adresat dhe faqet web në të cila nxënësi do të kërkojë informacionin. Informacioni i mbledhur duhet seleksionuar, përpunuar dhe organizuar.*
- *Nxënësit do të përgatisin posterin, i cili duhet të prezantojë (lidhjen me Gjuhën shqipe dhe Artet):*
 - *Dokumente të ndryshme (foto, vizatime, skema, harta, grafika) të shoqëruara më një legjendë që jep shpjegime.*
 - *Tekst që përfshin: titullin (i qartë dhe i saktë), nëntituj (të shkurtër), paragrafë (të shkurtër, me fjalë ose shprehje të theksuara).*
 - *Të respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe të bëhet kujdes në balancën e teksteve me ilustrimet.*

V . TEMAT NDËRKURRIKULARE

Temat ndërkurrikulare janë tema/çështje madhore me të cilat përballet shoqëria. Ato i shërbejnë zhvillimit të kompetencave dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme. Lënda e gjeografisë mundëson zhvillimin e temave ndërkurrikulare, me fokus të veçantë temat/çështjet:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave
- Zhvillimi i qëndrueshëm
- Mjedisi
- Ndërvarësia
- Bashkëjetesa paqësore

Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Si një disiplinë me karakter të thellë ndërdisiplinor, duke studiuar ndërveprimet komplekse midis natyrës dhe shoqërisë, Gjeografia mund të sjellë një kontribut të rëndësishëm për të mbështetur arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Gjeografia ndihmon për edukimin e nxënësve për Zhvillimin e qëndrueshëm dhe Mjedisin.

Duke analizuar marrëdhëniet e shoqërisë me mjedisin nga perspektiva e menaxhimit të përgjegjshëm, nxënësi mëson të vendosë lidhje midis nevojave dhe përdorimit racional të burimeve. Ai ndërgjegjësohet për aspektet shoqërore të konsumit, për implikimet e globalizmit për shoqërinë dhe shpërndarjen e burimeve. Ky ndërgjegjësim e ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë ndërvarësinë e mjedisit nga veprimtaria njerëzore.

Gjeografia mund të ofrojë një perspektivë lokale dhe globale për një sërë çështjesh të ndërlidhura me zhvillimin e qëndrueshëm, si për shembull:

- menaxhimi i integruar i burimeve ujore, vlerësimi i ekosistemeve të lidhura me ujin në zona të ndryshme gjeografike;
- shpërndarja hapësinore e burimeve të rinovueshme të energjisë në zona të ndryshme gjeografike;
- modelet e urbanizimit, planifikimi dhe menaxhimi i vendbanimeve, vlerësimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore, vlerësimi i rrezikut nga fatkeqësitë, ndikimet mjedisore të qyteteve;

- ndryshimet klimatike, rreziqet e lidhura me klimën dhe fatkeqësitë natyrore, ekspozimi dhe cënueshmëria e komuniteteve ndaj rreziqeve të lidhura me klimën, edukimi dhe ndërgjegjësimi në drejtim të përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike;
- ekosistemet detare dhe ndotja detare, menaxhimi i qëndrueshëm i ekosistemeve bregdetare, turizmi i qëndrueshëm;
- përdorimi i qëndrueshëm i ekosistemeve të ujërave të ëmbla, degradimi i tokës, shpyllëzimi, vlerësimi i thatësirës dhe përmytjeve, biodiversiteti.

Ndërvarësia

Përmes lëndës së gjeografisë nxënësit mësojnë për ndërvarësinë e dukurive gjeografike ndërmjet vendeve dhe rajoneve të ndryshme të botës. Ndërvarësia midis vendeve dhe rajoneve shprehet në aspektin ekonomik, politik, social, mjedisor. Kështu për shembull, në tema mësimore që trajtojnë klimën dhe ndryshimet klimatike, mësuesi bën kujdes të prekë një aspekt të rëndësishëm të ndikimit të ndryshimeve klimatike, ndërvarësinë ndërmjet ndryshimeve klimatike dhe migrimeve të popullsisë (p.sh., për shkak të burimeve të kufizuara të ujit të pijshëm, rritjes së nivelit të detit dhe pasojave që lidhen me të, ndryshimeve të mëdha të temperaturave dhe uljes së sasisë së reshjeve etj). Në këtë mënyrë nxënësit ndërgjegjësohen për ndikimin që kanë ndryshimet klimatike në jetën e njerëzve dhe në lëvizjen e tyre.

Nxënësi ndërgjegjësohet për të drejtat e tij, ndërvarësinë e njerëzve, konfliktet ndërkombëtare, dhe nevojën për të zhvilluar kulturën e paqes. Kjo e ndihmon atë të jetë mendjehapur dhe të respektojë diversitetin, të kuptojë domethënien e veprimeve në një territor të caktuar, të pozicionohet për një çështje të caktuar dhe të hulumtojë mbi dukuritë globale.

Disa veçori të planifikimit dhe integritit të temave ndërkurrikulare

Integrimi i temave/çështjeve ndërkurrikulare në lëndën e gjeografisë bazohet në trajtimin e veprimtarive të planifikuara si material plotësues për tema të caktuara mësimore. Mësuesi kur ndërton planin e periudhës, në varësi të rezultateve të të nxënit që do të zhvillohen përgjatë periudhës, identifikon çështjet ndërkurrikulare që do të integrojnë dhe temat mësimore ku mundësohet integrimi i këtyre çështjeve, duke bërë të mundur që planifikimi i tyre si kroskurrikul të mos i lihet spontanitetit.

Trajtimi i çështjeve ndërkurrikulare në tema të caktuara mësimore të lëndës së gjeografisë duhet të bëhet në mënyrë të natyrshme, në mënyrë që çështja e dhënë të mos jetë një hallkë shtesë në procesin mësimor.

Mësuesi gjithmonë bën kujdes që të përcaktojë rezultate të nxëni dhe veprimtari që mbështesin të nxënëit e nxënësve për temën/çështjen ndërkurrikulare.

Më poshtë janë përshkruar shembuj veprimtarish mësimore për trajtimin e disa prej temave ndërkurrikulare në lëndën e Gjeografisë.

Klasa e 11-të

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi:

- ✗ analizon procesin e migrimit si promotorin e të gjitha ndryshimeve demografike të popullsisë shqiptare, duke u ndalur në periudhën pas vitit 1990;
- ✗ evidenton territoret ku kanë migruar shqiptarët me veçoritë dhe problemet e integritetit të tyre;
- ✗ vlerëson diversitetin shoqëror, kulturor dhe mjedisor dhe respektimin e këtij diversiteti;
- ✗ ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përfutuara nga vëzhgimet.

Temat/çështjet ndërkurrikulare:

Identiteti kombëtar

- ✗ Tiparet dalluese të migrimit të popullsisë shqiptare.
- ✗ Ruajtja e gjuhës, traditave në vendet ku kanë emigruar dhe emigrojnë.

Njohja e kulturave, bashkëjetesa paqësore

- ✗ Bashkëjetesa me gjuhën, traditat e popullsisë së vendeve pritëse.
- ✗ Përfitimet arsimore, kulturore dhe profesionale në vendet mikpritëse.

Ndërvarësia


- ✗ Integrim në jetën socio-ekonomike në vendet ku shqiptarët kanë migruar.
- ✗ Shkëmbim i ndërsjellë shumë dimensional.


Veprimtaritë mësimore:

Nxënësit paraprakisht janë ndarë në grupe dhe çdo grup ka detyrat e tij.

- 📖 **Grupi 1:** Nxënësve u kërkohet të intervistojnë prindërit, të afërmit apo të njohurit të cilët kanë patur apo kanë një eksperiencë emigruese; të marrin nga to informacion për: vendet (shtetet)

ku kanë emigruar, gjuhën që kanë mësuar atje, profesionin dhe marrëdhëniet me popullsinë pritëse, ngjashmëritë dhe dallimet kulturore.

 **Grupi 2:** Nxënësve u kërkohet të dalin në zonën e tyre të banimit dhe të vëzhgojnë duke marrë informacion për emrat e bizneseve (bare, restorante, pastiçeri etj) që mbajnë një emër në gjuhën e huaj; nxënësit evidentojnë gjuhën e huaj mbizotëruese dhe shtetin përkatës (foto, video).

 **Grupi 3:** Nxënësve u kërkohet të intervistojnë persona të ndryshëm dhe të marrin informacion në lidhje me lëvizjet e tyre: nëse preferojnë ose jo të largohen drejt një zone tjetër banimi (urbane ose rurale), brenda ose jashtë qytetit/fshatit, brenda ose jashtë vendit, arsyet e lëvizjes, përfitimet dhe pasojat.

Diskutim mbi situatën e të nxënit

- ✎ Cilat janë gjetjet e secilit grup?
- ✎ Pse në vendin tonë me kushte natyrore të favorshme migrimi i brendshëm ka kryesisht drejtimin nga zonat periferike drejt qendrave më të mëdha urbane?
- ✎ Cilat janë shkaqet e emigracionit të jashtëm në Shqipëri?
- ✎ Cilat janë pasojat e emigracionit të jashtëm të shqiptarëve?
- ✎ Cilat janë masat apo strategjitë që duhen ndjekur për kontrollin e emigracionit dhe migrimit të brendshëm?

Klasa e 10-të

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi:

- ✎ analizon ndikimin e veprimtarisë njerëzore në mjedisin gjeografik dhe anasjelltas;
- ✎ parashikon rrugë dhe mundësi të zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor;
- ✎ hulumton për raste të keqmenaxhimit të burimeve natyrore në vendin tonë;
- ✎ propozon alternativa dhe strategji të mundshme të mbrojtjes së mjedisit.

Temat/çështjet ndërkurrikulare:

Mjedisi dhe Zhvillimi i qëndrueshëm

- ✎ Konceptet themelore të mjedisit gjeografik dhe ekosistemeve.
- ✎ Zhvillimi i qëndrueshëm mjedisor.
- ✎ Roli i veprimtarisë njerëzore në mjedisin gjeografik.

Ndërvarësia

- Bashkëveprimin njëri-mjedis.
- Pasojat mjedisore.
- Masat për të mbrojtur mjedisin gjeografik në nivel lokal, rajonal e global.
- Ndotja si proces global.
- Etj.

Veprimtaritë mësimore:

Situata e të nxënit

Pyetësor 1

A jeni ju një qytetar “eko”?

1. Shkoni në shkollë:
 - A) me makinë
 - B) me autobus
 - C) në këmbë
 - D) me biçikletë
2. E përdorni pjesën e pasme të një flete të përdorur? **PO JO**
3. E praktikoni ndarjen e diferencuar të mbetjeve (riciklimin)? **PO JO**
4. E mbyllni dritën e dhomës pasi largoheni prej saj? **PO JO**

Pyetësor 2

Përgjegjësia personale

1. Cila nga alternativat e mëposhtme përcakton stilin tuaj të jetesës? Qarkoni të gjitha ato që ju aplikoni.
 - Përdor transportin publik
 - Përdor biçikletën/ ecën në këmbë
 - Merrem me sport
 - Bëj punë vullnetare
 - Fik dritat për të kursyer energjinë
 - Përdor sa më pak qese plastike
 - Ricikloj
 - Printoj dhe fotokopjoj letrat nga të dyja anët
 - Nuk qëndroj gjatë në dush (maksimumi 5 minuta)

- ☒ Asnjë nga këto.
- 2. Sa dakord jeni me këtë fjali? Unë kam **PËRGJEGJËSI PERSONALE** për të ndihmuar mjedisin në çështje të tilla si: mbeturinat, konsumimi i burimeve natyrore dhe përdorimi i ujit.
- A) Shumë dakord
- B) Dakord
- C) Pak dakord
- D) Aspak dakord

Diskutim mbi situatën e të nxënit

- ☒ Cilat janë gjetjet e pyetësorëve?
- ☒ A jeni ju qytetar “eko”?
- ☒ Si e ndotim ne mjedisin?
- ☒ Sa miqësorë jemi me mjedisin dhe Tokën?
- ☒ Pse ndotja sot konsiderohet proces GLOBAL?
- ☒ Cila është përgjegjësia personale e secilit prej nesh në respekt të mjedisit?
- ☒ Cilat janë rrugët dhe mundësi për parandalimin e ndotjeve apo ndërhyrjeve në mjedis?
- ☒ Si mund të trajtojmë pasojat mjedisore?
- ☒ Etj .

Temat ndërkurrikulare përmes përdorimit të fotove (imazheve), simboleve dhe vizatimeve (në faza të ndryshme të orës mësimore dhe të veprimtarive praktike)

Gjeografi 11	
Rezultatet e të nxënit	
Nxënësi:	
<ul style="list-style-type: none"> ☒ evidenton tiparet e përgjithshme të strukturës së popullsisë së Shqipërisë; ☒ analizon grafikë (foto, figura) të strukturës së popullsisë dhe hartat e shpërndarjes gjeografike të saj; ☒ identifikon karakteristikat kulturore të popullsisë. 	
Tema/temat ndërkurrikulare	Njohja e kulturave
	<ul style="list-style-type: none"> ☒ Karakteristikat kulturore ☒ Grup etnokulturor

	<ul style="list-style-type: none"> ✎ Migrimet e vazhdueshme të popullsisë rome dhe shpërndarja hapësinore e kulturës.
	<p>Ndërvarësia</p> <ul style="list-style-type: none"> ✎ Ndikimi i proceseve kulturore në ndërvarësinë dhe bashkëpunimet në nivel rajonal dhe global. ✎ Strategjitë ndërsektoriale dhe planet e veprimit në nivel lokal e kombëtar.
Metodologjia	<i>Imagjinatë e drejtuar, brainstorming, pyetje-përgjigje etj</i>
Veprimtaritë mësimore	<i>Diskutime për foton apo figurën</i>
<p>📖 Figura (foto) e dhënë tregon flamurin e popullsisë rome (struktura etnike e popullsisë në Shqipëri).</p> <p>Pasi vëzhgojnë foton e dhënë zhvillohet me nxënësit diskutimi rreth pyetjeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✎ Cili është kuptimi i ngjyrave të përdorura në flamur? ✎ Cili është kuptimi i rrotës së kuqe në qendër të flamurit? ✎ Identifikoni me ndihmën e hartës shpërndarjen hapësinore të popullsisë rome në vendin tonë? ✎ Cilat janë strategjitë, planet e veprimit në mbështetje të të drejtave të popullsisë rome? ✎ Nxënësve u kërkohet të gjejnë informacion për historinë, traditat, kulturën, gjuhën rome dhe ta prezantojnë në klasë. 	



Gjeografi 12

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi:

- Identifikon karakteristikat kulturore të vendeve dhe të rajoneve të ndryshme të botës.

Tema ndërkurrikulare: Njohja e kulturave

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve : *Imagjinatë e drejtuar, brainstorming, etj*

Veprimtaritë: Përmes fotove apo imazheve nxënësit diskutojnë dhe nxjerrin përfundime:

- ⚙ Cilat janë karakteristikat socio-kulturore të popullsisë së Rajonit të Azisë Lindore?



Simbol i kulturës kineze

- ⊗ Si ndryshon struktura etnike e fetare e këtij rajoni në krahasim me rajonet e tjera aziatike?
- ⊗ Sa dhe si përdoret ky simbol në Europë e më gjerë?

Klasa 10

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi:

- Analizon ndikimin pozitiv dhe negativ të veprimitarisë së njeriut në mjedis.

Tema ndërkurrikulare: Mjedisi, Zhvillimi i qëndrueshëm Ndërvarësia.



Situata klimatike në Arktik.....

Metodologjia dhe veprimitaritë e nxënësve : *Imagjinatë e drejtuar, studim rasti, etj.*

Veprimitaritë: Nxënësit përmes fotove dhe fakteve diskutojnë për pasojat e ndryshimeve klimatike, identifikojnë treguesit e këtyre ndryshimeve.

Diskutimi shoqërohet dhe me leximin e të rejave më të fundit me fokus ndryshimet klimatike.

“Akullnajat në botë në vitin 2022 janë shkrirë me një shpejtësi të paprecedentë. Sipas Organizatës Botërore Meteorologjike akulli i detit në Antarktidë **ka arritur nivelin më të ulët historik që nga viti 1970, kur filloi të matet mbulimi i akullit të detit.**”

Temat ndërkurrikulare përmes përdorimit të hartave, skicave dhe grafikëve (në faza të ndryshme të orës mësimore dhe të veprimitarive praktike)

Gjeografi 10

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi:

- ☒ analizon rrymat oqeanike, lëvizjen dhe faktorët që ndikojnë në formimin e tyre;
- ☒ identifikon llojet e rrymave oqeanike;
- ☒ dallon rëndësinë e tyre për jetën në Tokë dhe ndikimin në të gjithë elementet e mjedisit gjeografik;
- ☒ interpreton rolin e mjedisit fizik në jetën e rajoneve të ndryshme (popullsinë, vendbanimet, ekonominë, turizmin etj.).

Tema/temat ndërkurrikulare	Ndërvarësia dhe Mjedisi <ul style="list-style-type: none"> ☒ Ndërvarësia globale në shkëmbimet e elementeve fizikë të mjedisit gjeografik. ☒ Ndërveprimi i komponentëve të gjeosistemeve me aktivitetin njerëzor. ☒ Roli i mjedisit fizik në jetën e rajoneve të ndryshme.
Metodologjia	<i>Imagjinatë e drejtuar, diskutim për njohuritë paraprake, përvijim i të menduarit, Paraqitja me diagram, përdorimi i hartave, etj</i>
Veprimtaritë	<i>Punë në grupe dhe diskutime për dukurinë e treguar në hartë</i>
<p>📖 Harta e dhënë tregon lëvizjen e rrymave oqeanike dhe veçoritë fizike të tyre. Nxënësit në grupe mbështetur dhe në hartën e dhënë diskutojnë dhe nxjerrin përfundime:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⚙️ Cili është drejtimi i lëvizjes së rrymave të ftohta dhe të ngrohta oqeanike? ⚙️ Si ndryshon klima dhe elementet e tjerë të mjedisit gjeografik në vendet që ndikohen nga rrymat oqeanike të ngrohta dhe të ftohta? ⚙️ Pse në brigjet lindore të Atlantikut klima është më e butë (Europa Perëndimore) se në brigjet perëndimore të tij (brigjet lindore të Amerikës Veriore)? ⚙️ Si ndikon ky ndryshim në jetën e rajoneve në brigjet lindore e perëndimore të Atlantikut. <div style="text-align: center;"> </div>	

Temat ndërkurrikulare përmes përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (gjatë zhvillimit të projekteve, të veprimtarive praktike apo në ditë të veçanta si Dita e Tokës)

Gjeografi 10,11,12	
Rezultatet e të nxënit	
Nxënësi:	
<ul style="list-style-type: none"> ☒ analizon ndikimin e veprimtarisë njerëzore në mjedisin gjeografik dhe anasjelltas; ☒ parashikon rrugë dhe mundësi të zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor; ☒ hulumton për raste të keq menaxhimit të burimeve natyrore në vendin tonë; ☒ propozon alternativa dhe strategji të mundshme të mbrojtjes së mjedisit. 	
Tema/temat ndërkurrikulare	Mjedisi, zhvillimi i qëndrueshëm, Ndërvarësia Njohja e kulturave.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	<i>Imagjinatë e drejtuar, mbajtja e strukturuar e shënimeve, diskutim për njohuritë paraprake, studim rasti, prezantime audio-vizuale, përdorimi i teknologjisë/internetit etj.</i>
Veprimtaritë	
<ul style="list-style-type: none"> 📖 Nxënësit shohin dokumentarë, filma dhe diskutojnë mbi çështjet kryesore që trajtohen si: filmi “Planeti plastik” (ose pjesë të tij). Filma dhe dokumentarë: I Am Greta; Our Planet, etj. 📖 Nxënësit kontribuojnë si qytetarë aktivë në mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e planetit duke përdorur aplikacione të ndryshme si AWorld app (Your Guide for Living Sustainably; In support of actnow). 	

VI. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES-NXËNIES NË GJEOGRAFI

Metodat, teknikat, strategjitë e të nxënit/mësimdhënies në lëndën e gjeografisë janë faktorë të rëndësishëm për një mësimdhënie të suksesshme që nxit interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve.

Mësimdhënia e gjeografisë përshkohet nga disa parime të mësimdhënies/nxënies mbi të cilat bazohet kurrikula e AML-së dhe që mësuesit duhet t'i marrin parasysh në planifikimin e strategjive të mësimdhënies:

- *Të nxësh do të thotë të pasurosh përvojën tënde me një përvojë të re. Mësimdhënia e gjeografisë mban fort parasysh njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet paraprake të nxënësve dhe e planifikon të nxënit mbi bazën e tyre.*
- *Mësimdhënia/nxënia e gjeografisë planifikohet bazuar në rezultatet e pritshme të të nxënit.*
- *Të zotërosh njohuri dhe aftësi do të thotë të jesh në gjendje t'i përdorësh ato gjatë gjithë jetës. Sprova më e madhe në lidhje me zhvillimin e kompetencave është zbatimi nga nxënësi i njohurive dhe aftësive të përfuara në situata të pahasura më parë prej tij.*
- *Nxënësi, si partner i mësuesit në mësimnxënien e tij ndihmon në bërjen e mësimdhënies më tërheqëse.*
- *Mësimdhënia-mësimnxënia e integruar përafron më mirë dijet njerëzore, të cilat kurrikula e zbatuar merr përsipër t'i zhvillojë.*
- *Mësimdhënia-mësimnxënia e gjeografisë zhvillohen mbi bazën e burimeve të shumëllojshme të informacionit.*
- *TIK-u mbështet dhe lehtëson të nxënit e nxënësve.*
- *Mësimdhënia-nxënia e gjeografisë duhet të krijojë një klimë bashkëpunimi në klasë me qëllim nxitjen e interesit dhe motivimin e nxënësve.*

Përdorimi i metodave, teknikave dhe strategjive ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse duhet konsideruar një proces didaktik që pasurohet gjithnjë me elemente të rinj dhe zbatohet në mënyrë krijuese. Programet e gjeografisë u japin mësuesve liri profesionale përmes së cilës mund të kërkojnë dhe zbatojnë shumëllojshmëri metodash dhe teknikash.

Gjatë orëve të ndryshme të mësimin, metodat ndërthuren me njëra-tjetrën aq sa është e vështirë të dallosh kufijtë midis tyre.

Në vëmendje!

- ✓ *Metodat e mësimdhënies u adresohen nxënësve dhe plotësojnë nevojat e tyre.*
- ✓ *Veprimtaritë e të nxënit duhet të synojnë zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik dhe krijues të të gjithë nxënësve.*
- ✓ *Përdorimi i një larmie metodash mësimore përbën një domosdoshmëri pasi nxënës të*

ndryshëm mësojnë në mënyra të ndryshme. Në përzgjedhjen dhe përdorimin e metodave dhe teknikave të të nxënësve/mësimdhënies, mësuesi duhet të bëjë kujdes që ato të jenë në përputhje me stilet e ndryshme të të nxënësve.

Mësuesi i gjeografisë duhet të jetë i kujdesshëm në përzgjedhjen e metodave dhe strategjive që nxisin punën me nxënës të talentuar dhe ata që kanë vështirësi në të nxënë.

Nxënës të me vështirësi në të nxënë

Shumë nxënës me vështirësi në të nxënë arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënësve si nxënës të tjerë, nëse bëhen përshtatje në mënyrën e mësimdhënies. Për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm të realizimit të kompetencave, mësuesi përzgjedh teknikat dhe metodat më të përshtatshme që u japin mundësi këtyre nxënësve të përmbushin rezultatet e të nxënësve.

Nxënës të talentuar

Mësuesit duhet të krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënës të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre. Kjo arrihet nëse nxënësve u krijohen mundësi të punojnë me një përmbajtje më të thelluar dhe zgjeruar, të zhvillojnë në mënyrë të vazhdueshme elemente specifike të kompetencave kyçe (p.sh.: aftësitë e nivelit të lartë konjitiv të kompetencës së të menduarit) dhe specifike të fushës, të fokusohen në çështjet kroskurrikulare, të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënësve brenda dhe jashtë shkollës. Për të mundësuar këtë, mësuesit përzgjedhin dhe përdorin metoda dhe teknika që zhvillojnë kuriozitetin, nxisin kërkimin gjeografik, zhvillojnë rrahjen e mendimeve dhe aftësitë konkurruese etj., si **debati, konkursi gjeografik, kuizet, udhëtimet imagjinare** etj.

Strategjitë e të nxënësve/mësimdhënies në gjeografi përfshijnë:

- **Teknikat dhe metodat e punës në grup** në të cilat bëjnë pjesë diskutimi, puna në grupe të vogla, grupet e ekspertëve, loja me role, puna në dyshe etj.
- **Teknikat dhe metodat e hulumtimit** në të cilat bëjnë pjesë studimi i rastit, puna me projekte, ekskursioni, vrojtimi, zgjidhja e problemit etj.

6.1. Shembuj të përdorimit të metodave dhe teknikave të të nxënës/ mësimitdhënies në gjeografi

VROJTIMI

Vrojtimi është një metodë që e vendos nxënësin në rolin e vëzhguesit, duke kërkuar që ai të vëzhgojë dhe të mbajë shënim për gjithçka që ndodh gjatë procesit ose të fotografojë raste të veçanta gjatë vrotimit, të përpunojë dhe të publikojë përfundimet.

Një karakteristikë e rëndësishme e kërkimit gjeografik është se një pjesë e mirë e tij zhvillohet në mjedise të jashtme. *Puna në terren*, ku zbatohen metodat kërkimore shkencore për veçoritë dhe proceset gjeografike, është në thelb aspekt i gjeografisë. Nxënësit vëzhgojnë, masin dhe mbledhin të dhëna, bëjnë parashikime, ngrejë hipoteza dhe nxjerrin përfundime rreth vendeve, ngjarjeve dhe dukurive që ata shikojnë.

Vrojtimi është një metodë shumë e përdorshme, si përsa i takon dukurive dhe proceseve në mjedisin fizik, ashtu dhe në mjedisin human. Për shembull, nëse nxënësit do të vrottojnë fenomenin e erozionit nga forcat e jashtme, atëherë kërkohet kohë e mjaftueshme për të kryer vëzhgimet, një aparat fotografik për të fiksuar raste tipike etj. Po kështu për të hulumtuar në lidhje me vendbanimet, popullsinë dhe lëvizjet e saj etj., nxënësve u duhet të kryejnë vëzhgime në zonën/rajonin që kanë marrë në studim.

Shembull

Vrojtimi i reve dhe parashikimi i motit

Qëllimi i kësaj veprimtarie është që nxënësit të zhvillojnë parashikime të motit bazuar në vëzhgimet e formave dhe përmasave të reve.

- Për realizimin e kësaj veprimtarie mësuesi mund të organizojë punën në grupe të vogla ose në çifte.
- *Parapërgatitja.* Ky hap ka të bëjë me paraqitjen para nxënësve të dukurisë që do të vëzhgohet, njohjen me qëllimin, kohën dhe mënyrën e mbajtjes së shënimeve dhe dokumentimin. Mësuesi udhëzon nxënësit të vëzhgojnë në lidhje me:
 - Format dhe përmasat e reve.
 - Ndryshimet që pëson moti gjatë ditëve që kryhet vëzhgimi.

Përgjatë një jave nxënësit duhet të kryejnë vëzhgimet dhe të grumbullojnë të dhëna.

- *Përpunimi i të dhënave.* Sipas udhëzimeve të mësuesit nxënësit përpunojnë të dhënat duke përgatitur montim të fotove, përpunim të të dhënave të motit etj.
- *Raportimi i përfundimeve.* Nxënësit raportojnë në klasë dhe shpallin përfundimet e vrojtimit që kanë kryer.

DISKUTIMI

Diskutimi është një nga metodat më të thjeshta që përdoret në realizimin e veprimtarive mësimore kur është fjala për të mundësuar procesin e pjesëmarrjes sa më të gjerë të nxënësve në mësim. Diskutimi fillon në çastin kur nxënësit drejtojnë pyetje dhe kur një nxënës përgjigjet për atë që ka thënë një nxënës tjetër. Pra, kjo ***metodë është një përzierje e shpjegimeve mësues-nxënës, e shkëmbimit të pikëpamjeve dhe pyetjeve ndërmjet tyre.***

Diskutimi me të gjithë klasën është një mënyrë shumë e mirë për mësuesin dhe për nxënësit për të zbuluar se cilat janë qëndrimet e tyre rreth çështjeve, fenomeneve dhe koncepteve të ndryshme që trajtohen në gjeografi. Kur mësuesi vendos të organizojë diskutimin në klasë merr parasysh dy momente vendimtare:

- *E para*, mënyrën e sistemimit të klasës, aty ku është e mundur. A është i përshtatshëm vendi për organizimin e nxënësve, aq sa ata të shohin dhe të dëgjojnë njëri tjetrin?
- *Së dyti*, deri në ç' masë dhe gjerësi mësuesi ka ndërmend të drejtojë diskutimin? Udhëheqja e tij kontribuon në forcimin e rrjedhshmërisë së mendimit dhe zhvillimin e asaj që është thënë.

Për mësuesin dhe nxënësit është shumë e rëndësishme që të ketë një atmosferë të respektit reciprok gjatë zhvillimit të diskutimit. Për këtë arsye, nxënësit bashkë me mësuesin, që në fillim të vitit vendosin “rregullat e diskutimit” në mënyrë që të kenë një diskutim të hapur dhe të vërtetë.

Duke e parë diskutimin në lidhje me shkallën e kontrollit nga ana e mësuesit, ekzistojnë disa lloje të tij:

- Diskutimi rreth pyetjeve të strukturuar dhe të drejtuara nga mësuesi.
- Diskutimi rreth pyetjeve gjysmë të strukturuar, gjatë të cilit nxënësit nxiten të tregojnë shkallën e të kuptuarit të koncepteve të rëndësishme.

- Diskutimi reflektiv që nënkupton një sërë çështjesh pak të strukturuar. Nxënësit në këtë rast mendojnë në mënyrë kritike për zgjidhjen e problemeve.
- Diskutimi në grupe të vogla. Klasa ndahet në grupe të vogla të cilat kanë përgjegjësi të caktuara në diskutim.

Avantazhet	Kufizimet
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Zhvillon aftësitë komunikuese të nxënësve. ▪ Rrit motivimin e nxënësve. ▪ Aftëson nxënësit të marrin pjesë në mënyrë konstruktive dhe si të bashkëpunojnë me njëri tjetrin. ▪ Aftëson nxënësit të bëjnë përgjithësime, analogji, të gjykojnë përparësitë, të krahasojnë dhe të kundërshtojnë argumentet. ▪ Aftëson nxënësit të jenë këmbëngulës në arritjen e një objekti të caktuar dhe në zgjidhjen e një problemi. ▪ Aftëson nxënësit të përfitojnë nga diskutimi, nga informacionet që merren dhe nga këndvështrimet që trajtohen. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Në qoftë se nuk planifikohen mirë pyetjet që do të drejtohen dhe si do të pasojnë njëra tjetrën, mund të ketë shmangie nga tema dhe jo një diskutim të vërtetë. ▪ Në qoftë se nuk planifikohet mirë mund të kthehet në stërmundim. ▪ Krijon mërzi, në qoftë se procesi është i gjatë.

Shembull: *Klasa e 12 - Migrimet e popullsisë*

Diskutim: *Migrimet e popullsisë sot në botë*

Mësuesi nxit nxënësit të punojnë individualisht për të shqyrtuar lëvizjet migratore në botë, me fokus të veçantë emigracionin aktual në Evropë (vendet/rajonet nga të cilat largohen emigrantët, korridoret e lëvizjes, vendet /rajonet që presin numrin më të madh të emigrantëve etj), të cilat më pas i diskutojnë së bashku.

Diskutimi orientohet përmes pyetjeve:

- Cilët janë disa shembuj të migriimeve që po ndodhin aktualisht në Evropë dhe në botë?
- Çfarë ndryshimesh kanë migrimet aktuale nga migrimet e mëparshme?
- Cilat janë disa nga arsyet e lëvizjeve migratore sot?
- Në cilat vende/rajone po vendosen sot kryesisht emigrantët?
- Cilat janë disa ndër problemet më të mëdha me të cilat ndeshen emigrantët në vendet ku vendosen?
- Cilat mund të jenë disa ndër politikat dhe strategjitë për menaxhimin e tyre?

Në lëndën e gjeografisë në arsimin e mesëm të lartë, përgjatë tre viteve kur ajo zhvillohet, mësuesi mund të nxisë me nxënësit tema të ndryshme diskutimi të cilat lidhin lëndën me situatat e jetës së përditshme, të tilla si p.sh.:

- në klasën e 10-të, diskutimin në lidhje me ndryshimet klimatike, veprimtarinë e njeriut, pasojat dhe mundësitë për menaxhimin e këtyre ndryshimeve; a janë të mjaftueshme rezervat ujore të planetit për të gjithë, ç' mund të bëhet për të menaxhuar situatën, erozioni i tokës dhe veprimtaria e njeriut etj. ;
- në klasën e 11-të, diskutimin për lëvizjet migruese sot, faktorët që ndikojnë në rritjen e këtij migracioni, pasojat që sjellin këto migriime për vendet ku ato shkojnë, politikat dhe mundësitë për menaxhimin e tyre; turizmi në Shqipëri dhe perspektiva të zhvillimit të tij; diferencat në zhvillimet demografike të rajoneve të Shqipërisë etj.;
- në klasën e 12-të, diskutimin për karrierën e gjeografit dhe fushat e punësimit; tendenca të zhvillimeve aktuale të rajoneve më të mëdha të botës; politikat dhe perspektivat e zgjidhjes së disa prej problemeve etnike dhe fetare më të spikatura sot në botë; zhvillimet gjeopolitike aktuale dhe proceset globale, zhvillimin e qëndrueshëm etj.

ZGJIDHJA E PROBLEMIT

Procesi i hulumtimit, ashtu si në jetën reale dhe në mësimin dhe aktivitetet në lëndën e gjeografisë, realizohet nëpërmjet një sërë formash të zgjidhjes së problemit. Kjo metodë është një nga metodat e njohura që synon zgjidhjen e një problemi apo të një çështjeje të caktuar që lidhet me problematikën, duke e studiuar atë. Përgjithësisht, çdo veprimtari të nxëni, në të cilën nxënësit i duhet të kërkojë, të hulumtojë ose të mendojë për përgjigjet, është një veprimtari e realizuar me metodën e zgjidhjes së problemit. Megjithatë, as mësuesi dhe as nxënësit nuk mund

të quajnë një veprimtari si zgjidhje e problemit në qoftë se përgjigjet mund të gjenden nga një proces i thjeshtë njohjeje dhe kujtese.

Në përgjithësi procesi vijon si më poshtë:

1. Identifikimi dhe njohja e problemit, i cili mund të lindë dhe të fillojë si rastësisht ose i sugjeruar dhe shtruar për zgjidhje nga ana e mësuesit. Njohja e nxënësve me problemin dhe rënia dakord për të bërë diçka për ta zgjidhur apo për të dhënë një përgjigje.
2. Kërkimi i momenteve kyç që të çojnë drejt zgjidhjes së problemit.
 - a. Të menduarit e zgjidhjeve të mundshme (hipotezave) ose të trajtimeve të ndryshme që duhen marrë parasysh në zgjidhjen e problemit.
 - b. Testimi i zgjidhjeve apo trajtimeve të mundshme kundrejt kritereve që do t'i ndihmojnë nxënësit t'i vlerësojnë ato ashtu siç duhet.
3. Reagimi apo kundërshtimi ndaj zgjidhjeve apo trajtimeve të mundshme që nuk u përgjigjen kërkesave të dhëna dhe përpjekja për të tjera derisa të gjendet ajo më e përshtatshme. Mësuesi, në dhënien e konkluzioneve, pranon zgjidhjen apo trajtimin që duket më i përshtatshmi ose mund të testojë të gjitha hipotezat e dhëna për të gjetur atë më të mirën.

Me pak fjalë ky proces përmbledh:

- njohjen dhe ndërgjegjësimin për problemin;
- kërkimin e një zgjidhjeje;
- kontrollin e zgjidhjes për të parë nëse është i mirë dhe i përshtatshëm.


Aftësia në zgjidhjen e problemeve është një zotësi që mund të mësohet. Nxënësit kanë nevojë për ndihmë në gjetjen e pyetjeve që duhen drejtuar për të hetuar.

Avantazhet	Kufizimet
<ul style="list-style-type: none">▪ Nxit nxënësit të bëjnë analiza.▪ Kultivon aftësinë për të përdorur argumente pro dhe kundër.▪ E bën nxënësin të aftë të interpretojë fakte të jetës së përditshme.▪ Nxit të menduarit hipotetik, të pavarur, kritik dhe krijues.	<ul style="list-style-type: none">▪ Kërkon një të menduar të nivelit të lartë, i cili shpesh është i mundur për nivelet e larta të shkollimit.▪ Kërkon materiale burimore rreth të cilave të hulumtohet.▪ Kërkon kohë.▪ Kërkon krijimin e klimës së pranimit të opinionëve të kundërta.

- Edukon nxënësit të vlerësojnë dhe respektojnë të gjitha këndvështrimet e problemit.

Shembull

Ndotja si proces global (Klasa 12)



STUDIMI I RASTIT

Studimi i rastit është një formë e veçantë e metodës së zgjidhjes së problemit. Ajo konsiston në studimin e hollësishëm të një situatë të veçantë ose një çështjeje për të cilën nxënësit bëjnë përgjithësime.

Megjithëse procedura për të realizuar studimin e rastit është krejt e thjeshtë, kjo metodë shumë shpesh paraqitet e vështirë për t'u përmbytur. Në përgjithësi kjo metodë përfshin hapat e mëposhtëm:

- Zgjidhet dhe përcaktohet një temë ose një problem për studim. Ky duhet të jetë një rast tipik studimi.
- Përcaktohen, mblidhen dhe përgatiten materialet e duhura për studimin e rastit në thellësi. Zakonisht përdoret materiali i shkruar, por mund të përdoren edhe foto, filma, skica, etj.

- Bëhet një paraqitje e mirë e çështjes para nxënësve, në mënyrë që ata të kuptojnë saktë para se të nisin punën. Nxënësit mund të punojnë individualisht ose në grupe. E rëndësishme është që pasi të studiohet të arrihet në përfundime.
- Në këtë hap të fundit, nxënësit ndajnë gjetjet dhe përfundimet e nxjerra për studimin e rastit. Paraqitja e përfundimeve mund të bëhet në disa mënyra. Më shpesh ajo bëhet në formën e një diskutimi, por mund të bëhet edhe me anë të lojës në role apo simpoziumit.

Shembull

STUDIM RASTI – Tjetërsimi i shkëmbinjve (Klasa 10)

Në Malin Rashmor në Dakotën e Jugut në SHBA, në faqen prej graniti të këtij mali gjenden të gdhendura fytyrat e katër presidentëve të famshëm amerikanë: Xhorxh Uashingtonit, Tomas Xhefersonit, Abraham Linkolnit dhe Teodor Ruzveltit. Qysh prej përfundimit të tyre më 1941-shin, këto vepra gjigande kanë tërhequr mijëra vizitorë nga e gjithë bota.

Megjithatë, vite më parë, kjo përmendore e bukur gati sa nuk u prish fare. Mbas dyzet vjetësh shkëmbi prej graniti filloi të shkërmoqej. Fytyrat e presidentëve nisën të shuheshin. Dhe më e keqja ishte se, pjesë të mëdha shkëmbi të gdhendur filluan të binin.

Fatmirësisht, punëtorët e Shërbimit të Parkut Kombëtar qenë në gjendje ta shpëtonin përmendoren para se ajo të pësonte ndonjë dëmtim serioz. Duke përdorur llaç dhe grepa metalike, ata mundën të shpëtonin përmendoret nga dëmtimi dhe copëtimi i shkëmbinjve.

Për këtë rast studimor nxënësve u kërkohet të gjejnë:

- Çfarë e ka shkaktuar dëmtimin e përmendoreve?
- Cilët faktorë mund të kenë ndikuar që graniti i fortë të copëtohet dhe të plasaritet?
- Cilat janë llojet e tjetërsimeve të shkëmbinjve?
- Cilët janë faktorët që ndikojnë në secilin prej tyre?
- Po pasojat e tyre?

HARTA E KONCEPTEVE

Hartat e koncepteve ose konceptogramat janë skema që orientojnë të menduarin, ndihmojnë procesin e të kuptuarit, duke i vënë nxënësit në veprimtari kërkimore dhe reflektive. Teknika përdoret kur jepet njëkohësisht më shumë se një dukuri apo një koncept.

Hapat që ndiqen për hartimin e konceptogramës:

- Hartimi i listës së ideve ose koncepteve.
- Organizimi i koncepteve në mënyrë që të kalohet nga e përgjithshme te specifika. Vendosni konceptin më të përgjithshëm në krye dhe rrethojeni.
- Bashkimi me vija i koncepteve.

Kur vlerësojmë konceptogramën e hartuar nga nxënësit duhet të kemi parasysh këto kritere:


- Sa e kuptueshme është diagrama (a janë treguar të gjitha lidhjet)?
- A janë lidhur qartë konceptet?
- A është e thjeshtë qartësia e paraqitjes? Janë përdorur drejt termat lidhës?

Shembull

Klasa 10: Llojet e shkëmbinjve

Shkëmbinjtë magmatikë

Mësuesi ndan klasën në grupe dhe i kërkon secilit grup të plotësojë konceptogramën për të gjitha konceptet që lidhen me shkëmbinjtë magmatikë. Më pas grupet mblidhen dhe ballafaqojnë me njëri-tjetrin konceptogramat e plotësuara.



PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Nuk ka dyshim se teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK) është mjete i informacionit dhe komunikimit që luan një rol kyç në pothuajse çdo aspekt të jetës. Përdorimi i saj në një mjedis të nxëni mbështet të mësuarit e gjeografisë duke e bërë më tërheqëse lëndën dhe më efektiv procesin e të nxënit. Teknologjitë gjeohapësinore përfshijnë Sistemin e Pozicionimit Global (GPS), Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS) etj.

TIK-u ka vlera të domosdoshme dhe të patjetërsueshme për të transformuar mjedisin profesional të mësimit-nxënies. TIK-u u ofron mësuesve dhe nxënësve akses të shpejtë në informacionin gjeografik aktual dhe të përditësuar. Nxënësit mund të përfitojnë shumë nga përdorimi i duhur i TIK-ut që mbështet të menduarit gjeografik dhe gjithashtu e bën zhvillimin e njohurive dhe aftësive më efikas dhe tërheqës. Kjo përfshin përdorimin e rrjeteve të komunikimit, kompjuterëve, softuerit, ruajtjes së të dhënave dixhitale dhe sistemeve audiovizive. Tërësia e mjeteve softuerike mund të përfshijë përdorimin e aplikacioneve, programeve dhe platformave të ndryshme, si Word për hartimin e materialeve të ndryshme, Excel për përpunimin e të dhënave dhe krijimin e databazave, Power point për zhvillimin e prezantimeve, Google Maps dhe Google Earth si platforma që ofrojnë imazhe satelitore, fotografi ajrore, harta etj.

Më poshtë janë dhënë disa çështje të cilat duhet të jenë në vëmendje të mësuesit të gjeografisë në lidhje me përdorimin e TIK-ut në procesin e të nxënit/mësimit-nxënies.

Mësuesi i gjeografisë:

- ✓ planifikon dhe zhvillon veprimtari mësimore që realizohen përmes përdorimit të TIK-ut dhe që sigurojnë përvetësimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive, vlerave dhe qëndrimeve nga nxënësit;
- ✓ përdor TIK-un për të mbështetur strategjitë e të nxënit dhe të vlerësimit të nxënësve, përfshirë projektin kurrikular;
- ✓ udhëzon nxënësit për përdorimin e TIK-ut për të kërkuar, menaxhuar, analizuar, vlerësuar dhe përdorur informacionin;
- ✓ identifikon dhe vlerëson e-burimet që mbështesin të nxënit e bazuar në projekte;
- ✓ udhëzon nxënësit për përdorimin e TIK-ut për zgjidhjen e situatave problemore, në mënyrë kritike dhe bashkëpunuese;

- ✓ udhëzon nxënësit në përdorimin e TIK-ut për realizimin e detyrave/punimeve që mbështesin arsyetimin, planifikimin, reflektimin dhe ndërtimin e njohurive;
- ✓ orienton nxënësit për të kërkuar informacionin në faqet e dhura në internet;
- ✓ kupton dhe zbaton parimet themelore të sigurisë kibernetike, edukimit mediatic dhe informativ;
- ✓ krijon mjedise virtuale të të nxënësve duke mbështetur bashkëpunimin, gjithpërfshirjen të mësuarin në klasë dhe jashtë saj.

VII. PLANIFIKIMI KURRIKULAR DHE MODELE TË PLANIFIKIMIT TË LËNDËS

7.1. Planifikimi i mësimdhënies së gjeografisë

- ✎ *Baza e një planifikimi të suksesshëm është njohja e mirë e programit mësimor; mësuesi duhet të zbatojë me përpikmëri të gjitha kërkesat e tij.*
- ✎ *Rezultatet e të nxënësve (RN) të përcaktuara në programet e secilës klasë janë një themel i përbashkët për të gjithë mësuesit. Mësuesit përzgjedhin vetë metodat dhe strategjitë më të përshtatshme, burimet e mundshme për t'u shfrytëzuar, llojet dhe mjetet e vlerësimit në lidhje me përmbushjen e RN-ve.*
- ✎ *Programet e gjeografisë specifikojnë orët e sugjeruara për tematikë dhe nëntematikë, për secilën shkallë dhe klasë. Orët e sugjeruara përfshijnë njohuritë e reja, punët praktike, detyrat dhe projektet, vëzhgimet në natyrë, veprimtaritë përforcuese, testimet e ndryshme. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shitesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën nëntematikë.*
- ✎ *Në lëndën e gjeografisë, për përmbushjen e programeve mësimore janë të domosdoshme planifikime të vëzhgimeve të drejtpërdrejta në terren (përfshirë ekskursionet), të cilat mund të realizohen në hapësirën përreth shkollës e më gjerë. Vëzhgimet u shërbejnë nxënësve për të formuar përfytyrime më të qarta për dukuritë dhe proceset gjeografike, si dhe për zhvillimin e shprehive dhe vlerave të dobishme për jetën.*
- ✎ *Zhvillimi i kompetencave të lëndës së gjeografisë nuk mund të konceptohet pa përdorimin e hartës. Puna me hartën në lëndën e gjeografisë është thelbësore për zhvillimin e të menduarit hapësinor. Përdorimi i hartave në procesin e të nxënësve/mësimdhënies zhvillon njohuritë dhe aftësitë gjeografike, nxit kuriozitetin e nxënësve, inkurajon eksplorimin dhe zgjidhjen e*

problemeve.

- ☞ *Planifikimi i burimeve dhe i mjeteve ndihmëse të mësimdhënies dhe të nxënit është i rëndësishëm në planifikimin e të mësuarit. Burimet e ndryshme të informacionit, si revista, enciklopedi, harta, atlase etj. dhe teknologjia e informacionit dhe komunikimit pasurojnë të nxënit dhe mësimdhënien.*

Në vëmendje!

Shembujt e mëposhtëm të planifikimeve vjetore, të periudhës dhe ditore synojnë të ilustrojnë metodologjinë dhe logjikën e planifikimit kurrikular të lëndës. Mësuesit duhet të ndërtojnë planet bazuar në programin mësimor të lëndës, në nevojat dhe veçoritë e nxënësve, në tekstin mësimor dhe burimet e tjera të të nxënit etj., duke bashkëpunuar dhe ndarë përvojat me kolegët.

7.2. Planifikimi vjetor

Plani vjetor është një planifikim në vija të përgjithshme i përmbajtjes së lëndës për të tria periudhat. Plani vjetor mund të pësojë ndryshime përgjatë vitit në varësi të veçorive të zhvillimit të nxënësve, problematikave që hasen gjatë procesit mësimor etj.

Për planifikimin vjetor të lëndës, mësuesi, përveç programit mësimor duhet të njohë edhe tekstin që ka përzgjedhur për atë vit shkollor. Natyrisht, realizimi i programit është qëllimi i vërtetë i mësuesit, kurse teksti mësimor është një mjet për ta përmbushur këtë qëllim. Kur mësuesi sheh se teksti nuk i ka dhënë vendin e mjaftueshëm përvetësimit të një rezultati të nxëni të programit, ai e plotëson vetë këtë mungesë të tekstit, duke përdorur burime të tjera të nxëni. Në procesin e planifikimit të periudhës mësuesit bëjnë kujdes për grupimin e temave që kanë lidhje logjike me njëra-tjetrën.

Plani vjetor është një plan sintetik. Mësuesi planifikon orët dhe përmbajtjen kryesore lëndore për tria periudha. Periudhat janë:

- periudha e parë: shtator- dhjetor;
- periudha e dytë: janar – mars;
- periudha e tretë: prill- qershor.

Shembull

Model planifikimi vjetor: Klasa 10

Tematika	Shpërndarja e përmbajtjes së lëndës		
	Shtator – Dhjetor (25 orë)	Janar – Mars (24 orë)	Prill – Qershor (23 orë)
Proceset natyrore dhe shoqërore	<p>I. Sistemi diellor</p> <p>Hipoteza e formimit të sistemit diellor.</p> <p>Dielli dhe karakteristikat e tij:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Përmasat -Struktura -Shtresat. <p>Rëndësia e Diellit për dukuritë gjeografike</p> <p>Toka si planet dhe tiparet e saj:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Forma -Përmasat. <p>Evolucioni i mendimit gjeografik mbi formën dhe pozicionin e Tokës në sistemin diellor.</p> <p>Rrotullimi i Tokës rreth boshtit: Provat dhe pasojat</p>	<p>Trysnia atmosferike dhe ndryshimet e saj në kohë dhe në hapësirë.</p> <p>Erërat dhe llojet e tyre: erërat e qarkullimit të përgjithshëm dhe erërat lokale.</p> <p>Masat ajrore dhe frontet.</p> <p>Ciklonet dhe anticiklonet.</p> <p>Moti, klima dhe faktorët që ndikojnë në formimin e saj.</p> <p>Zonat klimatike.</p> <p>Ndryshimet klimatike, politikat dhe masat për kontrollin e tyre.</p> <p>IV. Hidrosfera</p> <p>Hidrosfera dhe ndërvarësia me pjesët</p>	<p>VI. Biosfera</p> <p>Biosfera, elementet përbërëse të saj dhe faktorët që ndikojnë në zhvillimin e botës organike.</p> <p>Roli i biosferës në mjedisin gjeografik.</p> <p>VII. Dinamika e Tokës</p> <p>Pllakat tektonike, lëvizja e tyre dhe forcat lëvizëse.</p> <p>Krijimi i tipografisë së sipërfaqes së Tokës dhe dyshemesë së oqeanit përmes tektonikës së pllakave.</p> <p>Lëvizjet luhatëse, rrudhosëse e shkëputëse dhe pasojat e tyre.</p>

	<p><i>Rrotullimi i Tokës rreth Diellit, pasojat.</i></p> <p><i>Hëna si trup qiellor e satelit natyror i Tokës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -Struktura -Fazat e Hënës -Hipotezat e formimit të saj. <p><i>Eklipsi i Hënës dhe i Diellit.</i></p> <p><i>Planetët, asteroidet, meteorët, kometat.</i></p> <p><i>Zhvillimi i teknologjisë dhe eksplorimi i hapësirës.</i></p> <p>II. Hartografia</p> <p><i>Paraqitja e Tokës në hartë, glob dhe plan.</i></p> <p><i>Rrjeti gjeografik.</i></p> <p><i>Brezat e kohës dhe përcaktimi i kohës lokale dhe zonale.</i></p> <p><i>Projeksionet hartografike.</i></p> <p><i>Hartat, elementet matematikore dhe gjeografike.</i></p>	<p><i>e tjera të gjeosistemit.</i></p> <p><i>Ujërat e deteve dhe oqeaneve, dinamika e tyre (valët detare, baticat-zbaticat, rrymat oqeanike).</i></p> <p><i>Lumenjtë dhe regjimi i tyre hidrologjik.</i></p> <p><i>Liqenet, klasifikimi dhe evolucioni i tyre.</i></p> <p><i>Ujërat nëntokësorë, llojet e tyre dhe shfrytëzimi.</i></p> <p><i>Ujërat minerale, termominerale dhe rëndësia e tyre.</i></p> <p><i>Bora e përhershme dhe akullnajat.</i></p> <p><i>Rëndësia e hidrografisë për zhvillimin e një rajoni/vendi.</i></p> <p>V. Litosfera</p> <p><i>Ndërtimi i brendshëm i Tokës dhe veçoritë e shtresave të saj.</i></p>	<p><i>Tërmetet dhe dukuria e formimit të tyre.</i></p> <p><i>Tipet e tërmeteve dhe pasojat e tyre.</i></p> <p><i>Shpërndarja gjeografike e tërmeteve.</i></p> <p><i>Vullkanet, shpërndarja gjeografike e tyre dhe pasojat e vullkaneve.</i></p> <p><i>Llojet e shpërthimeve vullkanike.</i></p> <p><i>Forcat e jashtme dhe ndikimi i tyre në ndryshimet në Tokë.</i></p> <p><i>Tjetërsimi fizik, kimik e biologjik dhe kushtet në të cilat ndodhin.</i></p> <p><i>Dherat dhe faktorët e formimit të tyre.</i></p> <p><i>Dukuritë gravitative dhe faktorët e ndodhjes së tyre (shembjet, rrëzimet, rrëshqitjet).</i></p> <p><i>Veprimtaria gërryese, transportuese dhe depozituese e:</i></p>
--	---	---	--

	<p><i>Klasifikimi i hartave sipas:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Përmbajtjes</i> - <i>Shkallës</i> - <i>Përdorimit mbi bazën e veçorive dalluese.</i> <p><i>Zhvillimet teknologjike dhe hartografia në ditët e sotme.</i></p> <p>III. Atmosfera</p> <p><i>Hipoteza e formimit të atmosferës.</i></p> <p><i>Përbërja e atmosferës dhe karakteristikat kryesore të secilës shtresë.</i></p> <p><i>Rrezatimi diellor dhe llojet e tij.</i></p> <p><i>Ndikimi i rrezatimeve në sistemet gjeofizike të Tokës.</i></p> <p><i>Temperatura e ajrit dhe ndryshimet e saj në kohë dhe në hapësirë.</i></p> <p><i>Lagështira e ajrit: kondensimi dhe format kryesore të tij.</i></p>	<p><i>Ndryshimet e temperaturës, trysnisë, dendësisë dhe magnetizmit.</i></p> <p><i>Mineralet, vetitë fizike dhe përdorimet e tyre.</i></p> <p><i>Llojet e shkëmbinjve dhe formimi i tyre.</i></p> <p><i>Formimi i fosileve dhe rëndësia e tyre dokumentuese.</i></p> <p><i>Koha gjeologjike dhe evolucioni i botës së gjallë përgjatë saj.</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> - <i>erës dhe format e relievit që krijohen prej saj;</i> - <i>ujërave rrjedhës dhe format e relievit që ato krijojnë;</i> - <i>karstit dhe format që krijohen;</i> - <i>akullnajave dhe format e relievit që ato krijojnë;</i> - <i>detit dhe format e relievit që krijohen prej saj.</i> <p>VIII. Mjedisi dhe ndikimi i veprimtarisë njerëzore</p> <p><i>Mjedisi gjeografik dhe ndikimi i tij në veprimtarinë njerëzore.</i></p> <p><i>Roli i veprimtarisë njerëzore për ndryshimin e mjedisit.</i></p> <p><i>Zhvillimi i qëndrueshëm dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore.</i></p>
--	---	---	---

	<p><i>Reshjet dhe kushtet e formimit të tyre.</i></p> <p><i>Shpërndarja gjeografike e reshjeve dhe rëndësia e tyre.</i></p>		
--	---	--	--

7.3. Planifikimi i periudhës

Planifikimi i periudhës është një planifikim më i detajuar i mësimdhënies bazuar dhe në planifikimin e parashikuar në planin vjetor të lëndës. Dhe në planin e periudhës, ashtu sikurse në planin vjetor, mësuesit janë të lirë të bëjnë ndryshimet e tyre hap pas hapi në varësi të specifikave të lëndës së tyre.

Ky lloj planifikimi kërkon që mësuesi të përcaktojë me kujdes:

- **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

Mësuesi përcakton rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe, të cilat do të zhvillohen nga nxënësit përgjatë kësaj periudhe. Këto rezultate i përzgjedh në programin mësimor, në rubrikën “Rezultatet kryesore të të nxënit, sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjeografisë”.

- **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës**

Përcakton rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës, të cilat do të arrihen nga nxënësi përgjatë periudhës. Këto rezultate mësuesi i përzgjedh nga programi mësimor në rubrikën “Rezultatet e të nxënit sipas tematikave të përmbajtjes së lëndës”, duke veçuar vetëm ato rezultate që do të zhvillojë përgjatë asaj periudhe.

- **Temat mësimore sipas tematikave/nëntematikave**

Në këtë rubrikë shënohen të gjitha temat mësimore që do të zhvillohen gjatë periudhës, të cilat përfshijnë:

- ✓ Temat mësimore brenda të cilave do të realizohen rezultatet e të nxënit.
- ✓ Orët e projektit kurrikular që do të zhvillojnë nxënësit përgjatë periudhës për zbatimin dhe demonstrimin e aftësive të fituara në lëndën e gjeografisë si dhe për zhvillimin e kompetencave kyç.

- ✓ Mësuesi planifikon prezantimin dhe vlerësimin e projektit në planifikimin e periudhës.
- ✓ Orë mësimore për veprimtaritë praktike në funksion të zbatimit të njohurive dhe aftësive dhe demonstrimit të arritjeve të nxënësve, përfshirë vëzhgimet në terren/ekskursionet.
- ✓ Orë mësimore për përsëritje/veprimtari përforcuese për konsolidimin e njohurive dhe aftësive.
- ✓ Orën e testit/detyrës përmbledhëse.

▪ **Situata e të nxënit**

Në këtë rubrikë vendosen situatat e të nxënit që mësuesi parashikon të realizojë gjatë periudhës. Mësuesi jo detyrimisht planifikon të gjitha situatat e të nxënit të periudhës në këtë plan, ashtu sikurse është i lirë të ndryshojë situatat që ai ka planifikuar. Situatat e të nxënit mund t'i përkasin një teme ose disa temave mësimore, ashtu sikurse mund të ketë tema mësimore për të cilat mësuesi nuk zhvillon situata të nxëni.

▪ **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

Në këtë rubrikë mësuesi vendos teknikat dhe metodat e mësimdhënies (p.sh., harta e konceptit, parashikimi me terma paraprakë, grupet e ekspertëve, punë në grup, ekskursioni etj.) që do të përdoren gjatë zhvillimit të këtyre temave në një periudhë të caktuar (jo shumë e detajuar sepse e tillë kjo rubrikë detajohet në planifikimin ditor).

▪ **Vlerësimi**

Në planifikimin e periudhës mësuesi përzgjedh teknikat e vlerësimit që do të përdoren për vlerësimin e nxënësve, të tilla si p.sh., vlerësimi i përgjigjeve me gojë; vlerësimi i punës në grup; vlerësim mes nxënësish; vlerësim i aktivitetit gjatë debateve në klasë; vlerësim i detyrave të shtëpisë; vetëvlerësim etj. Kjo rubrikë nuk detajohet shumë sepse është e detajuar në planifikimin ditor.

▪ **Burimet**

Në këtë rubrikë mësuesi vendos burimet që do të përdoren për arritjen e rezultateve të të nxënit si p.sh., teksti i nxënësit, materiale të përgatitura nga mësuesi ose nxënësi, lloje të ndryshme hartash etj. Kjo rubrikë nuk plotësohet në mënyrë shumë të detajuar, pasi e tillë do të plotësohet në planifikimin ditor.

Shembull

Model planifikimi: Klasa 11, Periudha e tretë (Prill- Qershor)

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

Nxënësi:

- shprehet përmes një forme të komunikimit, për një temë të caktuar në një material gjeografik (prezantim) prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore të ngritura në material (prezantim);
- përdor drejt strukturën dhe rregullat standarde të drejtshkrimit të gjuhës amtare në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, e-mail (postë elektronike), letër formale dhe joformale etj.;
- prezanton një projekt, të hartuar individualisht dhe në grup, për një temë të caktuar gjeografike duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi:

- prezanton, në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse;
- krahason të paktën tri burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur teknologjinë informative;
- harton një detyrë me tekst, apo krijon një situatë logjike nga jeta e përditshme, e cila përmban një mesazh që kërkon zgjidhje duke u bazuar në njohuritë paraprake, prezanton mënyrën/procedurën e zgjidhjes së problemit para të tjerëve.

Kompetenca e të nxënit

Nxënësi:

- Shfrytëzon në mënyrë efektive përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjes së ndonjë detyre ose veprimtarie në lëndën e gjeografisë, diskuton dhe ndan përvojat me të tjerët për mënyrat më praktike të shfrytëzimit të përvojave paraprake në arritjen e dijeve të reja;
- parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar, bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejshëm të të nxëniet për temën apo problemin e caktuar;
- zgjidh një problem të caktuar mësimor ose një situatë nga jeta e përditshme;
- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna në ndonjë burim informacioni për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë ose për të zgjidhur një problem që kërkohet prej tij, vlerëson vetë performancën dhe rezultatin e arritur, duke iu referuar qëllimeve fillestare (p.sh., burime të informacionit në libër, revistë, enciklopedi, internet, hartë, grafik, skicë etj).

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi:

- përgatit, prezanton, drejton dhe merr pjesë në një fushatë të informimit të qytetarëve për një temë të caktuar, duke u mbështetur në ide të reja, bazuar në rezultate të pritshme të përcaktuara qartë (p.sh., fushatë informimi për mbrojtjen e mjedisit etj.);
- hulumton dhe analizon forma të ndryshme të sipërmarrjes për mundësi të orientimit për karrierën, si dhe për të kontribuar në të mirë të komunitetit.

Kompetenca personale

Nxënësi:

- analizon përparësitë dhe dobësitë personale duke i evidentuar masat përmes të cilave synon të mbështesë avancimin personal, në përparësitë që ka dhe masat përmes të cilave synon të përmirësojë dobësitë personale.

Kompetenca qytetare

Nxënësi:

- demonstroi shembuj të pjesëmarrjes demokratike dhe drejton forma të ndryshme të diskutimit për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes demokratike në

nivele të ndryshme (p.sh.: në familje, në shkollë, në komunitet, në nivel lokal dhe nivel shtetëror) duke treguar tolerancë dhe respekt për pyetjet dhe komentet e të tjerëve;

- demonstroi shembuj konkretë të mbrojtjes së mjedisit natyror dhe atij të krijuar nga njeriu në veprimtari të jetës së përditshme në shtëpi, në klasë, në shkollë dhe në komunitet, propozoi alternativa se si të gjithë qytetarët mund të ndihmojnë në mënyra të ndryshme për këtë proces.

Kompetenca digjitale

Nxënësi:

- përdori mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive;
- gjeti, organizoi, analizoi, përpunoi dhe përdori informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh të ndryshme.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës

Nxënësi:

- analizoi tendencën e ndryshimeve demografike të Rajonit Verior - Verilindor me fokus të veçantë braktisjen pas viteve '90;
- analizoi tiparet kryesore të aktivitetit aktual ekonomik të Rajonit Verior - Verilindor;
- vlerësoi trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Verior - Verilindor;
- identifikoi mundësitë dhe argumenton perspektivën e zhvillimit të Rajonit Verior - Verilindor, rolin e korridorit Durrës-Prishtinë në kuadër të këtij zhvillimi dhe të bashkëpunimit rajonal e më gjerë;
- ndërtoi hartën e resurseve natyrore të Rajonit Verior – Verilindor, duke analizuar mundësitë e shfrytëzimit të tyre për zhvillimin social –ekonomik;
- vlerësoi pozitën gjeografike të Rajonit Juglindor për zhvillimin e bashkëpunimit rajonal;
- përshkroi tiparet dalluese natyrore të Rajonit Juglindor;
- identifikoi pjesët përbërëse të Rajonit Juglindor;
- analizoi tiparet dalluese dhe tendencën e zhvillimit demografik të Rajonit Juglindor, me fokus të veçantë lëvizjet migratore pas viteve '90;
- evidentoi disa ndër pasojat e këtyre lëvizjeve në zhvillimet rajonale;

- analizon tiparet kryesore të veprimtarisë ekonomike të Rajonit Juglindor, duke e krahasuar dhe me rajonet e tjera;
- vlerëson trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Juglindor dhe rëndësinë e saj për zhvillimin e turizmit;
- identifikon mundësitë dhe argumenton perspektivën e zhvillimit të Rajonit Juglindor;
- ndërton hartën e infrastrukturës rrugore të Rajonit Juglindor, duke evidentuar rolin e saj në integrimin dhe bashkëpunimin me shtetet fqinje dhe më gjerë;
- vlerëson rëndësinë e pozitës gjeografike ndërkufitare të Rajonit Jugor për zhvillimet rajonale;
- përshkruan tiparet e përgjithshme natyrore që dallojnë Rajonin Jugor;
- analizon tiparet dalluese të zhvillimit demografik të Rajonit Jugor;
- evidenton pasojat e migrimeve të popullsisë së Rajonit Jugor;
- dallon tiparet kryesore të veprimtarisë ekonomike të Rajonit Jugor dhe pasojat ndërrajonale të saj;
- vlerëson trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Jugor dhe rëndësinë e saj;
- identifikon mundësitë dhe argumenton perspektivën e zhvillimit të Rajonit Jugor;
- ndërton hartën e zonave kryesore turistike të Rajonit Jugor. përshkruan tiparet dalluese të pabarazive të zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve të vendit tonë;
- analizon faktorët që kanë ndikuar në pabarazitë e zhvillimeve rajonale;
- përcakton drejtimet kryesore të këtyre dallimeve, të tilla si:
 - popullimi,
 - zhvillimi ekonomik,
 - shkalla e urbanizimit,
 - niveli i papunësisë,
 - etj;
- identifikon disa nga rrugët për zbutjen e pabarazive;
- vlerëson potencialet konkurruese të Shqipërisë për zhvillimet e ardhme rajonale (të tilla, si bujqësia, energjia, turizmi etj).

Tematika /nëntematika	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
Rajonet gjeografike të Republikës së Shqipërisë	1. Tiparet e zhvillimit demografik të Rajonit Verior –Verilindor.	Censusi 2011 dhe Censusi 2001: Analizë e tipareve demografike të rajonit mbi të dhënat statistikore.	Stuhi mendimesh Pyetje- përgjigje Harta e konceptit Punë me grupe	Vlerësim individual, Vlerësimi i përgjigjeve me gojë, vlerësimi nga njëri-tjetri	Teksti i nxënësit, harta murale politike- administrative e Shqipërisë, të dhëna nga internet, media etj
	2. Lëvizjet masive të popullsisë në Rajonin Verior- Verilindor pas vitit 1990.	Censusi 2011 dhe Censusi 2001: Analizë e tipareve demografike të rajonit mbi bazën e të dhënave statistikore.	Stuhi mendimesh Pyetje- përgjigje Harta e konceptit Punë me grupe	Vlerësim individual, Vlerësimi i përgjigjeve me gojë, vlerësimi nga njëri-tjetri	Teksti i nxënësit, harta murale politike- administrative e Shqipërisë, të dhëna nga internet, media etj
	3.
	4.
	5. Projekt (ora e parë).....
	6. Projekt (ora e dytë).....

	7.
	8.
	9.
	10.
	11.
	12.
	13.
	14.
	15. Veprimtari përforcuese
	16. Detyrë përmbledhëse
	17.
	18.
	19.
	20.
	21.
	22.
	23.

7.4. Planifikimi ditor

Për përgatitjen e planit ditor mësuesi përcakton së pari rezultatet e të nxënit të asaj ore mësimi, përgatit veprimtaritë mësimore duke bërë kujdes të veçantë për përzgjedhjen e metodave dhe

strategjive ndërvepruese, përzgjedh burimet e të nxënit, përcakton teknikat e vlerësimit të përshtatshme për klasën, planifikon punën me klasën, me grupet, me nxënës të veçantë, përcakton lidhjen me lëndët e tjera etj.

Në rastet kur janë kryer bashkime të temave që kanë lidhje logjike me njëra tjetrën, ato trajtohen brenda dy orëve të njëpasnjëshme dhe për to hartohet një plan i përbashkët ditor (shih shembullin më poshtë – Tabela 1, 2, 3). Nëse dy temat nuk mund të trajtohen si një e tërë, atëherë mësuesi mund të hartojë plan ditor të veçantë për secilën prej tyre.


(shih shembullin më poshtë – Tabela 4, 5, 6)

Shembull

Tabela 1: Model planifikimi ditor me dy orë të njëpasnjëshme, Klasa 10

Tema 1:Lumenjtë	
Tema 2: Llogaritja e elementeve hidrologjikë të lumit (Punë praktike)	
Situata e të nxënit: Shembull - Lumi i Shkumbinit Përmes rastit të lumit të Shkumbinit (ose të një lumi që ndodhet në zonën ku nxënësit banojnë) të cilin mësuesi e shoqëron me foto dhe ilustrime të gazetave, revistave etj., nxënësit nxiten të mendojnë për veçoritë e lumenjve dhe ndërhyrjet e njeriut.	
Rezultatet e të nxënit: Nxënësi: - Përshkruan tiparet e elementeve morfologjikë të lumit. - Analizon regjimin hidrologjik të lumenjve dhe faktorët që ndikojnë në të. - Klasifikon lumenjtë sipas kushteve klimatike dhe ushqimit. - Mban qëndrim kritik ndaj dukurive me pasoja negative që sjell ndërhyrja e njeriut. - Llogarit prurjen, rrjedhjen dhe nivelin e ujit të lumenjve. - Ndërton profilin e gjallë të lumit dhe e interpreton atë - Bashkëpunon në grup dhe ndan ide me të tjerët.	Fjalët kyce: Lumë, elementet e lumit, sistem lumor, pellg ujëmbledhës, regjim hidrologjik, prurje, rrjedhje, nivel, rregjim hidrologjik, përmytje, vërshim, profil i gjallë i lumit

<p>Burimet/mjetet/materialet: Teksti i nxënësit, harta, foto nga lumenj të ndryshëm etj.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose temat ndërkurrikulare: Shkencat natyrore, zhvillimi i qëndrueshëm, TIK-un, Matematikën etj</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>Diskutim rreth njohurive paraprake Mësuesi rishikon dhe njëherë me nxënësit se çfarë ndodh me reshjet pasi ato bien në tokë. Nxënësit risjellin në fokus se një pjesë e ujit avullon menjëherë në atmosferë, një pjesë thithet dhe ruhet në tokë, një pjesë merret nga bimët, dhe një pjesë ushqen lumenjtë dhe përrrenjtë si rrjedhë sipërfaqësore.</p>	
<p>Stuhi mendimesh Mësuesi drejton nxënësit të diskutojnë dhe të japin mendime paraprakisht rreth: Çfarë dallimi ka midis lumit Shkumbin në afërsi të rrugës nacionale Elbasan - Librazhd dheZaranikës që kalon në periferi të qytetit tonë? Dalin në pah tiparet e lumenjve (Shkumbini) si gjatësia, pjerrësia e shpatit të luginës, sasia e ujit në rrjedhje në dallim nga përrrenjtë (Zaranika).</p>	
<p>Lexim i drejtuar dhe organizues grafik Nxënësit në dyshe lexojnë tekstin në paragrafë duke u përqëndruar në veçoritë e lumenjve. Për çdo paragraf evidentohen çështjet kryesore në formën e pyetjeve si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Çfarë është lumi? Cilat janë tiparet morfologjike të tij? Figura e ndërtuar në dërrasë. 2.Cilat janë veçoritë e çdo pjese morfologjike të lumit? 3.Si paraqitet regjimi hidrologjik i lumenjve? 4.Cilët janë faktorët që ndikojnë në këtë regjim? 5.Si klasifikohen lumenjtë sipas ushqimit dhe kushteve klimatike? 6.Cila është rëndësia praktike e lumenjve dhe shfrytëzimi ekonomik i tyre? <p>Informacioni organizohet grafikisht duke përcaktuar: <u>Lumenjtë, klasifikimi sipas ushqimit, treguesit e ndërtimit morfologjik, tiparet e treguesve të regjimit hidrologjik etj.</u></p>	



Rrjeti i diskutimit

Nxënësit në dyshe diskutojnë duke dhënë argumente dhe shembuj konkretë nga Shqipëria rreth:

Pse lumenjtë e vendit tonë shkaktojnë përmbytje? Cilët janë faktorët që ndikojnë? Jepni shembuj konkretë të ndodhur së fundmi në Shqipëri. Nxënësit diskutojnë mbi ndërhyrjet e njeriut në lumin Shkumbin, pasojat dhe rëndësinë e reagimit qytetar për mbrojtjen e tij.

Punë individuale dhe në grup

- Nxënësit fillimisht individualisht dhe më pas në grupe të vogla evidentojnë konceptet kryesore;
- Formulojnë pyetje rreth tipareve dhe veçorive të lumenjve dhe diskutojnë me njëritjetrin;
- Ndërtojnë figurën e lumit dhe pjesëve përbërëse të tij;

Punë individuale dhe në grup

Nxënësit angazhohen individualisht dhe në grup në zgjidhjen e ushtrimeve të mëposhtme duke evidentuar veçoritë e regjimit hidrologjik të lumenjve si me poshtë:

Detyra 1

Të gjendet prurja e lumit, kur sipërfaqja e seksionit të gjallë të lumit është $18,2 \text{ m}^2$ dhe shpejtësia mesatare e rrjedhjes së ujit në gjithë seksionin e gjallë është 1.1 m/sek .

Detyra 2

Të llogaritet rrjedhja ujore e lumit kur sipërfaqja e seksionit të gjallë të lumit është $18,2 \text{ m}^2$ dhe shpejtësia mesatare e rrjedhjes së ujit në gjithë seksionin e gjallë është 1.1 m/sek .

Detyra 3

Të gjendet niveli mesatar ditor i ujit të lumit,(h.mes) kur janë bërë dy matje brenda 24 orëve. Në matjen e parë niveli ka qenë $h_1=102$ cm dhe në të dytën $h_2= 106$ cm. Mbështetur në të dhënat, nxënësit ndërtojnë grafikët e prurjes dhe nivelit të ujit në lumë e më tej i interpretojnë ato duke përcaktuar faktorët.

Vlerësimi:

Nxënësi

Niveli 2:

- Identifikon elemente morfologjike të lumit dhe veçoritë e regjimit hidrologjik të lumenjve; llogarisin elementet hidrologjike pa analizuar rezultatet.

Niveli 3:

- Përshkruan elementet morfologjike të lumit dhe veçoritë e regjimit hidrologjik të lumenjve; llogarisin elementet hidrologjike dhe analizon rezultatet.

Niveli 4:

- Analizon elementet morfologjike të lumit dhe veçoritë e regjimit hidrologjik të lumenjve; llogarisin elementet hidrologjike dhe analizon rezultatet; argumenton dhe mban qëndrim.

Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësit do të hulumtojnë mbi rastin e ndërhyrjes së njeriut në një prej lumenjve, duke analizuar ndryshimet dhe pasojat që ka sjellë.

Shembull

Tabela 2: Model planifikimi ditor me dy orë të njëpasnjëshme, Klasa 11

Tema 1:Karakteristikat kryesore të popullimit të Rajonit Perëndimor.	
Tema 2: Lëvizjet e popullsisë drejt Rajonit Perëndimor.	
Rezultatet e të nxënit	Fjalët kyce:
Nxënësi:	popullim i hershëm, tipare
- Analizon karakteristikat kryesore të popullimit të këtij rajoni dhe shkaqet e pasojat e lëvizjes drejt tij.	strukurore, vendbanime
- Analizon ndryshimet strukurore të popullsisë së këtij rajoni.	qytetare, vendbanime fshatare
	, shpërndarje e popullsisë,
	migrim, faktorë të migrimit,
	transformim demografik,

<ul style="list-style-type: none"> - Interpreton shpërndarjen e popullsisë brenda Rajonit Perëndimor. - Evidenton tiparet e vendbanimeve të rajonit. - Parashikon perspektivën e zhvillimit të Rajonit perëndimor në lidhje me lëvizjen e popullsisë. - Bashkëpunon në grup dhe ndan ide me të tjerët. 	<p>strategji zhvillimi, efekte të migrimit, menaxhim potencialesh, investime, strategji zhvillimi etj.</p>
<p>Burimet/mjetet/materialet: Teksti i nxënësit, harta murale politiko-administrative e Shqipërisë, foto, video ose CD me të dhëna nga CENSUSI</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose temat ndërkurrikulare: Ndërvarësia, bashkëjetesa paqësore, historia, qytetaria, TIK-u</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>Stuhi mendimesh</p> <p>Mësuesi drejton pyetjen: “Në Rajonin Perëndimor të Shqipërisë janë përqëndruar qendra më të mëdha e të rëndësishme urbane të Shqipërisë. A është kjo e rastësishme apo ka një arsye?”</p> <p>Pse pjesa më e madhe e studentëve preferojnë të studiojnë në Tiranë? Pse në Rajonin Perëndimor ka një përqindje të madhe të popullsisë së ardhur nga rajonet malore të Shqipërisë? Nxënësve u kërkohet të diskutojnë dhe të japin mendimet e tyre.</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: center; margin-top: 20px;"> <div style="border: 1px solid black; border-radius: 50%; padding: 10px; text-align: center;">Tiparet e popullimit</div> <div style="border: 1px solid black; border-radius: 50%; padding: 10px; text-align: center;">Popullimi R. Perendimor</div> <div style="border: 1px solid black; border-radius: 50%; padding: 10px; text-align: center;">Migrimi dhe tiparet ne RP</div> </div>	
<p>Diskutim</p> <p>Nxënësit diskutojnë çështjet më kryesore në formën e pyetjeve që ata drejtojnë pasi kanë lexuar tekstin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pse themi se Rajoni Perëndimor dallohet për popullim të hershëm dhe të dendur? - Pse Rajoni Perëndimor dallohet për shtim të lartë të popullsisë pas viteve 1990? - Cilët janë treguesit që identifikojnë trashëgiminë e pasur kulturore të rajonit Perëndimor? - Si paraqiten tiparet strukturore të popullsisë së rajonit Perëndimor? Sillni shembuj konkretë. - Pse Rajoni dallohet për përqindjen e madhe të popullsisë qytetare dhe asaj në moshë të re? - Renditni qytetet më të rëndësishme të këtij Rajoni dhe disa nga funksionet kryesore të tyre 	

- Cilët janë faktorët që kanë përcaktuar lëvizjen migruese të popullsisë drejt rajonit Perëndimor?
- Si paraqiten lëvizjet migruese të popullsisë në këtë rajon gjatë periudhave të ndryshme historike (1945.... Sot)
- Pse themi që prirja për të migruar drejt Rajonit P. ka qenë e pritshme? Argumentoni përgjigjen.
- Si paraqitet shpërndarja e popullsisë në këtë rajon, sipas qarqeve, ndikuar dhe nga fluksi migrues i popullsisë?
- Pse themi se migrimi në këtë rajon është shoqëruar me pasoja negative dhe positive? Jepni shembuj nga praktika e përditshme.

Organizmi grafik i informacionit, shkëmbimi ideve, rrjeti i diskutimit

Nxënësve u kërkohet të plotësojnë tabelën e mëposhtme pasi kanë diskutuar çështjet më kryesore mbi popullimin e Rajonit Perëndimor

Nr	Arsyet e lëvizjes drejt Rajonit Perëndimor	Strukturat që kanë ndryshuar	Prirjet e ndryshimit të tyre në të ardhmen
1	-	-	-
2	-	-	-
3	-	-	-
4	-	-	-
5	-	-	-
	-	-	-

Nxënësit japin mendimet e tyre pro dhe kundër mbështetur në argumente për:

Efektet e migrimit drejt Rajonit Perëndimor kanë sjellë më shumë pasoja pozitive apo negative për rajonin?

PO

Arsyet

JO

Arsyet

Përfundimet

Vlerësimi:**Nxënësi***Niveli 2:*

- Identifikon karakteristikat kryesore të popullimit të këtij rajoni, shkaqet e pasojat e lëvizjes drejt tij, ndryshimet strukturore të popullsisë së këtij rajoni.
- Identifikon shpërndarjen e popullsisë brenda rajonit pa identifikuar faktorët dhe pasojat.
- Plotëson me ndihmë organizuesit grafikë pa interpretuar të dhënat.

Niveli 3:

- Përshkruan karakteristikat kryesore të popullimit të këtij rajoni, shkaqet e pasojat e lëvizjes drejt tij, ndryshimet strukturore të popullsisë së këtij rajoni.
- Përshkruan shpërndarjen e popullsisë brenda rajonit.
- Plotëson në mënyrë të pavarur organizuesit grafikë por nuk interpreton të dhënat.

Niveli 4:

- Analizon karakteristikat kryesore të popullimit të këtij rajoni, shkaqet e pasojat e lëvizjes drejt tij, ndryshimet strukturore të popullsisë së këtij rajoni.
- Interpretë shpërndarjen e popullsisë brenda rajonit pa identifikuar faktorët dhe pasojat.
- Plotëson saktë organizuesit grafikë dhe interpreton të dhënat.




Shembull**Tabela 3: Model planifikimi ditor me dy orë të njëpasnjëshme, Klasa 10****Tema mësimore:****Tërmetet dhe dukuria e formimit të tyre, tipet e tërmeteve dhe pasojat e tyre.****Shpërndarja gjeografike e tërmeteve (njohuri të reja dhe veprimtari praktike)**

Situata e të nxënit: Në 6 shkurt 2023 një tërmet i fuqishëm me magnitudë 7.8 ballë shkallës Rihter goditi Turqinë dhe Sirinë. Ai u shoqërua pas disa orësh nga një gotitje tjetër me magnitudë 7.6 të shkallës Rihter. Ky tërmet solli pasojat katastrofike si në humje jete ashtu dhe ndërtime. Ky tërmet sipas studiuesve lidhet me aktivitetin sizmik në thyerjen e Anadollit Lindor. Nisur nga ky fakt dhe ngjarje të tilla të ngjashme në rajon dhe në vend nxënësit nxiten të mendojnë për tërmetet, veçoritë e tyre, përhapjen dhe si duhet të veprojnë në raste të rënies së tërmeteve?


<p>Rezultatet e të nxënët</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Shpjegon dukurinë e formimit të tërmeteve. ✓ Diferencon tipet e tërmeteve sipas thellësisë dhe origjinës. ✓ Përdor hartën dhe teknologjinë për të lokalizuar shpërndarjen gjeografike të tërmeteve. ✓ Diskuton mbi pasojat e tërmeteve përmes shembujve nga vendi e bota, masat për parandalimin e tyre dhe rolin e sizmologut. 	<p>Fjalët kyce:</p> <p>tërmet, hipoqendër, epiqendër, valë simike, magnitudë, shkalla Rihter, zonë sizmike, pllaka tektonike, tërmete vullkanike, antropogjenë, të shembjes, zona sizmike , etj.</p>
<p>Burimet/mjetet/materialet: Teksti i nxënësit , figurat e ndërtuara në dërrasë, klasa digjitale, foto, harta e botës, harta skicë e botës, fletore, lapsa, bojërat, https://www.emsc-csem.org/Earthquake/europe/, etj</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose temat ndërkurrikulare:</p> <p>Mjedisin, TIK-un, ndërvarësia, shkencat e natyrës etj</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>Parashikimi (përgatitja për të nxënë) Parashikim me terma paraprakë, diskutimi i ideve kryesore</p> <p>U kërkohet nxënësve të diskutojnë idetë dhe mendimet e tyre në lidhje me situatën e të nxënët dhe termave kryesore që identifikojnë të gjithë dukurinë sizmike</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Termat: <i>sizma, simograf, magnitudë, ballë, epiqendër, hipoqendër, zonë simike.</i> ▪ Kujtoni momentet kur ndodh një tërmet? Çfarë ndodh? ▪ Çfarë ju kanë thënë më të rriturit për veprimet që duhet të bëni kur ndodh një tërmet? A keni simuluar në shkollë një situatë kur bie tërmet? ▪ Pse vendi ynë konsiderohet si vend më sizmicitet të lartë? 	
<p>Ndërtimi i njohurive (përpunimi i përmbajtjes) Pyetje- përgjigje, harta e konceptit, ndërtim i hartës</p>	

Nxënësit punojnë me tekstin. Nxënësit drejtojnë pyetje të cilat diskutohen me mbështetjen e mësuesit.

<p>Çfarë janë tërmetet? Cilat janë pjesët e një tërmeti (fig)? Si klasifikohen tërmetet sipas thellësisë?</p>	<p>Si klasifikohen tërmetet sipas shkaqeve të formimit zonat me lëvizjet më të shumta sizmike në botë?</p>
<p>Çfarë është forca e tërmetit? Si përcaktohet magnituda dhe intensitetit i tij? Po shkalla Rihter?</p>	<p>Cilat janë pasojat e tërmeteve? Cila është historia e tërmeteve në Shqipëri?</p>



Përgjigjet e pyetjeve shoqërohen me ndërtimin e figurave apo skemave dhe organizmin grafik të informacionit :



Konkretizimi i informacionit të marrë për tërmetet (veprimtaria praktike-përhapja gjeografike e tërmeteve).

Hapat

- 📖 Çdo nxënës është pajisur me hartën skicë të botës.
- 📖 Nxënësit plotësojnë vetë legjendën e hartës ku përmes ngjyrave apo numrave (simboleve) evidentojnë zonat sizmike (brezat simikë) psh: me ngjyrë të verdhë (ose me rrathë të verdhë) brezi mesdhetar,brezi përreth Paqësorit etj.
- 📖 Pas përcaktimit të legjendës ata vendosin në hartën skicë zonat sizmike sipas legjendës që ata kanë përcaktuar vetë.
- 📖 Gjatë plotësimit ata ndihmohen dhe nga harta fiziko-gjeografike, harta e pllakave tektonike të cilat tregohen në tabelën digjitale.

Përforcimi (konsolidimi i të nxënit): Turi i galerisë, interpretimi i hartës së ndërtuar

Pas plotësimit të hartës nxënësit paraqesin punimet e tyre dhe më tej ata diskutojnë dhe interpretojnë.

- 📖 Cila është lidhja midis kufijve të pllakave tektonike dhe përhapjes së brezave sizmikë
- 📖 Në cilin brez sizmik bën pjesë vendi ynë?
- 📖 Si të veprojnë kur bie tërmet?

Në përmbyllje nxënësit me ndihmën dhe të teknologjisë së informacionit shohin video, imazhe dhe mësimet online për rrugët dhe format se si ata të sillen në rast se ndodh një tërmet kur ata gjenden në: *shtëpi, rrugë dhe shkollë.*

Vlerësimi:

Niveli 2:

Nxënësi

- Identifikon dukurinë e formimit të tërmeteve, zonave sizmike dhe pasojat.
- Identifikon tiparet dalluese të llojeve të tërmeteve sipas origjinës dhe thellësisë;
- Plotëson me ndihmë organizuesit grafikë (skemat, foto, imazhe) pa interpretuar të dhënat;

Niveli 3:

Nxënësi

- Përshkruan dukurinë e formimit të tërmeteve, zonave sizmike dhe pasojat.
- Përshkruan tiparet dalluese të llojeve të tërmeteve sipas origjinës dhe thellësisë;
- Plotëson në mënyrë të pavarur organizuesit grafikë (skemat, foto, imazhe) por nuk interpreton

Niveli 4:

Nxënësi

- Analizon dukurinë e formimit të tërmeteve, zonave sizmike dhe pasojat.
- Interpreton tiparet dalluese të llojeve të tërmeteve sipas origjinës dhe thellësisë;
- Plotëson saktë organizuesit grafikë (skemat, foto, imazhe) dhe interpreton të dhënat.

Reflektim, vetëvlerësim, informacion për vlerësimin e nxënësve

Detyrat dhe puna e pavarur: Simulim në klasë i veprimeve që duhet të bëjnë nxënësit në rast tërmeti.

Shembull

Tabela 4: Model planifikimi ditor, Klasa 10

Tema mësimore: Hëna	
Situata e të nxënët: Misioni “Apollo”. Bazuar në njohuritë e mëparshme dhe ato që nxënësit do të zhvillojnë përgjatë orës mësimore, nxënësit diskutojnë mbi eksplorimin e Hënës nga njeriu (formën, krateret, përbërjen etj).	
Rezultatet e të nxënët: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">- Interpreton hipotezën e formimit të Hënës.- Përshkruan ndërtimin e Hënës dhe veçoritë fizike të saj.- Modelon formimin e fazave të Hënës dhe eklipseve.- Ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale.	Fjalët kyce: Hëna, fazat e hënës, muaji sinodik, eklipsi i Diellit, eklipsi i Hënës, zonat e ndriçuara, zonat e errëta etj
Burimet/mjetet/materialet: Teksti i nxënësit, foto nga fazat e hënës dhe zbritja e njeriut të parë, llambë/abazhur, top etj.	Lidhja me fushat e tjera ose temat ndërkurrikulare: TIK- un, ndërvarësinë, shkencat e natyrës, fizikën etj
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	

Brainstorming


Nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin dhe evidentojnë veçoritë:

- Çfarë dini ju për pamjen e Hënës dhe ndryshimin periodik të saj? A keni parë më parë eklips diellor dhe hënor? Si e shpjgoni thënien e gjyshit\gjyshes “Hëna pesëmbëdhjetë”?


Lexim i drejtuar

Nxënësit lexojnë tekstin pasi kanë marrë udhëzimet nga mësuesi rreth çështjeve ku ata duhet të fokusohen. Trajtimi i çështjeve mbështetet dhe nga mësuesi përmes ndërtimit të figurave si më poshtë.

- Cilat janë veçoritë fizike të Hënës? Çfarë pamje ka Hëna?
- Cilat është origjina e formimit të saj? Si duket ajo?
- Çfarë lëvizje bën Hëna? A keni dëgjuar më parë për fazat e saj?
- Si ndodhin eklipset? Çfarë dini për eklipsin e Hënës dhe atë të Diellit?




Përmes demonstrimit me një llambë elektrike dhe një topi nxënësit në grupe modelojnë formimin e fazave të Hënës dhe të eklipseve.



Harta e konceptit

Informacioni i marrë për Hënë organizohet grafikisht në mënyrë individuale nga nxënësit.:



Vlerësimi:

Nxënësi

Niveli 2:

- Përshkruan një ndër elementet – ndërtimin e Hënës/ veçoritë fizike të saj/origjinën e formimit.
- Identifikon me ndihmë fazat e Hënës dhe eklipset.
- Plotëson me ndihmën e mësuesit organizuesin grafik.

Niveli 3:

- Përshkruan dy ndër elementet – ndërtimin e Hënës/ veçoritë fizike të saj/origjinën e formimit. Përshkruan fazat e Hënës dhe eklipset.
- Plotëson në mënyrë të pavarur organizuesin grafik dhe nuk e interpreton atë.

Niveli 4:

- Përshkruan ndërtimin e Hënës, veçoritë fizike të saj dhe origjinën e formimit.
- Interpretin fazat e Hënës dhe dallon eklipset.
- Plotëson organizuesin grafik dhe e interpreton atë.
- Vlerëson rëndësinë e Hënës për dukuritë që ndodhin në Tokë.

Shembull

Tabela 5: Model planifikimi ditor, Klasa 10

Tema mësimore: Zonat klimatike	
Situata e të nxënësve: Mbështetur në informacionet e marra në klasat paraardhëse pse themi që vendi ynë ka klimë subtropikale mesdhetare? Cilët janë faktorët që kushtëzojnë këtë lloj klime? Cili është ndikimi i anticiklonit të Azoreve dhe të Afrikës Veriore në klimën e rajonit dhe vendit tonë?	
Rezultatet e të nxënësve Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">☒ Përcakton zonat klimatike sipas gjerësisë gjeografike dhe përshkruan veçoritë e tyre.☒ Argumenton, me gojë ose shkrim, pasojat e ndryshimeve klimatike dhe politikat menaxhuese në nivel kombëtar e global në lidhje me to.☒ Vlerëson rëndësinë e klimës në komponentët përbërës të mjedisit gjeografik.	Fjalët kyçe: : Zona klimatike, klimë malore, klimë lokale, mikroklime, tip i klimës, ndikim kontinental, ndikim detar, etj.
Burimet/mjetet/materialet: Teksti i nxënësit, harta e botës për shpërndarjen zonale të klimës, informacion digjital etj.	Lidhja me fushat e tjera ose temat ndërkurrikulare: Mjedisi, zhvillimi i qëndrueshëm, ndërvarësia, TIK, etj.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Parashikimi (përgatitja për të nxënë) Imagjinatë e drejtuar, Stuhi mendimesh

Duke menduar se po jetoni në një vend tjetër ndryshe nga Shqipëria si në: *vendet polare* (te jeni studiues) dhe në *gjerësitë ekuatoriale* (xhungël) përcaktoni cilat janë tiparet e klimës në këto vende si temperatura, lagështira, erërat, bota bimore dhe shtazore. Nxënësit diskutojnë mendimet dhe idetë e tyre.

Ndërtimi i njohurive (përpunimi i përmbajtjes) Përvijim i të menduarit

Nxënësit lexojnë dhe nënvizojnë tekstin sipas udhëzimeve të mësuesit. Ata nga leximi

përcaktojnë tiparet kryesore të zonave klimatike duke mbajtur shënime. Në dërrasë paraqitet skematikisht një



organizues grafik ku nxënësit përcaktojnë zonat klimatike.

Gjatë plotësimit të skemës ato me ndihmën e mësuesit përcaktojnë shtrirjen e tyre gjeografike në hartë dhe diskutojnë për:

- ✧ Si shprehet zonaliteti horizontal dhe vertikal i klimës?
- ✧ Po ekzistenca e klimave lokale dhe mikroklimave me cilët faktorë lidhet?

Përforsimi (konsolidimi i të nxënësit): Shkrim i lirë (paragraf argumentues)

Nxënësit shkruajnë përmes argumentave dhe shembujve konkretë për këto dy çështje (zgjedhin njërin nga çështjet).

- ✎ përmes shembujve argumentoni pasojat e ndryshimeve klimatike në nivel rajonal e global
- ✎ përmes shembujve konkretë evidentoni rëndësinë e klimës në një nga komponentët e mjedisit gjeografik

Nxënësit ndajnë idetë e tyre me njëri-tjetrin.

- Vlerësimi:

Niveli 2:

Nxënësi


📖 identifikon zonat klimatike sipas gjerësisë gjeografike dhe veçoritë e tyre;

📖 identifikon pasojat e ndryshimeve klimatike dhe politikat menaxhuese në nivel kombëtar e global.

- plotëson me ndihmë organizuesit grafikë (skemat, foto, imazhe) pa interpretuar të dhënat.

Niveli 3:

Nxënësi

 përshkruan zonat klimatike sipas gjerësisë gjeografike dhe veçoritë e tyre;

- përshkruan pasojat e ndryshimeve klimatike dhe politikat menaxhuese në nivel kombëtar e global.
- plotëson në mënyrë të pavarur organizuesit grafikë (skemat, foto, imazhe) por nuk interpreton të dhënat.

Niveli 4:

Nxënësi

 analizon zonat klimatike sipas gjerësisë gjeografike dhe veçoritë e tyre;

- interpreton pasojat e ndryshimeve klimatike dhe politikat menaxhuese në nivel kombëtar e global.
- plotëson saktë organizuesit grafikë (skemat, foto, imazhe) dhe interpreton të dhënat.

Detyrat dhe puna e pavarur: Greta Thunberg dhe ndryshimet klimatike..... roli i aktivistit në pasojat e ndryshimeve klimatike dhe masat për përballimin e tyre.

Shembull

Tabela 6: Model planifikimi ditor, Klasa 11

Tema mësimore: Tiparet e zhvillimit demografik të Rajonit Verior - Verilindor	
Situata e të nxënit: Reportazh...nxënësit ftohen të lexojnë një reportazh për Thethin. Gjatë leximit përmenden: kreshnikët, kulla e ngujimit, Bjeshkët e Namuna, zanat, popullsi e larguar, turistë të huaj. Reportazhi shoqërohet dhe me foto dhe video.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës/lëndës sipas temës së mëimit:	Fjalët kyce: popullim, labeatët, kulla e ngujimit, shpërndarje e popullsisë, popullsi katolike, vendbanime fshatare, vendbanime qytetare, trashëgimi kulturore, kultura e Komanit, monumente arkeologjike, monumente arkitektonike, monumente fetare, etnografi, folklor, etj.
<ul style="list-style-type: none"> ☒ Evidenton tiparet kryesore të zhvillimit demografik të Rajonit Verior – Verilindor; ☒ Vlerëson rëndësinë e trashëgimisë kulturore të Rajonit Verior dhe Verilindor. 	

<p>Burimet/mjetet/materialet: Teksti i nxënësit, harta fizike e Shqipërisë, Atlasi gjeografik i Shqipërisë. Foto të ndryshme nga Thethi, kulla e Ngulimit, kostume popullore, etj.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose temat ndërkurrikulare: Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave, zhvillimi i qëndrueshëm, ndërvarësia, TIK-u, etj.</p>
---	---

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Parashikimi (përgatitja për të nxënë) Stuhi mendimesh

Nxënësit mbështetur në reportazhin dhe pamjet japin ide lidhur me:

- Cili është roli i kushteve natyrore në tiparet e popullimit të Alpeve dhe pjesëve të tjera të nënrajonit Verilindor?
- Si kanë ndikuar faktorët historikë, politikë, ekonomikë në tiparet e popullimit të rajonit?
- Çfarë informacioni keni për kullën e ngujimit dhe Eposin e kreshnikëve?



Kulla e ngujimit

Ndërtimi i njohurive (përpunimi i përmbajtjes) Përvijim i të menduarit organizimi grafik i informacionit

Nxënësit lexojnë dhe nënvizojnë tekstin sipas udhëzimeve të mësuesit. Ata të ndarë në katër grupe gjatë leximi përcaktojnë tiparet kryesore të popullimit të këtij rajoni duke mbajtur shënime. Në dërrasë paraqitet skematikisht një organizues grafik ku nxënësit përcaktojnë tiparet e popullimit për njësitë e mëposhtme përbërëse të rajonit Veri-Verilindor:


Tiparet	Popullimi i Alpeve shqiptare	Popullimi i malësive të: Hasit, Gjakovës, Martaneshit, Pukë-Mirditë, Gollobordës, Çermenikës	Popullimi i luginës së Drinit të Zi, lugut të Matit	Popullimi i malet e Lurës dhe shpatet e Korabit
Numri i popullisë, ecuria				
Shpërndarja gjeografike e popullisë				

Raporti qytet-fshat				
Trashëgimia kulturore				

Përforcimi (konsolidimi i të nxënit) Rrjeti i diskutimit

A ka diferenca të dukshme ndërmjet popullimit të Nënrajonit Verior dhe atij Verilindor? Nxënësit shpjegojnë arsyet e zgjedhjes së tyre e diskutojnë qëndrimet mbështetur në fakte dhe shembuj konkretë.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për:

 Analizën e tipareve kryesore të zhvillimit demografik të Rajonit Verior – Verilindor;

Niveli 2:

- Identifikon tiparet kryesore të zhvillimit demografik të Rajonit Verior – Verilindor
- Identifikon faktorët ndikues në popullimin e ndryshëm të nënrajonit Verilindor nga ai Verior;
- Plotëson me ndihmë organizuesit grafikë (skemat, foto, imazhe) pa interpretuar të dhënat.

Niveli 3:

- Përshkruan tiparet kryesore të zhvillimit demografik të Rajonit Verior – Verilindor
- Përshkruan faktorët ndikues në popullimin e ndryshëm të nënrajonit Verilindor nga ai Verior;
- Plotëson në mënyrë të pavarur organizuesit grafikë (skemat, foto, imazhe) por nuk interpreton të dhënat.

Niveli 4:

- Analizon tiparet kryesore të zhvillimit demografik të Rajonit Verior – Verilindor
- Interpreton faktorët ndikues në popullimin e ndryshëm të nënrajonit Verilindor nga ai Verior;
- Plotëson saktë organizuesit grafikë (skemat, foto, imazhe) dhe interpreton të dhënat.

Detyrat dhe puna e pavarur: Krijoni një udhërrëfyes turistik ku të përfshini objektet e trashëgimisë kulturore që duhen vizituar në Rajonin Veri-Verilindor.

VIII. VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi i nxënësve është procesi gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së rezultateve të të nxënësve (njohuri, shkathtësi, qëndrime) bazuar në nivelet e arritjes.

Qëllimi kryesor i vlerësimit të nxënësve në lëndën e gjeografisë është përmirësimi i përmbushjes së rezultateve të të nxënësve nga nxënësi dhe i vetë procesit të të nxënësve. Vlerësimi i nxënësve mbështetet tërësisht në rezultatet e të nxënësve të programeve mësimore të gjeografisë dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato rezultate që nuk përshkruhen në program.

Më poshtë përshkruhen disa ndër parimet kryesore të vlerësimit të nxënësve në lëndën e gjeografisë:

- ☞ *Vlerësimi duhet të jetë i drejtë, i paanshëm dhe i barabartë, duke u dhënë të gjithë nxënësve mundësinë për të demonstruar tërësinë e dijeve, aftësive dhe mundësive të tyre.*
- ☞ *Vlerësimi duhet të ofrojë informacion mbështetës për nxënësin.*
- ☞ *Vlerësimi duhet të ushqejë aftësitë e nxënësve për të transferuar dijet e tyre në përvoja jetësore.*
- ☞ *Vlerësimi duhet të nxisë pjesëmarrjen aktive dhe vetëvlerësimin e nxënësve për të reflektuar mbi të nxënësit e tyre.*
- ☞ *Vlerësimi duhet të mundësojë shanse të barabarta për zhvillimin dhe përmirësimin e nxënësve.*
- ☞ *Vlerësimi duhet të përfshijë jo vetëm matjen, por dhe interpretimin e gjykimin.*
- ☞ *Vlerësimi duhet të jetë pjesë integrale e të gjithë orës së mësimin dhe jo një moment në fund të saj.*
- ☞ *Vlerësimi duhet t'u komunikohet rregullisht prindërve/kujdestarëve dhe nxënësve në një mënyrë sa më kuptimplotë.*

Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta

Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta duhet të bëhet në mënyrë të tillë që t'u japë atyre mundësinë të demonstrojnë çfarë dinë dhe mund të bëjnë në përmbushje të rezultateve të të nxënësve. Për këtë qëllim mësuesi duhet të përshtasë detyrat/veprimtaritë vlerësuese me mundësitë dhe nevojat që këta nxënës kanë. Këto modifikime mund të përfshijnë:

- Ndryshimin/përshtatjen e formateve alternative të pyetje/përgjigjeve, p.sh. një formë të përgjigjes më të thjeshtuar (bazuar në disa pika orientuese) në vend të një eseje që duhet të përgatisin nxënësit.
- Modifikime të veprimtarive vlerësuese, p.sh. duke thjeshtuar gjuhën e përdorur, ose duke përdorur një format tjetër të pyeturi.
- Përshtatje të procesit të vlerësimit, p.sh. duke i dhënë kohë shtesë nxënësit, me pauza të ndërmjetme, duke përdorur një lexues ose teknologji specifike.

Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herëpashere me prindërit dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

8.1. Teknika dhe instrumente të vlerësimit të nxënësve në lëndën e gjeografisë

Lënda e gjeografisë për vetë karakterin e saj ndërdisiplinor mundëson forma të shumta vlerësimi. Mësuesi zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi. Disa ndër format e vlerësimit të nxënësit në lëndën e gjeografisë janë:

- *Vlerësimi individual* (p.sh. i një nxënësi, me gojë ose me shkrim);
- *Vlerësimi në grup* (grupi 5-6 nxënës ose më shumë apo më pak, kur nxënësi realizon një projekt apo detyrë kërkimore);
- *Vlerësime në çift dhe vetëvlerësimi* (p.sh. shoku i bankës vlerëson detyrën apo përgjigjen e shokut dhe anasjelltas apo nxënësi vlerëson veten për realizimin e detyrës, përgjigjes ose testit)
- Etj.

Këto forma vlerësimi duhet t'u krijojnë mundësi të gjithë nxënësve të vlerësohen në atë mënyrë që është më e përshtatshme për to.

Disa ndër teknikat dhe strategjitë për vlerësimin e nxënësve në gjeografi janë:

Detyrat individuale	Detyrat individuale në lëndën e gjeografisë duhet të synojnë zbatimin e njohurive, zgjidhjen e problemeve, nxjerrjen e përfundimeve dhe ndërlidhjen me jetën reale.
	Përmes kësaj metode mundësohet zgjedhja dhe përdorimi i provave (dëshmime) për të identifikuar, përshkruar, analizuar dhe për të nxjerrë konkluzione në lidhje me një çështje gjeografike ose problem të veçantë. Nxënësit duhet të

Projektet individuale	përfshihen në një sërë aktiviteteve për një kohë të konsiderueshme në mënyrë që të punojnë në mënyrë individuale. Bazohen në shfrytëzimin e burimeve sekondare – të dhëna të siguruar nga mësuesi dhe në burimet primare që përfshijnë grumbullimin e të dhënave nga burimet e ndryshme përfshirë terrenin.
Projektet në grup	Projektet në grup zhvillojnë përgjegjësi individuale, ndërvarësinë sociale dhe shkathhtësitë e nxënësve në lidhje me lëndën. Momentet më delikate të punës me projekte në grup kanë të bëjnë me formën e organizimit të veprimtarive, identifikimin e roleve të anëtarëve të grupit, produktin që duhet përgatitur.
Veprimtaritë praktike	Veprimtaritë praktike janë një ndër llojet e detyrave vlerësuese më të përdorura dhe efikase në gjeografi. Zhvillimi i tyre kërkon që mësuesi të japë udhëzime dhe vërejtje të nevojshme në mënyrë që të zhvillohen kompetencat e caktuara.
Testet dhe esetë	Përmes tyre, vlerësimi i arritjeve të nxënësve bëhet në mënyrë të shpejtë dhe të besueshme. Testet dhe esetë sigurojnë mundësi për përfshirjen e nxënësve në riorganizimin e fakteve dhe ideve, dhënien e argumenteve për të përmirësuar efektivitetin e nxënies. Janë shumë motivuese për disa nxënës e në veçanti për nxënësit që kanë dëshirë shkrimin. Karakteristikë e secilës prej tyre është se zhvillohen me kohëzgjatje të kufizuar.
Veprimtari krijuese	Veprimtaritë krijuese krijojnë mundësi për matjen e të kuptuarit të koncepteve, zhvillimin e imagjinatës dhe të aftësive krijuese. Të tilla mund të jenë përgatitja e posterave, maketeve, albumeve, guidave turistike etj.
Vetëvlerësimi	Përmes vetëvlerësimit, nxënësit përfshihen në analizën kritike të punës së tyre, nxitet të nxënësit e pavarur, reflektojnë mbi

	procesin e tyre të të nxënit, sidomos në lidhje me vështirësitë që hasin dhe identifikojnë çfarë duhet të zhvillojnë në të ardhmen.
Vlerësimi nga njëri-tjetri	Ky lloj vlerësimi i aftëson nxënësit të bëjnë gjykime, të japin informacion bazuar në to, të mësojnë dhe të mbështesin njëri-tjetrin, nxënësit zhvillojnë përgjegjësi për progresin e tyre.

Një nga momentet më të mprehta të vlerësimit të nxënësve në lëndën e gjeografisë është sigurimi i ndërveprimit mësues-nxënës dhe nxënës-nxënës. Në këtë proces ndërveprimi, **TË PYETURIT** është një nga aspektet qëndrore që mbisundon në marrëdhëniet mësues-nxënës, nxënës-nxënës dhe ndikon në efektivitetin e këtij procesi.

Të pyeturit nuk është vetëm ai proces që shërben për të përcaktuar se kush e di përgjigjen e saktë, por është një proces që shërben për të mbështetur nxënësin, për t'i dhënë kompetenca atij, duke bërë që të shkohet drejt përgjigjes në rrugë të ndryshme. Në mënyrë që të zhvillojnë aftësi të larta të të menduarit, nxitini nxënësit të parashtrojnë pyetje, jo vetëm të përgjigjen!

Një ndër teknikat e të pyeturit në mësimdhënien e gjeografisë është harta e të pyeturit. Harta e të pyeturit është një skicë që shfaq idetë e rëndësishme të një çështje gjeografike, të vendosura në një renditje logjike në trajtën e një skeme racionale pyetjesh, që lexohen dhe kuptohen me lehtësi nga nxënësit.


Përdormi i kësaj teknike ka disa përparësi:

- Hap rrugën për diskutim.
- Ndihmon nxënësit për të zhvilluar aftësi të larta të të menduarit.
- Tërheq nxënësit në punët e pavaruara.
- Rrit rolin e nxënësve në mësim.
- Nxit të menduarit logjik.
- Nxit dhe tërheq nxënësit pasivë.

Një hartë e të pyeturit mund të përdoret për të menduar rreth çdo lloj çështjeje ose tematike gjeografike. Gjithashtu, ajo mund të përdoret për të gjallëruar diskutimin e nxënësve, për t'i mbajtur ata të interesuar rreth problemit dhe për të përmbledhur informacionin e trajtuar.

Për të përpiluar një hartë të pyeturi:

- Shkruhet çështja/dukuria gjeografike që do të trajtohet në qendër të tabelës.
- Pas kësaj ndërtohet skema me pyetje në të cilën pas pyetjeve kyç gjenden të lidhura edhe pyetje të tjera që zgjerojnë hartën.



Pyetje të mira janë ato lloj pyetjesh të cilat nxisin nxënësit të mendojnë, të kërkojnë dhe të reflektojnë mbi to dhe jo pyetje që kërkojnë riprodhim të fakteve apo të dhënave.

8.2. Përdorimi i niveleve të arritjeve dhe vlerësimi bazuar në kritere

Vlerësimi bazuar në kritere u siguron nxënësve informacion rreth cilësive, karakteristikave dhe aspekteve të një detyre/veprimtarie vlerësuese e cila përdoret për të matur arritjen e rezultateve të të nxënit.

Vlerësimi bazuar në kritere:

- Lidh rezultatet e të nxënit me detyrat/veprimtaritë për përmbushjen e tyre.

- Përcakton nivelet e performancës së nxënësve referuar niveleve të arritjeve.
- I ndihmon nxënësit të kuptojnë pritshmëritë.
- U jep nxënësve mundësi të vlerësojnë performancën e tyre.

Numri i kritereve që mësuesi përcakton nuk duhet të jetë i madh pasi krijon konfuzion te nxënësit.

Kriteri përcakton karakteristikat e performancës, por nuk përcakton “sa mirë” i demonstrojnë nxënësit këto karakteristika – e cila është detyrë e niveleve të arritjeve.

Nivelet e arritjeve shprehin rezultatet e ndryshme që arrijnë nxënës të ndryshëm në përpjekjet e tyre për të përmbushur arritjen e dëshiruar (e pritshme) prej tyre në një lëndë. ***Për të përcaktuar nivelin e arritjes së nxënësit duhen bërë një sërë vëzhgimesh dhe duhen përdorur një sërë instrumentesh vlerësimi të cilat duhet t’i shërbejnë progresit të nxënësit.***

Mësuesi duhet t’i krijojë çdo nxënësi mundësinë e të nxënët në të gjitha nivelet, sikurse t’i japë mundësinë që të demonstrojë arritjet e tij në të gjitha nivelet. Kjo do të thotë që mësuesi:

- të mundësojë situata të nxëni në përputhje me rezultatet e pritshme.
- të përzgjedhë veprimtari mësimore gjatë të cilave nxënësit demonstrojnë nivelin e tyre të arritjeve dhe u krijohet mundësi për progres.
- të vlerësojë nxënësit në përputhje me nivelet e tyre të arritjeve (performancën).

Në veçanti, nivelet e arritjeve ndihmojnë mësuesin për të planifikuar mësimdhënien individuale, punën e diferencuar me nxënësit, për të ndikuar pozitivisht në progresin e tij dhe për të raportuar të nxënët e nxënësit.

Mësuesi duhet të ketë të qartë dallimet ndërmjet niveleve të arritjeve, të shprehura si më poshtë:

- ***Niveli 1:*** Nxënësit në këtë nivel demonstrojnë një shkallë të pamjaftueshme të zotërimit dhe zbatimit të njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve.
- ***Niveli 2:*** Nxënësit në këtë nivel zotërojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime dhe i zbatojnë ato në situata të përcaktuara/të njohura; ata kryejnë detyra sipas modeleve të ofruara.
- ***Niveli 3:*** Nxënësit në këtë nivel zotërojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime dhe i zbatojnë ato në situata analoge ose të ngjashme; ata shprehin qëndrimin e tyre personal, duke vepruar më shumë në nivelin e pohimeve dhe konkluzioneve të formuluar se sa në nivel analize.
- ***Niveli 4:*** Nxënësit në këtë nivel zotërojnë njohuri, aftësi, qëndrime dhe i zbatojnë ato në mënyrë të pavarur dhe krijuese, në situata të reja dhe të panjohura për ta; ata janë të aftë të zgjidhin situata problemore të ndryshme, të mbrojnë pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre bazuar në argumente.

Shembull

Më poshtë paraqitet një shembull i përcaktimit të kriterëve të vlerësimit bazuar në nivelet e arritjeve.

Nxënësi:

- identifikon në zonën e tij problemin për të cilin do të hetojë;
- përcakton faktorët që e shkaktojnë problemin në zonën e tij;
- ofron zgjidhje të mundshme të problemit.

Përshkruesit/nivelet e arritjeve:

Kriteret	Niveli II	Niveli III	Niveli IV
Identifikon në zonën e tij problemin për të cilin do të hetojë.	Bën supozime që lidhen pak a shumë me problemin;	Identifikon elemente të problemit që duhet zgjidhur	Identifikon problemin që duhet zgjidhur në zonën ku banon
Përcakton faktorët që e shkaktojnë problemin në zonën e tij.	Dallon faktorë të problemit pa e lidhur me rastin konkret	Identifikon faktorë të mundshëm që e shkaktojnë problemin në zonën e tij	Përcakton faktorët që e shkaktojnë problemin mbi bazën e të dhënave të besueshme të mbledhura
Ofron zgjidhje të problemit	Identifikon zgjidhje të problemit që nuk lidhet me situatën konkrete në zonën e tij.	Përcakton zgjidhje të mundshme të problemit në zonën e tij.	Propozon zgjidhje të problemit mbi bazën e vlerësimit të risqeve dhe përfitimeve të mundshme

8.3. Llojet e vlerësimit

Vlerësimi i nxënësit kryhet nëpërmjet:

- A. Vlerësimit të vazhduar
- B. Vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse
- C. Vlerësimit me projekt kurrikular

A. Vlerësimi i vazhduar (për të nxënë)

- **Vlerësimi i vazhduar për të nxënë është pjesë e mësimdhënies dhe motivon përparimin e nxënësit në të gjitha aspektet e të nxënës, në situata të ndryshme të njohura dhe të panjohura.**
- Vlerësimi i vazhduar bazohet në vëzhgimet dhe në gjykimet e mësuesit mbi përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët në grup, diskutimet, vetëvlerësimin e nxënësit, vlerësimin e nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjen në aktivitete dhe në debatet në klasë, vlerësimin e detyrave të shtëpisë apo të klasës etj.
- Mësuesi vlerëson nxënësin me notë në regjistër, vetëm pasi është siguruar që ky vlerësim është objektiv dhe shpreh shkallën e qëndrueshmërisë së performancës së nxënësit për një periudhë të caktuar kohe. Për këtë qëllim, mësuesi mban shënime të cilat e ndihmojnë atë për të gjykuar në lidhje me vendosjen e notës dhe për të argumentuar në çdo kohë, objektivitetin e vlerësimit të tij me notë në regjistër.
- Mësuesi shënon në regjistër *të paktën 2* (dy) vlerësime me notë për çdo periudhë për lëndët që zhvillohen me 1-2 orë në javë.
- Mësuesi nxjerr notën e vlerësimit të vazhduar për çdo periudhë duke u bazuar në notat e nxënësit në regjistër dhe në shënimet që ka mbajtur. Mësuesi merr në konsideratë balancën ndërmjet njohurive, shkathtësive, qëndrimeve, ashtu siç përshkruhet në rezultatet e të nxënës në programin lëndor.
- Mësuesi ka përgjegjësi për të informuar prindërit dhe nxënësin për ecurinë dhe mundësinë e nxënësit për progres.

B. Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse

Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse përdoret për të mbledhur prova dhe të dhëna që tregojnë nëse mësimdhënia ka realizuar qëllimin e saj, me synim monitorimin dhe raportimin e progresit. Testi/detyra përmbledhëse siguron informacion nëse përparimi i nxënësve është në rrugën e duhur apo duhen ndërmarrë hapa për zgjidhjen e ndonjë problemi të mundshëm.

Si dhe kur realizohet testi/detyra përmbledhëse?

- Vlerësimi me test ose me detyrë përmbledhëse kryhet në pjesën e fundit të periudhës.
- Mësuesi ka lirinë të përcaktojë vetë nëse do të zhvillojë test apo detyrë përmbledhëse, sipas specifikave të lëndës.
- Testi/detyra përmbledhëse planifikohet nga mësuesi, kur përmbillet një grup rezultatesh të nxëni dhe mësuesi është *i lirë ta vendosë vetë se kur do ta zhvillojë atë*.
- Testi/detyra përmbledhëse është 45 minuta.
- Drejtoria e shkollës menaxhon organizimin e testeve ose detyrave përmbledhëse sipas një grafiku, në mënyrë që të mos ngarkohet nxënësi në fund të periudhës.
- Testi/detyra përmbledhëse *jo domosdoshmërisht* bëhet në fund të periudhës. Mësuesi e përcakton vetë kohën se kur do ta zhvillojë atë.
- Në momentin kur mësuesi *vlerëson testet/detyrat përmbledhëse, i vendos* notat në regjistër.
- Mësuesi duhet *të ruajë deri në përfundim të vitit shkollor* testet ose detyrat përmbledhëse.

B.1. Detyra përmbledhëse

Detyra përmbledhëse mund të jetë një detyrë e tipit ese/raport/veprimtari praktike etj., përmes së cilës mësuesi vlerëson grupin e rezultateve të të nxënit të periudhës. Detyra përmbledhëse zhvillohet në klasë dhe ruhet sikurse testi, pasi është objekt monitorimi.

Shembull

<p style="text-align: center;">Detyrë përmbledhëse</p> <p style="text-align: center;">Klasa e 11-të</p> <p style="text-align: center;">Periudha e parë (Shtator – Dhjetor)</p>

Pasi nxënësit kanë zhvilluar njohuritë dhe aftësitë për Evropën dhe rajonin, mësuesi mund të japë një detyrë përmbledhëse të tipit ese me temë: “Perspektiva e zhvillimit të Evropës Juglindore”. Për realizimin e detyrës përmbledhëse:

- Mbi bazën e njohurive dhe aftësive që nxënësi ka zhvilluar në lidhje me veçoritë natyrore, popullsinë, ekonominë, trashëgiminë natyrore dhe kulturore të rajonit të Evropës Juglindore, gjykon mbi perspektivën e zhvillimit të këtij rajoni.
- Nxënësi jep mendimin e tij dhe argumenton përgjigjen, duke iu referuar kompleksitetit të të gjithë faktorëve, natyrorë dhe humanë.
- Mësuesi udhëzon nxënësit që të vendosin në fokus të trajtimit të detyrës dhe pozitën gjeostrategjike të hapësirës shqiptare në Evropën Juglindore, rolin e saj për zhvillimin dhe bashkëpunimin ndër rajonal e më gjerë.

Vlerësimi i nxënësve për detyrën përmbledhëse:

Nxënësi vlerësohet për shkallën e përmbushjes së rezultateve të të nxënësve të kësaj detyre mbi bazën e kriterëve që mësuesi harton sipas niveleve të arritjeve.

Kriteret e vlerësimit:

Niveli 1 (nota 4). Nxënësi dëshmon një shkallë të pamjaftueshme të përmbushjes së rezultateve të të nxënësve.

Niveli 2 (nota 5-6). Nxënësi:

- Identifikon disa prej faktorëve fizikë ose humanë që ndikojnë në shkallën e zhvillimit të rajonit pa dalluar lidhjen ndërmjet tyre.
- Evidenton pozitën gjeostrategjike të hapësirës shqiptare në Evropën Juglindore.
- Bën supozime që lidhen pak a shumë me perspektivën e zhvillimit të rajonit.
- Shpreh me fjalë të thjeshta mendimin.

Niveli 3 (nota 7-8). Nxënësi:

- Përshkruan faktorët fizikë dhe humanë që ndikojnë në shkallën e zhvillimit të rajonit.
- Përshkruan pozitën gjeostrategjike të hapësirës shqiptare në Evropën Juglindore.
- Përcakton qëndrimin e tij në lidhje me perspektivën e zhvillimit të rajonit pa e mbështetur në argumente.
- Përdor fjalor të përshtatshëm gjeografik.

Niveli 4 (nota 9-10): Nxënësi:

- *Analizon lidhjen dhe varësinë ndërmjet faktorëve fizikë dhe humanë që ndikojnë në shkallën e zhvillimit të rajonit.*
- *Vlerëson pozitën gjeostrategjike të hapësirës shqiptare në Evropën Juglindore dhe rolin e saj për zhvillimin dhe bashkëpunimin ndërrajonal e më gjerë.*
- *Argumenton qëndrimin e tij në lidhje me perspektivën e zhvillimit të rajonit.*
- *Përdor fjalor të pasur gjeografik në përmbushje të detyrës.*

B.2. Testi, kriteret e hartimit dhe vlerësimit të tij

Qëllimi kryesor i çdo testimi është përcaktimi i asaj se çfarë nxënësit dinë dhe janë në gjendje të bëjnë. Nëpërmjet tij sigurohet informacion i vlefshëm rreth efektivitetit të procesit të mësimdhënies për të mbështetur të nxënësit e nxënësve dhe progresin e tyre.

Hartimi i testeve të gjeografisë bazohet në bazat metodologjike të hartimit të testeve. Veçoria e testeve të gjeografisë buron nga natyra e kompetencave me të cilat pajisen nxënësit gjatë nxënies së kësaj lënde. Vetëm pyetjet e mira veç e veç nuk garantojnë medoemos që testi të jetë i mirë, pasi testi si një i tërë, është më shumë se një grupim i thjeshtë pyetjesh. Për këtë është me rëndësi që së pari të dihet çfarë dëshirojmë të masim, cilin rezultat të të nxënësit dëshirojmë ta realizojmë, cilën kompetencë dëshirojmë ta arrijmë.

Në vazhdim përshkruhen hapat që ndjek hartimi i një testi:

▪ **Përcaktimi i njohurive dhe rezultateve të të nxënësit që do të vlerësohen me test**

Një nga hapat më të rëndësishëm në hartimin e një testi është që brenda tematikave dhe nëntematikave të zhvilluara përgjatë periudhës të përcaktohen rezultatet e të nxënësit dhe njohuritë që do të testohen.

▪ **Përcaktimi i niveleve të vështirësisë së testit**

Në hartimin e një testi, rëndësi të veçantë ka përdorimi i niveleve të arritjeve, si një strukturë hierarkike e aftësive të të menduarit, dhe një mjet për të matur thellësinë njohëse të të mësuarit të nxënësve (shih rubrikën për nivelet e arritjeve më lart).

Kur hartojmë një test duhet të kemi parasysh që ai të jetë i vlefshëm për të gjithë. Nëse ne do të hartonim një test me pyetje kryesisht të nivelit bazë (ulët), atëherë ne nuk do t'u jepnim mundësi nxënësve të shfaqnin siç duhet aftësitë e tyre mendore.

E kundërta do të ndodhte nëse do të hartoheshin kryesisht pyetje të nivelit të lartë. Në rastin e parë ne do të diskriminojmë nxënësit me arritje të larta dhe në rastin e dytë nxënësit me arritje të ulëta. Niveli i vështirësisë së testit në klasat 10-12 në lëndën e gjeografisë, rekomandohet të jetë:

- Nga 40% deri në 30% - Niveli bazë
- Nga 40% deri në 45% - Niveli mesatar
- Nga 20% deri në 25% - Niveli i lartë

▪ **Tabela e përmbajtjes së testit (tabela e specifikimeve – Blueprint)**

Për të hartuar një test, mësuesi duhet të ketë kujdes që së pari të përgatisë tabelën e përmbajtjes së testit. Kjo tabelë përmban njohuritë, rezultatet e të nxënit sipas nëntematikave, peshat (në %) si dhe pikët për pyetjet sipas niveleve të arritjeve.

Tabela është themelore për ndërtimin e një testi të mirë. Ajo, jo vetëm siguron që testi do të provojë (testojë) të gjithë përmbajtjen e rëndësishme dhe proceset, por gjithashtu është e rëndësishme në planifikimin dhe organizimin e mësimit.

Tabela e specifikimeve të testit nuk duhet të bëhet kufizuese që mësuesi të drejtojë vëmendjen kryesisht drejt përlllogaritjeve. Për hartimin e saj është i rëndësishëm përcaktimi i njohurive dhe rezultateve të të nxënit që do të vlerësohen me test, si dhe përcaktimi i pyetjeve sipas niveleve të vështirësisë.

Që të ndërtohet tabela e përmbajtjes së testit për periudhën, fillimisht duhet të nxjerrim përqindjet (peshat) që zë çdo tematikë/nëntematikë, njohuritë dhe rezultatet e të nxënit që zhvillohen përgjatë asaj periudhe.

Për shembull,

Në rast se testi i periudhës do të përmbajë 30 pikë dhe gjatë kësaj periudhe zhvillohet nëntematika A me 19 orë, nëntematika B me 7 orë, atëherë për secilën prej tyre llogaritet pesha në përqindje dhe pikët që do të kenë në test. Totali i orëve të periudhës është 26 orë.

Nëntematika A ka 19 orë: $26 \text{ (orët e periudhës)} = 74\% = (74\% \times 30 \text{ pikë totali}) = 22 \text{ pikë}$

Nëntematika B ka 7 orë: $26 \text{ (orët e periudhës)} = 26\% = (26\% \times 30 \text{ pikë totali}) = 8 \text{ pikë}$

Kjo do të thotë që nëntematika A do të ketë numrin më të madh të pikëve në test. Me të njëjtën logjikë veprohet për peshat e njohurive dhe rezultateve të të nxënit.

Për ndarjen në nivele të pikëve, veprohet si më poshtë:

Nëse peshat për secilin nivel do të jenë 40% - Niveli 1; 40% - Niveli 2; dhe 20% - Niveli 3, atëherë pikët sipas niveleve do të jenë:

Nëntematika	% & nr. i pikëve	Pikët e ndara në nivele		
		Niveli 2	Niveli3	Niveli 4
Nëntematika A	74% - 22 pikë	22 x 40% = 9 pikë	22 x 40% = 9 pikë	22 x 20% = 4 pikë
Nëntematika B	26% - 8 pikë	8 x 40% = 3 pikë	8 x 40% = 3 pikë	8 x 20% = 2 pikë
Totali	30	12	12	6

Shënim: Përlllogaritja e peshave dhe pikëve orienton mësuesin dhe mbështet hartimin e një testi të mirë; por duhet bërë kujdes të mos shndërrohet në një proces kufizues për mësuesin gjatë hartimit të testit.

Konvertimi i pikëve në notë

Pasi përcaktohet totali i pikëve të një testi, atëherë bëjmë konvertimin e tyre në notë, duke përcaktuar përqindjet mbi bazën e të cilave llogariten pikët që do të shërbejnë si kufiri i poshtëm dhe intervalet e tyre për notat nga 4 në 10.

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Përqindja	0-24%	25-38%	39-51%	52-64%	65-77%	78-90%	91-100%

Në rastin tonë totali i pikëve është 30. Llogarisim $30 \text{ pikë} \times 24\% = 7 \text{ pikë}$. Pra 7 pikë është kufiri maksimal i pikëve për të cilën nxënësi nuk merr notë kaluese. Pikët e mbetura ndahen në 6 intervale për notat nga 5 në 10.

$30-7=23$, $23 / 6 = 4$ pikë secili interval. Për intervalin e fundit (nota 10) do të ketë 3 pikë.

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-11	12-15	16-19	20-23	24-27	28-30

Llojet e pyetjeve në test dhe kriteret e hartimit të tyre

Rregulla bazë për të gjitha formatet e pyetjeve

Në hartimin e pyetjeve, duhet të respektohen disa rregulla bazë si më poshtë:

- sigurohuni të matni njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të periudhës;
- formuloni pyetje të qarta dhe koncize;
- sigurohuni që pyetja i përgjigjet qëllimit të caktuar;
- shmangni pyetjet e papërshtatshme në formë e përmbajtje;
- shmangni pyetjet e vështira të pajustificuara;
- shmangni pyetjet me kuptime të tjera logjike veç kuptimit që synojmë;
- vendosni të parat pyetjet më të lehta.

Pyetjet në teste klasifikohen në dy grupe të mëdha:

A. Objektive

B. Subjektive

A. Pyetjet objektive mund të jenë të disa llojeve. P.sh.

- me zgjedhje të shumëfishtë (alternativa)
- me kombinime
- e vërtetë - e gabuar
- me zëvendësim të fjalëve
- etj.


Pyetjet objektive janë të vështira për t'u hartuar, por të lehta për t'u vlerësuar. Ato përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe shumë të prerë kufirin midis përgjigjes së saktë dhe të gabuar.

Shembuj pyetjesh objektive

☒ Pyetje me zgjedhje të shumëfishtë (alternativa)

Figura tregon përplasjen e dy pllakave tektonike në Azi.

Cili është rezultati i kësaj përplasjeje?



1 pikë

- A) Vullkanet shpërthejnë vazhdimisht
- B) Pllaja e Tibetit ka pësuar ulje të vazhdueshme
- C) Formimi i maleve të Himalajeve
- D) Shkrirja e akujve në pllajën e Tibetit

☒ **Pyetje “E vërtetë - e gabuar”**

Qarko e vërtetë (V) apo e gabuar (G) për pohimet e mëposhtme

4 pikë

- A) Rrotullimi i Tokës rreth boshtit të saj bëhet nga lindja në drejtim të perëndimit.
V G
- B) Më 22 dhjetor rrezet e Diellit bien pingul mbi Tropikun e veriut.
V G
- C) Sasia e nxehtësisë diellore që merr Toka, zvogëlohet nga ekuatori në drejtim të poleve.
V G
- D) Toka rrotullohet rreth Diellit për 24 orë.
V G

☒ **Pyetje me zëvendësim të fjalëve**

P.sh., Nënrajonet e Rajonit Verior-Verilindor të Shqipërisë janë _____ dhe _____.

☒ **Pyetje me kombinime**

Kolona e parë përmban shtresat e atmosferës, ndërsa kolona e dytë karakteristikat e tyre. Bashkoni duke vendosur përbri numrit të shtresës atmosferike shkronjën e karakteristikës përkatëse.

- 1. _____
- 2. _____
- 3. _____
- 4. _____
- 5. _____

Shtresat e atmosferës	Karakteristikat
1. Troposfera	A. Gjendet shtresa e ozonit (O ³)
2. Stratosfera	B. Është elektrikisht e ngarkuar me jone
3. Mezosfera	C. Ndodhin proceset meteorologjike
4. Termosfera	D. Nuk ka kufij të qartë
5. Ekzosfera	E. Shtrihet në kufijtë 50 – 85 km lartësi

B. Në pyetjet subjektive bëjnë pjesë:

- pyetjet e strukturuar
- pyetjet ese

Pyetjet subjektive janë pyetje të hapura ku nxënësve u kërkohet të japin gjykimet e tyre në bazë të disa kritereve.

Shembull pyetje e strukturuar


Vëzhgoni me kujdes hartën e mëposhtme dhe përcaktoni:

A) Llojin e hartës

1 pikë

B) Në cilën pikë lumi rrjedh më shpejt. Jepni një argument për të mbështetur përgjigjen tuaj.

2 pikë



▪ Koha që i duhet nxënësit për çdo tip pyetje

Koha që i duhet nxënësit për t'iu përgjigjur pyetjeve të ndryshme në një test është tepër e rëndësishme. Shpeshherë mësuesit hartojnë teste me shumë pyetje, pa u lënë nxënësve kohën e duhur për t'iu përgjigjur. Në të tilla raste nxënësit janë nën trysinë jo vetëm të testimit, por edhe të kohës së shkurtër që ata kanë në dispozicion. Kjo situatë rrjedhimisht sjell rezultate jo të mira për nxënësit.

Si rregull për pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë (1 pikë) koha llogaritet 60 sekonda; për pyetjet e tjera për çdo pikë të dhënë koha llogaritet 90 sekonda.

Gjithashtu, është e rëndësishme dhe hapësira që i lëmë nxënësve për të shkruar çdo përgjigje në test. Duhet bërë kujdes pasi nëse i lëmë më shumë hapësirë seç duhet, atëherë i krijojmë nxënësit përshtypjen e gabuar që duhet të shkruajë shumë. Kështu që, duhet të lëmë aq hapësirë sa është e mjaftueshme për të shkruar përgjigjen e parashikuar të secilës pyetje.

▪ **Pikëzimi për çdo pyetje dhe skema e vlerësimit**

Pikëzimi është një tjetër hap i rëndësishëm gjatë hartimit të testit. Një test që nuk është pikëzuar siç duhet krijon probleme të mëdha jo vetëm gjatë vlerësimit të përgjigjeve të nxënësve, por edhe gjatë ballafaqimit të nxënësit me mësuesin.

Pyetjet objektive janë më të thjeshta për t'u pikëzuar. Kështu, pyetjet me alternativa, pavarësisht vështirësisë së tyre (nëse i përkasin nivelit bazë, mesatar ose të lartë), pikëzohen me 1 pikë.

Pyetjet me kombinime, pikëzohen me 1 pikë për secilin kombinim të mundshëm. Pra, nëse janë katër kombinime, pyetjet do të pikëzohen me 4 pikë.

Pyetjet e strukturuar pikëzohen në varësi të asaj se çfarë dhe sa kërkojmë në një pyetje. Duhet të mbajmë në konsideratë se, për përgjigje të caktuara, mirë është që të lëmë mundësi pikëzimi edhe për përgjigjet e pjesshme, nëse ka tilla.

Për shembull, në pyetjen më poshtë lidhur me tjetërsimin fizik, pyetja është e strukturuar në dy kërkesa: a) dhe b).

Tjetërsimi fizik ndodh për disa arsye.

- a) Shpjegoni si ndodh tjetërsimi fizik për shkak të luhatjeve të temperaturave gjatë 24 orëve.

2 pikë

- b) Në cilat zona mbizotëron më tepër ky lloj tjetërsimi?

1 pikë

Tjetërsimi fizik mund të ndodhë për disa arsye, por në kërkesën e parë testohet për tjetërsimin fizik që ndodh për shkak të luhatjeve të temperaturave gjatë 24 orëve. Në këtë rast pyetja është pikëzuar 2 pikë. Në këtë mënyrë i japim mundësi nxënësit, që edhe nëse jep një përgjigje të pjesshme, ai të vlerësohet me të paktën 1 pikë. Në skemën e vlerësimit, jepet përgjigja e mundshme për përgjigjen e plotë, që vlerësohet me 2 pikë, dhe përgjigja e pjesshme që vlerësohet me 1 pikë.

Pasi hartohet testi, çfarëdo lloj formati qoftë ai, hartojmë skemën e vlerësimit. Skema e vlerësimit reflekton përgjigjet e sakta të çdo pyetjeje në test.

Skema e vlerësimit:

Përgjigje e plotë për kërkesën a):

2 pikë

Gjatë ditës, shkëmbinjte ngrohen dhe bymehen, kurse natën, duke u ulur temperaturat, tkurren. Përsëritja e vazhdueshme e këtyre proceseve (bymim, tkurrje) prish kompaktësinë e shkëmbinjve duke i copëtuar ata.

Përgjigje e pjesshme për kërkesën a):

1 pikë

Tjetërsimi fizik për shkak të temperaturave, ndodh si pasojë e ndryshimeve të mëdha të temperaturave gjatë 24 orëve.

Ndërsa në kërkesën e dytë (b), jepen tre variante të ndryshme përgjigjesh, që do të thotë se cilëndo nga ato përgjigje të japë nxënësi, do të vlerësohet me 1 pikë.

a) Mbizotëron më tepër në zonat e thata e të nxehta;

OSE

Në shkretëtira;

OSE

Në gjysmëshkretëtira.

Nxënësi fiton:

3 pikë	Nëse bën shpjegimin e plotë për kërkesën a dhe përcakton saktë kërkesën b.
2 pikë	Nëse bën shpjegim të pjesshëm për kërkesën a dhe përcakton saktë kërkesën b.
1 pikë	Nëse bën shpjegim të pjesshëm për kërkesën a.
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetjet e strukturuar mund të hartohen në mënyrë të tillë, që përgjigja e kërkesës së dytë të varet nga kërkesa e parë. Në këtë rast nxënësi nuk mund t'i përgjigjet kërkesës së dytë, pa bërë të parën. *Sugjerohet që mos të ketë shumë pyetje të tilla në test, pasi penalizon nxënësit.*

Shembull

- **TEST: Periudha I (shtator – dhjetor), Klasa 10**
- **Koha: 45 minuta**
- **Tematika: Proceset natyrore dhe shoqërore**
- **Tabela e specifikimeve të testit – Blueprinti**

Testi ka 30 pikë gjithsej

Njohuritë		Rezultatet e të nxënit	Peshat në %	Pikët	N ₂	N ₃	N ₄
I	Sistemi diellor		37%	11	3	5	3
1.	Rrotullimi i Tokës rreth boshtit: Provat dhe pasojat.	Analizon pasojat e rrotullimit të Tokës rreth vetes.	6%	2	1	1	0
2.	Rrotullimi i Tokës rreth Diellit, pasojat.	Analizon pasojat e qarkullimit të Tokës rreth Diellit.	25%	7	1	3	3
3.	Eklipsi i Hënës dhe i Diellit	Krahason eklipsin e Diellit dhe të Hënës.	3%	1	0	1	0
4.	Planetët, asteroidet, meteorët, kometat	Dallon planetët e brendshëm, të jashtëm, e satelitët e tyre, duke përshkruar disa ndër karakteristikat kryesore të tyre.	3%	1	1	0	0
II.	Hartografia		25%	7	1	4	2

1.	Projeksionet hartografike	Diferencon llojet e ndryshme të projeksioneve hartografikë.	12%	3	0	2	1
2.	Hartat, elementet matematikorë dhe gjeografikë Klasifikimi i hartave sipas: - Përmbajtjes - Shkallës - Përdorimit mbi bazën e veçorive dalluese	Ndërton dhe interpreton profilin topografik të një sipërfaqeje të paraqitur në hartë.	13%	4	1	2	1
III.	Atmosfera		38%	12	4	6	2
1.	Përbërja e atmosferës dhe karakteristikat kryesore të secilës shtresë	Përshkruan ndërtimin shtresor të atmosferës dhe përbërjen e saj.	6%	2	2	0	0
2.	Rrezatimi diellor dhe llojet e tij	Interpreton ndikimin e rrezatimeve (i drejtpërdrejtë, i shpërndarë, i përgjithshëm dhe i Tokës) në sistemet gjeofizike të Tokës;	10%	3	0	2	1

		<p>Evidenton faktorët që ndikojnë në sasinë e rrezatimit që mbërrin në sipërfaqen e Tokës;</p> <p>Analizon llojet e rrezatimeve përmes dukurisë së përcjellshmërisë dhe konveksionit;</p>					
3.	<p>Temperatura e ajrit dhe ndryshimet e saj në kohë dhe në hapësirë</p>	<p>Analizon ndryshimin në kohë të temperaturës (temperaturën mesatare ditore, mujore, vjetore, amplitudat) përmes llogaritjes dhe përpunimit të treguesve të temperaturës;</p> <p>Analizon ndryshimin e temperaturës në hapësirë (horizontal dhe vertikal) dhe faktorët që ndikojnë në të.</p> <p>Nxjerr përfundime mbi shpërndarjen e temperaturave duke analizuar hartën e izotermave.</p>	12%	4	1	2	1

4.	Reshjet dhe kushtet e formimit të tyre Shpërndarja gjeografike e reshjeve dhe rëndësia e tyre	Shpjegon formimin e vesës, mjegullës, brymës dhe reve, përmes procesit të kondensimit; Shpjegon kushtet e formimit të llojeve të ndryshme të reshjeve.	10%	3	1	2	0
	TOTALI		100%	30	8	15	7

▪ **Grupimi i rezultateve të të nxënës sipas niveleve të arritjes**

Niveli 2

- Dallon planetët e brendshëm, të jashtëm e satelitët e tyre, duke përshkruar disa ndër karakteristikat kryesore të tyre.
- Përshkruan ndërtimin shtresor të atmosferës dhe përbërjen e saj.

Niveli 3

- Diferencon llojet e ndryshme të projeksioneve hartografikë.
- Krahason eklipsin e Diellit dhe të Hënës.
- Analizon ndryshimin në kohë të temperaturës (temperaturën mesatare ditore, mujore, vjetore, amplitudat) përmes llogaritjes dhe përpunimit të treguesve të temperaturës;
- Nxjerr përfundime mbi shpërndarjen e temperaturave duke analizuar hartën e izotermave.
- Shpjegon kushtet e formimit të llojeve të ndryshme të reshjeve.

Niveli 4

- Analizon pasojat e rrotullimit të Tokës rreth vetes.
- Analizon pasojat e rrotullimit të Tokës rreth Diellit.
- Ndërton dhe interpreton profilin topografik të një sipërfaqeje të paraqitur në hartë.
- Analizon ndryshimin e temperaturës në hapësirë (horizontal dhe vertikal) dhe faktorët që ndikojnë në të.
- Evidenton faktorët që ndikojnë në sasinë e rrezatimit që mbërrin në sipërfaqen e Tokës;
- Shpjegon formimin e vesës, mjegullës, brymës dhe reve, përmes procesit të kondensimit;

MODEL TESTI

Model Test Gjeografi, klasa 10 - Periudha I

1. Kryen një rrotullim të plotë për rreth 24 h me drejtim nga perëndimi në lindje:

1 pikë

- A) Toka rreth boshtit
- B) Toka rreth Diellit
- C) Hëna rreth boshtit
- D) Hëna rreth Diellit

2. Lëvizja rrotulluese e Tokës rreth boshtit të vet imagjinar shkakton:

1 pikë

- A) Ndryshimin e kohëzgjatjes së ditës dhe natës.
- B) Formimin e fushës magnetike të Tokës.
- C) Ndryshimin e kohëzgjatjes së stinëve.
- D) Formimin e shtypjes tokësore.

3. Një nga pasojat e rrotullimit të Tokës rreth Diellit është:

1 pikë

- A) Shmangia e trupave që lëvizin horizontalisht.
- B) Forma vezake e orbitës së tokës.
- C) Formimi i stinëve.
- D) Llogaritja e kohës lokale.

4. Është pasojë gjeografike e rrotullimit të Tokës rreth Diellit:


1 pikë

- A) Llogaritja e kohës lokale.
- B) Formimi i ditës dhe natës.
- C) Zhvendosja e trupave që lëvizin horizontalisht.
- D) Ndryshimi i vendit të lindjes dhe perëndimit të Diellit.

5. Cila figurë tregon vendosjen e Diellit, Tokës dhe Hënës gjatë një eklipsi Hënor?

1 pikë

- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4



6. Trupi qiellor më i afërt me Tokën është:


1 pikë

- A) Dielli
- B) Afërdita
- C) Marsi
- D) Hëna

7. Në cilën nga hartat e mëposhtme zonat e hijezuara në kontinente kanë temperaturë vjetore më të madhe se 18°C?

1 pikë

- A) A
- B) B
- C) C
- D) D



8. Gazi që luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e tokës nga rrezet ultravjollcë është:

1 pikë

- A) Dioksidi i karbonit
- B) Oksigjeni
- C) Azoti
- D) Ozoni

9. Cila është shtresa e atmosferës ku bëhet i mundur transmetimi i valëve të radios?

1 pikë

- A) Troposfera
- B) Stratosfera
- C) Termosfera
- D) Ekzosfera

10. Supozojmë se temperatura maksimale gjatë ditës është 27°C , ndërsa ajo minimale është 10°C . Sa është amplituda ditore e temperaturës?

1 pikë

- A) 17°C
- B) 10°C
- C) 7°C
- D) 1°C


11. Inversioni termik ndodh kur:

1 pikë


- A) Temperaturat e ajrit janë më të larta pranë sipërfaqes së tokës.
- B) Temperaturat e ajrit janë më të ulëta pranë sipërfaqes së tokës.
- C) Temperatura e ajrit ndryshon nga përplasja e dy masave ajrore.
- D) Në ajrin pranë Tokës përqindja e ndotjes është shumë e lartë.

12. Në figurën e dhënë paraqitet pozicioni i Tokës përkundrejt Diellit në një datë të caktuar të vitit. Ju do të gjeni:

- A) Ku bien pingul rrezet diellore?
- B) Në cilën hemisferë dita është më e gjatë se nata?
- C) Në cilën pjesë të rruzullit dita zgjat 24 h?
- D) Në cilin paralel dita është e barabartë me natën?
- E) Për cilën datë bëhet fjalë?




5 pikë




13. Në figurën më poshtë jepen tre lloje të ndryshme projeksionesh hartografikë.


3 pikë



A



B



C


a) Emërtoni të paktën një nga projeksionet e paraqitura.

b) Cili nga projeksionet përdoret për më shumë për zonat polare?

c) Cili nga projeksionet shformon më shumë sipërfaqet në gjerësitë e mëdha gjeografike?

14. Ndërtoni profilin topografik të vijës së hequr AB në hartën topografike të dhënë.

3 pikë





15. Vëzhgoni me kujdes dy figurat.

- a) Përcaktoni në cilën nga figurat kemi të bëjmë me stinën e verës dhe në cilën me stinën e dimrit. Jepni një argument për secilin rast. **1 pikë**

Në figurën 1: _____

Në figurën 2: _____



- b) Supozoni se prindërit tuaj do të blejnë një apartament. Apartamenti që ata kanë zgjedhur është me drejtim nga veriu. A kanë bërë ata zgjedhjen e duhur? Jepni të paktën një argument për të mbështetur përgjigjen tuaj duke u bazuar në figurat e dhëna.

2 pikë

16. Renditni dy nga faktorët që ndikojnë në ndryshimin e temperaturës së ajrit.

2 pikë

17. Shpjegoni dallimin midis vesës dhe brymës lidhur me mënyrën e formimit të tyre.

1 pikë

18. Shpjegoni dy nga faktorët që ndikojnë në përhapjen dhe sasinë e reshjeve në planetin tonë.

2 pikë

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-11	12-15	16-19	20-23	24-27	28-30

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Udhëzime të përgjithshme

- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim, përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundshme të përgjigjeve të nxënësve.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që mësuesi e gjykon të saktë.

- *Pyetjet me zgjedhje*

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
Përgjigja e saktë	A	D	C	D	B	D	A	D	C	A	B

• *Pyetjet me zhvillim*

Pyetja 12

5 pikë

- A) Në tropikun e veriut
- B) Në hemisferën veriore
- C) Në ekuator
- D) Në polin e veriut
- E) Bëhet fjalë për datën 22 Qershor

Nxënësi fiton:

5 pikë Nëse rendit pesë përgjigjet.

OSE

4pikë Nëse rendit 4 nga përgjigjet.

3 pikë Nëse rendit 3 nga përgjigjet.

2 pikë Nëse rendit 2 nga përgjigjet.

1 pikë Nëse rendit 1 nga përgjigjet.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13

3 pikë

- a)
 - ✓ Projeksioni ndërprerës
 - ✓ Projeksioni merkator (cilindrik)
 - ✓ Projeksioni azimutal polar
- b)
 - ✓ Përdoret projeksioni azimutal - C
 - ✓ Projeksioni cilindrik – B

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse emërton saktë një nga projeksionet hartografike që jepen në figurë, gjen se cili nga projeksionet përdoret për zonat polare dhe gjen saktë se cili nga projeksionet shformon sipërfaqe në gjerësitë e mëdha gjeografike.

OSE

2 pikë Nëse emërton saktë një nga projeksionet hartografikë që jepen në figurë dhe gjen se cili nga projeksionet përdoret për zonat polare **OSE** saktë një nga projeksionet hartografikë që jepen në figurë dhe gjen saktë se cili nga projeksionet shformon sipërfaqe në gjerësitë e mëdha gjeografike **OSE** gjen se cili nga projeksionet përdoret për zonat polare dhe gjen saktë se cili nga projeksionet shformon sipërfaqe në gjerësitë e mëdha gjeografike.

1 pikë Nëse emërton saktë një nga projeksionet hartografikë që jepen në figurë **OSE** gjen se cili nga projeksionet përdoret për zonat polare **OSE** gjen saktë se cili nga projeksionet shformon sipërfaqe në gjerësitë e mëdha gjeografike.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 14


3 pikë

3 pikë nëse ndërton profilin e saktë

2 pikë nëse ndërton pingulet dhe njërën nga pjesët e profilit

1 pikë nëse ndërton një nga pjesët e profilit **OSE** ndërton vetëm pingulet (projeksionet)

0 pikë Nëse e ndërton profilin gabim ose nuk e ndërton fare



3 pikë

Pyetja 15

- a) Në figurën 1- stina e verës, sepse këndi i rënies së rrezeve të diellit është më i madh. Në figurën 2 - stina e dimrit, sepse këndi i rënies së Diellit është më i vogël.
- b) Nuk kanë bërë zgjedhjen e duhur, pasi 1: figura tregon se gjatë verës shtëpinë e zë dielli vetëm pak pasdite, ndërsa gjatë dimrit nuk e zë fare dielli. 2: Gjatë dimrit ajo shtëpi do të ketë më shumë nevojë për ngrohje, e për rrjedhojë më shumë shpenzime.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse përcakton saktë stinët në të dyja figurat duke dhënë argumentet përkatëse si edhe shkruan dy argumente të vlefshëm për kërkesën b.

OSE

- 2 pikë** Nëse përcakton saktë stinët në të dyja figurat duke dhënë argumentet përkatëse dhe shkruan një nga argumentet për kërkesën b **OSE** shkruan dy argumente të vlefshëm për kërkesën b.
- 1 pikë** Nëse përcakton saktë stinët në të dyja figurat duke dhënë argumentet përkatëse **OSE** shkruan një argument të vlefshëm për kërkesën b.
- 0 pikë** Nëse përcakton saktë stinët në figurë **pa** dhënë argumentet përkatëse **OSE** përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16

2 pikë

- Rrezatimi diellor
- Shpërndarja e kontinenteve
- Relievi
- Masat ajrore dhe rrymat oqeanike
- Karakteri i truallit

Nxënësi fiton:

- 2 pikë** Nëse rendit dy nga faktorët që ndikojnë në ndryshimin e temperaturës së ajrit.
- OSE**
- 1 pikë** Nëse rendit një nga faktorët që ndikojnë në ndryshimin e temperaturës së ajrit.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 17

1 pikë

Vesa formohet kur ajri bie në kontakt me objekte të ftohta në sipërfaqen e tokës, temperatura e të cilave është më e ulët se ajo e ajrit, ndërsa kur temperatura e këtyre objekteve është më e vogël se 0°C, formohet bryma.

Nxënësi fiton:

- 1 pikë** Nëse bën saktë dallimin midis vesës dhe brymës.
- OSE**
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 18

2 pikë

- Masat ajrore. Reshjet më të shumta bien atje ku masat ajrore kanë karakter ngjitës. Kjo ndodh në zonën ekuatoriale dhe mesatare.
- Lartësia mbi nivelin e detit dhe relievi i terrenit. Zonat malore dhe shpatet e ekspozuara ndaj masave ajrore të pasura me lagështirë, marrin më shumë reshje.
- Largësia nga detet dhe oqeanet. Sa më në brendësi të kontinenteve të futen masat ajrore e humbasin lagështirën dhe reshjet pakësohen.
- Rrymat oqeanike. Kur ajri kalon mbi rrymat e ngrohta oqeanike pasurohet me lagështirë e ngrohet. Duke u ngjitur lart, ftohet dhe kondenson avujt e ujit duke formuar retë dhe reshjet.

Nxënësi fiton:

2 pikë Nëse shpjegon dy nga faktorët që ndikojnë në përhapjen e reshjeve në planetin tonë.

OSE

1 pikë Nëse shpjegon një nga faktorët që ndikojnë në përhapjen e reshjeve në planetin tonë OSE vetëm i rendit dy faktorët pa i shpjeguar se si ndikojnë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

C. Projekti kurrikular

Projekti kurrikular është pjesë e vlerësimit të nxënësit.

Në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e projektit kurrikular:

- Mësuesi planifikon dhe organizon një projekt të shtrirë gjatë gjithë vitit shkollor.
- Projekti kurrikular mund të jetë lëndor ose ndërlëndor, mund t'i përkasë një fushe të nxëni ose të shtrihet në më shumë se një fushë të nxëni.
- Drejtoria e shkollës menaxhon kohën e prezantimit dhe të vlerësimit të projektit kurrikular që të shmanget mbingarkesa e nxënësve në fund të vitit shkollor.
- Nota e projektit kurrikular shënohet në regjistër në kolonën përkatëse.
- Projektet e nxënësve ruhen deri në fund të vitit shkollor.

- Projekti si veprimtari integruese me karakter kërkimor e krijues, nxit zhvillimin e aftësive të larta të menduarit, aftësive komunikuese, të bashkëpunimit, të përdorimit të TIK, të sipërmarrjes etj. Projekti nxit të nxënit dhe mësimdhënies me në qendër nxënësin përmes së cilës nxënësit në mënyrë të pavarur ose/dhe si një anëtar i një grupi hulumtojnë mbi një çështje të caktuar ose një problem të lidhur me jetën reale.
- Projekti kurrikular duhet të jetë i shtrirë përgjatë gjithë vitit shkollor, pra në të tri periudhat. Mësuesi që kur planifikon projektin duhet të ketë në mendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënësit dhe përgjatë zhvillimit të tij.
- Planifikimi dhe zbatimi në mënyrë efikase i një projekti kërkon që mësuesi të përcaktojë qartë detyrën mësimore në detaje për çdo grup dhe nxënës (është mjaft e rëndësishme që secili nxënës të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyra të përcaktuara); të paraqesë rezultatet e të nxënit që do të arrihen nëpërmjet projektit; të paraqesë hollësisht çdo fazë të realizimit të projektit; të qartësojë nxënësit për arritjen përfundimtare të projektit; të qartësojë nxënësit për kriteret e vlerësimit të projektit; të vëzhgojë dhe të japë gjykimin e tij në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të projektit.
- Për realizimin e projektit shfrytëzohen përvojat vetjake të nxënësve dhe njohuritë e marra nga burime të ndryshme. Realizimi i një projekti kërkon përdorimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: vrojtimi, studimi i rastit, intervista, puna në grup, puna individuale, përpunim informacioni statistikor etj.
- Stadet kryesore që ndiqen për realizimin e një projekti janë:
 - ✎ Përcaktohet çështja ose problemi për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i menaxhueshëm në kohë.
 - ✎ Përcaktohen detyrat që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme nga puna e secilit nxënës.
 - ✎ Grumbullohet materiali dhe/ose mjetet e nevojshme.
 - ✎ Përpunohen dhe analizohen të dhënat e grumbulluara.
 - ✎ Nxirren përfundime dhe përgjithësime nga të dhënat e grumbulluara dhe përgatitet produkti përfundimtar.
 - ✎ Prezantohen gjetjet dhe përfundimet e projektit ose prezantohet produkti i krijuar.
- Për planifikimin e një projekti mësuesi ndërton planin e projektit, rubrikat kryesore të të cilit paraqiten më poshtë. Në varësi të tematikës së projektit dhe specifikave të tij, mësuesi mund

të pasurojë planin me rubrika të tjera. Mësuesi planifikon në planin e tij ditor çdo orë të planifikuar të projektit sikurse vepron me orët e tjera mësimore.

Rubrikat kryesore të planit të një projekti kurrikular përfshijnë:

- *Tema e projektit* (Përcaktohet nga mësuesi në bashkëpunim me nxënësit)
- *Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore* (Nëse projekti është ndërlëndor, përcaktohet kontributi i çdo mësuesi dhe orët mësimore për secilën lëndë).
- *Klasa/t pjesëmarrëse:* (përcaktohet klasa ose në rast se ka disa klasa).
 - *Rezultatet e të nxënit* – (Përfshijnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që do të zhvillohen përmes veprimtarive të projektit.)
- *Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:* (përcaktohen konceptet që duhet të zotërojë nxënësi për realizimin e këtij projekti).
- *Partnerët* (Nëse ka, p.sh., nëse projekti në lëndën e gjeografisë ka si qëllim që nxënësit të hulumtojnë për ndotjen mjedisore në zonën ku banojnë, një specialist i mjedisit mund të jetë një partner pjesëmarrës në projekt).
- *Veprimtaritë kryesore:* (përcaktohen veprimtaritë që do të realizohen gjatë projektit).
- *Burimet kryesore të informacionit* (Mësuesi duhet të orientojë nxënësit drejt përdorimit të burimeve të larmishme dhe të duhura të informacionit. Në lëndën e gjeografisë një burim i çmuar informacioni, përveç internetit, hartave dhe teksteve të ndryshme si enciklopeditë, revistat, etj., janë vëzhgimet në natyrë).
- *Tematika e orëve të planifikuara të planit mësimor:* (këtu vendoset tematika për çdo orë mësimore të projektit. Psh nëse projekti planifikohet në 6 orë atëherë duhet vendosur tematika për të gjashta orët).
- *Përshkrimi i produktit të projektit* (duhet të përfshijë shkurtimisht llojin e produktit që pritet të realizohet dhe mënyrën e prezantimit të tij).
- *Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi* (Mësuesi përcakton kritere për vlerësimin e projektit të cilat ia komunikon nxënësit që në fillim të projektit. P.sh., kriteret mund të përcaktohen në lidhje me trajtimin e përmbajtjes në përmbushje të tematikës, përdorimin e burimeve të informacionit, përgatitjen e produktit, prezantimin e tij etj., në varësi të rezultateve të të nxënit).
- *Sigurimi i të dhënave nga burime të ndryshme vlerësimi është thelbësore për të nxënin bazuar në projekte. Përfshirja e nxënësve në vlerësimin e projektit nxit motivimin dhe përmirëson të nxënit e drejtuar prej tyre. Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësve nga njëri-tjetri nxit nxënësit*

të reflektojnë mbi pikat e tyre të dobta dhe të forta, në mënyrë që të fokusojnë përpjekjet e tyre të mëtejshme).

Shembuj kriteresh për vlerësimin e projektit:

A është fokusuar përmbajtja e projektit te çështja/problemi i identifikuar për shqyrtim?
A është lidhur tema e projektit me situata nga jeta reale?
A i kanë zbatuar nxënësit konceptet e marra në lëndën përkatëse?
A kanë mbledhur të dhëna bazuar në burime të mjaftueshme informacioni?
A kanë bashkëpunuar nxënësit për të zhvilluar aftësitë komunikuese, vetëmenaxhuese dhe organizuese?
.....

Sigurimi i të dhënave nga burime të ndryshme vlerësimi është thelbësore për të nxënësin bazuar në projekte. Përfshirja e nxënësve në vlerësimin e projektit nxit motivimin dhe përmirëson të nxënësit e drejtuar prej tyre.

Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësve nga njëri-tjetri

Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësve nga njëri-tjetri nxit nxënësit të reflektojnë mbi pikat e tyre të dobta dhe të forta, në mënyrë që të fokusojnë përpjekjet e tyre të mëtejshme.

Nxitja e nxënësit për t'u përfshirë në vendosjen e kriterëve për vlerësimin e punës së tij e kalon një pjesë të përgjegjësisë tek nxënësi. Kjo ndjeshmëri e përdorur me më shumë theks tek zhvillimi i nxënësit dhe vetëkuptimi, krahasuar thjesht me qëllimin për të arritur tek një notë, bën që vetëvlerësimi të kontribuojë në mundësitë e nxënësit për të strukturuar procesin e tij të të nxënësit. Kjo rrit më tej zotërimin e nxënësit mbi procesin e nxënies.

Vlerësimi i shokut mund të shtojë edhe një dimension tjetër në zhvillimin e nxënësit nga pikëpamja e njohjes mbi veten. Nxënësit gjatë konsultimeve me shokët e tyre për marrjen dhe dhënien e sugjerimeve për përmirësim, marrin më shumë përgjegjësi për atë që bëjnë dhe mënyrën si e realizojnë. Në këtë mënyrë ata mendojnë në mënyrë analitike mbi natyrën e performancës së shokut të tyre. Projektet si detyra që përfshijnë një kombinim të aftësive të nxënies të tilla, si kërkimi, planifikimi, projektimi dhe përfundimi janë shembuj të mirë. Kjo gjithashtu praktikohet në ato situata ku nxitet një shkallë e lartë e ndërveprimit të nxënësit.

Shembull

Projekt kurrikular

Tema e projektit: Turizmi në Shqipëri dhe potencialet për zhvillimin e tij

Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore: 6 orë. Projekti do të zhvillohet përgjatë gjithë vitit, me nga 2 orë në secilën periudhë.

Klasat pjesëmarrëse: Klasat e 11-ta

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi:

- vlerëson rolin dhe rëndësinë e pozitës gjeografike të Shqipërisë për zhvillimin e turizmit;
- analizon potencialet natyrorë dhe humanë që mundësojnë zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit në Shqipëri;
- evidenton disa ndër problematikat që ndikojnë në zhvillimin e turizmit në Shqipëri;
- parashikon rrugë dhe strategji të zhvillimit të llojeve të ndryshme të turizmit dhe promovimit të zonave turistike në vendin tonë;
- krahason të paktën tre burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë;
- prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse (me shkrim dhe me gojë), duke përdorur teknologjinë e informacionit;
- demonstroi bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup.

Njohuritë kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:

Mjedisi natyror, mjedisi human, rajoni, veçoritë e rajonit, marrëdhënia njeri-mjedisi, trashëgimia natyrore, trashëgimia kulturore, ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, turizmi, llojet e turizmit, zonat turistike.

Partnerët: Specialistë të turizmit, gjeografë dhe përfaqësues të tjerë të komunitetit.

Veprimtaritë kryesore

Për realizimin e projektit, klasa ndahet në katër grupe të cilat përcaktojnë nga një tematikë specifike për hulumtim. Grupet, në bashkëpunim me mësuesin, vendosin në lidhje me tematikën për të cilën do të zhvillojnë projektin. Për shembull:

Grupi i parë: Turizmi malor (Potencialet natyrore dhe humane, problematikat, zonat turistike, rrugë dhe mundësi të zhvillimit)

Grupi i dytë: Turizmi bregdetar (Potencialet natyrore dhe humane, problematikat, zonat turistike, rrugë dhe mundësi të zhvillimit)

Grupi i tretë: Turizmi kulturor (Potencialet natyrore dhe humane, problematikat, zonat turistike, rrugë dhe mundësi të zhvillimit)

Grupi i katërt: Agroturizmi (Potencialet natyrore dhe humane, problematikat, zonat turistike, rrugë dhe mundësi të zhvillimit).

Nr	Veprimtaria	Afati	Produkti i punës
1	<ul style="list-style-type: none"> - Përcaktimi i temës dhe nëntemave të projektit në bashkëpunim me nxënësit. - Përcaktimi i detyrave për secilin grup dhe nxënësi. - Përcaktimi i afateve për secilën fazë të projektit. - Hartimi i një liste paraprake të burimeve të informacionit të cilët do të mbështesin studimin. - Përgatitja e pyetësorëve/intervistave të strukturuar. 	Periudha e parë (Shtator-Dhjetor)	<ul style="list-style-type: none"> - Hartimi dhe dorëzimi nga çdo nxënës i dokumentit që pasqyron: <i>Temën e grupit, nënçështjen individuale, burimet e informacionit ku do mbështetet dhe hapat për fazat pasardhëse.</i> - Pyetësorët e përgatitur sipas tematikave të grupeve.
2	<ul style="list-style-type: none"> - Mbledhja e informacionit nga pyetësorët, intervistat, dhe përmes hulumtimit në burimet e identifikuara të informacionit. - Përpunimi i të dhënave. <p>Hartimi i draftit të parë të projektit dhe diskutimi i tij.</p>	Periudha e dytë (Janar-Mars)	Produkti: Drafti i parë i projektit.

3	<ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e produktit përfundimtar. - Prezantimi nga grupet. - Vlerësimi i punës në grup dhe punës individuale 	<p><i>Periudha e tretë</i> <i>(Prill-Qershor)</i></p>	<p><i>Produkti:</i> Produkti përfundimtar në formën e një raporti</p>
---	---	---	--

Burimet kryesore të informacionit:

Teksti i nxënësit, enciklopedi, revista, fletëpalosje, guida turistike, harta, adresa të ndryshme interneti, biseda me specialistë të fushave të ndryshme ku mund të grumbullohen të dhëna, vëzhgime në terren, video/CD etj.

Përshkrimi i produktit përfundimtar të projektit:

Secili grup do të realizojë punën e tij në formën e një raporti.

Raporti për secilin grup duhet të përfshijë:

- Të dhëna sasiore (ku është e nevojshme) dhe cilësore të dala nga hulumtimi në burimet e përcaktuara si dhe nga intervistat dhe pyetësorët e realizuar, të cilat mbështesin trajtimin e tematikës përkatëse të grupit.
- Foto, pamje dhe ilustrime nga vëzhgimet në terren dhe/ose nga burime të tjera që shoqërojnë të dhënat, si psh. hartë e zonës, pamje nga Google etj.
- Secili grup në varësi të tematikës, duhet të përfshijë në produkt një plan strategjik masash që mund të merren për nxitjen e turizmit (të shprehur në formë skematike/narrative).
- Raporti mund të prezantohet në Power point/në formë poster/në fletë A4 me shkrim ose në word.

Tematika e orëve të planifikuara

1. Ndarja e detyrave për secilin nxënës dhe përcaktimi i burimeve të informacionit. Hartimi i planit të veprimtarive të projektit për secilin grup, afatet dhe personi përgjegjës.
2. Përgatitja e instrumenteve (pyetësorë, intervista etj) për grumbullimin e informacionit në terren.
3. Grumbullimi i të dhënave nga intervistat dhe burimet e tjera të informacionit.
4. Përpunimi i të dhënave. Diskutimi në klasë i rezultateve kryesore paraprake të nxënësve.
5. Përgatitja e draftit të parë të projektit dhe diskutimi në klasë.

6. Prezantimi i produktit/raportit përfundimtar. Vlerësimi i punës në grup dhe individuale.

Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi

Tabela e kriterëve për vlerësimin e projektit

Periudha	Kriteri	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
Periudha 1	- Strukturon pyetësorët/intervistat në përmbushje të tematikës dhe mbledhjes së të dhënave.	Formulon pyetje të cilat nuk e adresojnë problemin konkret dhe grumbullimin e të dhënave. (2 pikë)	Formulon pyetje që adresojnë pjesërisht problemin dhe mundësojnë grumbullimin e të dhënave. (4 pikë)	Formulon pyetje që adresojnë tërësisht problemin dhe mundësojnë grumbullimin e të dhënave. (6 pikë)
	- Identifikon dhe përdor burime të larmishme për hulumtimin e informacionit.	Përdor një burim të vetëm për hulumtimin e informacionit. (2 pikë)	Identifikon dhe përdor dy burime të ndryshme për hulumtimin e informacionit pa vlerësuar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre. (4 pikë)	Identifikon dhe përdor të paktën tre burime të ndryshme për hulumtimin e informacionit duke vlerësuar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre. (6 pikë)
	- Shkëmben ide dhe bashkëpunon në grup.	I bashkohet grupit por nuk është aktiv në realizimin e detyrës. (1 pikë)	Bashkëpunon me grupin vetëm kur i kërkohet nga anëtarët e tjerë. (2 pikë)	Demonstron gadishmëri për realizimin e detyrës dhe ndan ide me të tjerët. (3 pikë)
Totali		15 pikë		
	- Përpunon informacionin e	Identifikon informacionin dhe të dhënat	Përshkruan informacionin dhe të dhënat	Analizon dhe interpreton informacionin

Periudha 2	mbledhur bazuar në të dhëna.	gjeografike për të nxjerrë përfundime të thjeshta. (2 pikë)	gjeografike për të nxjerrë përfundime bazuar në të dhëna. (4 pikë)	dhe të dhënat gjeografike për të nxjerrë përfundime dhe evidentuar kufizimet. (6 pikë)
	- Organizon draft-produktin në përmbushje të tematikës dhe zgjidhjes së problemit.	Strukturon raportin në çështje që adresojnë pjesërisht problemin, por nuk ofrojnë zgjidhje. (2 pikë)	Strukturon raportin në çështje që adresojnë pjesërisht problemin dhe ofrojnë zgjidhje të pjesshme. (4 pikë)	Strukturon raportin në çështje që adresojnë tërësisht problemin dhe ofrojnë zgjidhje. (6 pikë)
	- Shkëmben ide dhe bashkëpunon në grup. (2 pikë)	I bashkohet grupit por nuk është aktiv në realizimin e detyrës. (1 pikë)	Bashkëpunon me grupin vetëm kur i kërkohet nga anëtarët e tjerë. (2 pikë)	Demonstron gadishmëri për realizimin e detyrës dhe ndan ide me të tjerët. (3 pikë)
Totali		15 pikë		
Periudha 3	- Trajton tematikën në funksion të zgjidhjes së problemit.	Identifikon zgjidhje për çështjen gjeografike aktuale pa u thelluar në pasojat e mundshme të zgjidhjes së propozuar. (2 pikë)	Propozon zgjidhje për çështjen gjeografike aktuale dhe identifikon disa ndër pasojat e mundshme të zgjidhjes së propozuar. (4 pikë)	Propozon zgjidhje për çështjen gjeografike aktuale dhe analizon pasojat e mundshme të zgjidhjes së propozuar. (6 pikë)
	- Prezanton informacionin duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e	Organizon me vështirësi informacionin, pa e përshtatur	Organizon informacionin, pa e përshtatur atë për audiencën e	Organizon informacionin, e përshtat atë për audiencën e synuar dhe e

	përshtatshëm gjeografik.	për audiencën e synuar. (2 pikë)	synuar dhe e përcjell qartë; përdor fjalorin dhe terminologjinë gjeografike. (4 pikë)	përcjell qartë; përdor fjalorin dhe terminologjinë gjeografike. (6 pikë)
	- Shkëmben ide dhe bashkëpunon në grup për prezantimin e produktit përfundimtar	I bashkohet grupit por nuk është aktiv në realizimin e detyrës. (1 pikë)	Bashkëpunon me grupin vetëm kur i kërkohet nga anëtarët e tjerë. (2 pikë)	Demonstron gadishmëri për realizimin e detyrës dhe ndan ide me të tjerët. (3 pikë)
Totali		15 pikë		

2. Vlerësimi i të nxënit të nxënësit realizohet nëpërmjet:

- a) Vlerësimi periodik
- b) Vlerësimi përfundimtar.

a) Vlerësimi periodik

1. Vlerësimi periodik është dokumentimi në regjistër i rezultateve të vlerësimit të nxënësve për secilën periudhë. Ai përmban 2 (dy) nota:
 - a) *Notën e vlerësimit të vazhduar,*
 - b) *Notën e vlerësimit me test ose me detyrë përmbledhëse.*

b) Vlerësimi përfundimtar

1. Vlerësimi përfundimtar realizohet me notë, në përfundim të vitit shkollor.
2. Nota përfundimtare vjetore përmbledh notat vjetore si më poshtë:
 - a) *Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar për tri periudha.*
 - b) *Notën vjetore të vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse për tri periudha.*
 - c) *Nota e vlerësimit të projektit.*
3. Peshat në përqindje sipas vlerësimeve janë:
- 4.

	<i>Pesha në përqindje klasat X-XII</i>
<i>Vlerësimi i vazhduar</i>	40%
<i>Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse</i>	40%
<i>Vlerësimi i projektit kurrikular</i>	20%

5. Hapat për njehsimin e notës përfundimtare vjetore janë:
- Nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NVv) përcaktohet duke u bazuar në tri notat e vlerësimit të vazhduar të periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
 - Nota vjetore e vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse (NTp/Dp) përcaktohet duke u bazuar në tri notat e vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse të periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
 - Nota e vlerësimit të projektit (NVp) përcaktohet në përfundim të projektit duke u bazuar në procesin e realizimit të projektit dhe në produktin përfundimtar.
 - Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse. Mblidhen këto prodhime dhe shumta rrumbullakoset me numër të plotë (p.sh., 8,8 ≈ 9).
 - Formulat për llogaritjen e notës përfundimtare janë:
 - *Nota përfundimtare në klasat X-XII = (NVv x 0.4) + (NTp/Dp x 0.4) + (NVp x 0.2)*
 - Dokumentimi në regjistër i rezultateve të vlerësimit të të nxënit sipas periudhave është si në tabelën më poshtë:

Shembull:

Periudha e parë shtator – dhjetor		Periudha e dytë janar - mars		Periudha e tretë prill - qershor		Vlerësimi vjetor			Nota përfundimtare
NVv	NTp/Dp	NVv	NTp/Dp	NVv	NTp/Dp	NVv	NTp/Dp	NVp	
6	6	8	7	8	7	8	7	9	8

$$(8 \times 0.4) + (7 \times 0.4) + (9 \times 0.2) = 7.8$$

Nota përfundimtare 8

IX. BIBLIOGRAFIA

- Korniza Kurrikulare e Shqipërisë, Tiranë, 2014, MAS.
- Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë, 2014, IZHA, Tiranë.
- Korniza e vlerësimit në arsimin parauniversitar, 2015, IZHA, Tiranë.
- Programet mësimore të gjeografisë për shkallën 5 dhe 6, IZHA, Tiranë.
- Nivelet e arritjeve për shkallën 5 dhe 6, 2016, IZHA, Tiranë.
- Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”
- Metoda të mësimdhënies: Manual për mësuesit e rinj, AEDP.
- Mësimdhënia me në qendër nxënësin, QTKA, 2005.
- Vlerësimi i nxënësit: Manual për mësuesin, IKT, 2009, Tiranë.
- European Journal of Education, Vol46, No. 3, (2011). Key Competences in Europe: interpretation, policy, formulation and implementation. e_1491 289..306
- CIDREE. (2008). A toolkit for the European citizen. The implementation of key competences. Challenges and opportunities. for the European
- Gordon, J., Rey, O., Siewiorek, A., Vivitsou, M., & von Reis Saari, J. KeyCoNet 2012 Literature Review: Key competence development in school education in Europe. A to
- Case network report, Nr.87. (2009): Key competences in Europe: Opening doors for lifelong learners across the school curriculum and teacher education. Toolkit for teachers.
- Claudine OURGHANLIAN (2010). Le socle commun: Une logique, mais laquelle? Polémiques autour d’un socle.
- Deschryver N, Charlier B, Fürbringer J-M. Education et formation (2011). L’approche par compétences en pratique.
- Schagen S. (2011). Ministry of education. Implementation of the New Zealand Curriculum: Synthesis of Research & Evaluation
- Moreau S. (2012). E-noveps Revue nr.2. Articuler les compétences pour transformer l’élève.
- <http://www.nationalgeographic.com/xpeditions/guides/geogsummary.pdf>
- <http://www.mywonderfulworld.org>
- <http://ngsednet.org>
- <http://www.nationalgeographic.com>
- <http://www.nationalgeographic.com/xpeditions/lessons/05/g68/gpafrika3.html>